

Petraç Risto


A protestojnë

BIBLIOTEKA


844-31

R 59

të vdekurit



Opus
R
opus



884 31

R 79

PETRAQ RISTO

A PROTESTOJNE TE
VDEKURIT

ROMAN



Shtëpia Botuese "GLOBUS R."
Tirane, 1994

Kopertina: Sadri Ahmeti

*Ia kushtoj Nasit, babait tim, veteranit të Luftës,
në 50-vjetorin e Çlirimit*

Autori

KAPITULLI I

ZBATICA NJEREZORE

Qyteti bregdetar u çbanorizua pak kohë pas ardhjes së hitlerianëve. Ishte i vetmi rast në historinë e tij, që banorët detyroheshin të braktisnin e ta linin pas si një kufomë. Sipas urdhrit të komandës së Korparmatës së 21-të malore gjermane, zhvendosja e qytetarëve ishte bërë ngaqë në këto brigje pritej zbarkimi i trupave angleze. Për qytetarët kjo nuk kishte aspak rëndësi. Qyteti mijëra vjeçar, evakuimin e quante fyerje. Ai ishte përmbysur dy herë nga tërmetet, mbi të kishin kaluar ushtri të panumërta, ishin bërë masakra masive dhe kishin plasur epidemi të ndryshme e, megjithatë, kishte mbijetuar. Shtëpitë, rrugët, dyqanet, punishtet, zyrat, hotelet, kishat, pusët, xhamitë, varkat, muret e kështjellës, anijet, kafenetë, varreza, kinemaja, brigjet, deti, ndërtesa e madhe e Bashkisë, sahati mbi të, moloja, vila e mrekullueshme në majë të kodrës, fabrika e duhanit dhe fabrika e miellit, gjithçka ishin zhytur në mbretërinë e vetmisë.

Zbatika njerëzore kishte ndodhur para një jave. Qyteti, i parë nga lart, do të dukej si një anije në mbytje, në kuvertën e së cilës lëviznin në zallahi mijëra e mijëra njerëz. Ata drejtoheshin nga rruga e vetme që lidhte qytetin me pjesën tjetër të steresë. Qyteti ishte rrethuar nga ujët e detit dhe të kënetës. Gra, burra, fëmijë, pleq, të rinj e të reja, të shëndoshë e të sëmurë, linin vatrat e tyre, me dhembje, dhe kalonin urën,

poshtë së cilës takoheshin deti me kënetën. Ushtarët dhe oficerët nazistë thërrisnin egër, që banorët të shpejtonin. Spiunët, tanimë fare haptazi, qëndronin krah tyre, përkthenin urdhrat në shqip dhe me sytë e stërvitur vëzhgonin fytyrat e mijëra njerëzve, si për të gjetur në të sekrete e fshehtësi të mëdha, që s'kishin mundur t'i gjenin më parë.

Komandanti Johan Katzen, ndënjur në makinën e tij, priste matanë urës, në krah të rrugës së asfaltuar, sikur donte të numëronte teshin e gjatë të të shpërngulurve. Ishte i ri, jo më shumë se dyzet vjeç. Profesionin si dirigjent orkestre, që e kishte ushtruar pak kohë në qytetin e tij Nuremberg, e kishte harruar qekuri. Tashmë do të ishte komandant i garnizoneve të vendosura në brigjet rrotull qytetit. Nuk do të kishte të bënte me banorët dhe andrallat që të sjell një qytet ku lëvizja ilegale deri para disa ditësh, para terrorit, kishte qenë në pikun e saj. Shumë elementë të rrezikshëm i kishin internuar larg, nëpër kampet e përqëndrimit. Tani po shkullnin njerëzit e qytetit. Në fillim komanda e Korparmatës kishte menduar që banorët t'i shpërngulnin shumë larg, por nga që ishin me mijëra qytetarë, mungonin mjetet e transportit, kështu që vendimi ishte kthyer dhe popullata ishte shtyrë, si në zbatice, dhjetra kilometra më tutje. Kishte nisur operacioni me emrin konvencional "Shëtitje në port".

- Nxitoni! Njerëzit duhet të largohen pa prënduar dielli, - foli prerë komandanti Katzen.

- Si urdhëron! - iu përgjegj një nga oficerët, që rrinte në këmbë pas xhamit të makinës.

Pastaj komandanti urdhëroi shoferin që ta drejtonte makinën nga qyteti. Duhej të bënte një inspektim të përgjithshëm. Makina shkonte ngadalë në mes të rrugës, duke detyruar banorët të hapeshin në të dy krahët. Ata, të zemëruar, të lodhur, të trishtuar, me hapa si të magnetizuar, ngrinin pak kokat e rënda dhe që nga strehët e rëna të vetullave, hidhnin

shikime të flohta armiqësore në fytyrën e përtejxhamit. Një lumë njerëzor ngarkuar me dengje plaçkash nga më të rëndomtat: jorganë, çarçafë, enë gatimi, gjyma, djepe e gjithëcka e domosdoshme që duhet për të jetuar larg shtëpisë, nën çatitë e të tjerëve. Shumica i kishte hedhur plaçkat krahëve, po kishte edhe nga ata që shpërnguleshin me karroca dore apo biçikleta. Tregtarët e qytetit kishin kaluar pak më parë, pasi kishin ngarkuar mallrat në makina të mëdha. Të shpërngulurit flisnin ngadalë, gati me pëshpërima, duke kthyer herë pas here kokat mbrapa, ku dukeshin shtëpitë e mbështetura mbi kodrat e qytetit.

- Eshhtë e para herë që ndodh kështu.

- Mund të ketë ndodhur dhe herë të tjera. Kjo s'ka rëndësi.

- Më mirë të na kishte rënë tërmeti, të na kishte shuar të gjithëve.

- Mos fol kështu! S'ka më keq se tërmeti. Shtëpitë aty i kemi, do kthehemi përsëri.

- S'ma ha mendja. Do vijë anglezi dhe kushedi si do të ndizet. Do bëhet hataja.

- Gjermani është i egër, do na shkrumbojë shtëpi e katandi.

- Jua them unë pse na lajguan, jua them unë: nuk duan të na kenë telash mbrapa shpine.

- Mirë e ka.

- NXitoni hapat!

- S'më bëhet të nxitoj. Më mbeti koka mbrapa. Ja shtëpia ime, ja, ajo që duket si një shami e bardhë...

- S'është gjë e madhe të lësh shtëpinë mbrapa. Mos të qahemi kot. Harruat çfarë hoqëm para disa ditësh. Varrit do t'ia tregoj.

- Prit sa do të vuajmë. Dimri akoma s'ka ardhur.

- Do mendojnë dhe për ne, djema. Kismet. Pak bukë e

pak zjarr do të gjendet dhe për ne. Kismet.

- Po vjen një makinë. Kalo anash. Më duket se është komandanti gjerman. Po, ai qenka, Egërsira!

- Shshsht, se rrotull ka spiunë! Ja, shikoje Servet Dackën, shikoje si i mban sytë hapur. naaa, si peshku.

- Servet qeni, thuaj! Edhe të nipin e degdisi në kampet e vdekjes.

- Kur nuk e zhdukën djemtë! Qeni!

- Ahh!...

Komandanti i ndjente shikimet e banorëve, po aq i bënte për to. Profesionit si dirigjent orkestre e kishte regjur me zhurma të tilla, stonatura të gjalla e klithma bastarde. Ai i duronte me një vetëpërmbajtje olimpike.

Hyri në qytetin e boshatisur, si në një kabanë pa gjuhëz. Iu duk diçka ironike parada e tij pa njerëz. Mungonin vetëm fanfarat. Shoferi, sipas urdhrat të tij, i jepte makinës ngadalë. Ilynë në rrugën kryesore, që merrte kthesën te fabrika e miellit, drejt qendrës së qytetit. Komandanti i shkuan mornica në trup, kur mendoi se si do të jetonte në këtë qytet pa jetë, si do t'i ngryste ditët e pritjes këtu, më këto rrugë të zhveshura, mes këtyre shtëpive shurdhemece. Nxori një cigare dhe e vuri në buzë. Shoferi ia ndezi menjëherë.

- Në një qytet të evakuar, bën ftohtë, - tha shoferi.

Komandanti Katzen nuk foli, po thithi cigaren, si për t'u ngrohur nga ajo xixë e vogël para hundës së hollë. Vërtet që duhej të bënte më ftohtë. Kjo kishte shpjegimin e vet të natyrshëm, që kishte lidhje qoftë me banorët, qoftë me psikologjinë e atyre që do të ruanin një qytet të çbanorizuar. Shumicën e forcave ai e kishte përqëndruar në brigjet rreth e qark, gjithnjë në pritje të një zbarkimi të madh. Edhe kazermat i kishte ngritur rrëzë kodrave, pranë brigjeve, në pikat më strategjike. Kurse komandën e kishte vendosur te ndërtesa e Bashkisë, një ndërtesë kjo vërtet komode, ndërtuar nga

njeshër italianë. Që aty ai do të drejtonte garnizonet e tij, kuptohet nëse do të zharkonin anglezët. Veçse mund t'i duhej të priste gjatë. Ishte komandanti i pritjes.

Inspektimi zgjati vetëm një orë. Gjithçka iu duk në rregull. Banorët ishin larguar duke besuar se kthimi nuk do të vononte. Më mirë, kishte menduar komandant Katzeni duke ngjitur shkallët drejt zyrës. Dhoma e tij e punës do të ishte në katin e tretë, në fund të korridorit, diku nën ingranazhet e sahatit të madh të qytetit. Njëra Jritare e zyrës shikonte nga juperëndimi, ku shtrihej deti. Dielli ishte në të zhytur dhe Katzenit iu duk sikur sfera e zjarrtë qëndronte pezull mbi ujë, e frikësuar nga ftohtësia e dallgëve. Po binte muzgu. Ishte muzgu i parë mbi qytetin pa banorë.

Dita e dytë e evakuimit

Natën kishte fryrë shumë erë. Zhurma e detit i kishte nxjerrë gjumin komandantit, po nuk kishte ç'të bënte, do të mësohej dhe me këtë zhurmë. Vrojtuesit nuk kishin vënë re asgjë të dyshimtë, qoftë nga deti, qoftë nga toka. Disa ushtarë tregonin për macet, qentë dhe pëllumbat që vërtiteshin rrugicave, oborreve dhe çative, me një shikim të përvajshëm. Nuk kishte patur as mjaullitje, as të lehura, madje as gugitje.

Kurse dita kaloi pakuptuar. komandanti Katzen, të cilit sipas dëshirës hëpërhë ia kishin vendosur shtratin në zyrë, fjeti me orë të tëra. Madje edhe drekën ia sollën në zyrë. Nga dritarja nuk shihte ndonjë gjë të re. Po ai perëndim. Veç deti dukej disi më i egëruar.

Dita e tretë

Natën kishte shumë të lehura dhe mjaullitje. Qentë dhe macet vërtiteshin të uritur, duke rrëmihur nëpër të gjitha

qoshet. Ishin dëgjuar krisma xhamash. Ushtarët e patrullave tregonin se qentë kishin sulmuar shtëpitë e tyre. që dikur i kishin ruajtur me fanatizëm, duke kërkuar ushqime nëpër kuzhina. Po siç duket kishin dalë të zhgënjyer dhe ua kishin dhënë ulurimave. Ushtarët ishin detyruar të qëllonin mbi disa nga qentë, të cilët në mëngjes i hoqën nga udhët dhe i hodhën larg. në kënetë.

Komandant Katzenit s'i erdhi mirë kur i raportuan për qentë e vrarë. Ishte një ngjarje joserioze, po fundja ky ishte fati i tij dhe me këtë do të pajtohej, ose më mirë, ishte pajtuar.

Dita e katërt dhe e pestë

Ra një shi i imët. Rrugët u mbushën me gjethe. Shumë qen dhe mace u lanë të lirë të largoheshin në po atë rrugë ku para disa ditësh kishin ikur të zotërit e tyre. Ishte një evakuim tjetër. këtë radhë pa urdhëresë. Vetëm pëllumbat në kafaze e nën pullazet e shtëpive nuk u pajtuan me largimin. Kishin vendosur të ktheheshin në pëllumba të egjër. Natyrisht që komandanti dhe oficerët e tjerë, madje as ushtarakët, nuk dolën te ura për të parë nga afër evakuimin e kafshëve shtëpiake.

Radioja njoftonte për luftime të ashpra në frontin e Lindjes. Kryeministri shqiptar kishte mbajtur një fjalim të rëndësishëm. Ishte lexuar një reportazh për të disa banorë të qytetit të evakuuar, të cilët kishin gjetur strehë në çimentot e ftohta të bodrumeve të Bashkisë së Tiranës, kishin arritur të hanin dhe mull të gjallë. Kinema "Kosova" po shfaqte një film me Greta Garbon.

Katzeni dëgjonte radion me sytë nga dritarja. I dukej sikur shihte një gravurë të qullur nga shiu. Kullonte zi.

Dita e gjashtë

Asgjë e re. Telefonat e vrojtuesve nuk flasin për asnjë

shqetësim. Korrieri sjell gazetat nga Tirana. Asnjë lajm për lëvizjen e luftanijeve angleze. Në të gjithë Shqipërinë vazhdojnë luftime të ashpra.

Dita e shtatë

Ora e madhe e qytetit, që ngrihej tre metra mbi zyrën e komandantit Katzen, papritmas tingëlloi, kur tetë akrepat në të katër fushat, tregonin shifrën 11.

Katzeni u kujtua se ai kishte dhënë urdhër që ora të ndreqej. Mirëpo të njëmbëdhjetë tingujt e saj ishin të fuqishëm e të mprehtë. tepër shurdhues, aq sa nuk duroheshin. Tani nuk mund të jepte urdhër tjetër. U vesh dhe zbriti poshtë. Shoferi e priste në makinë.

- Drejt plazhit!

- Si urdhëron!

Pas dhjetë minutash ishin në shkretëtirën e bardhë. Disa metra larg detit, mes një pylli të vogël me pisha, ishte ngritur garnizoni i katërt. Kishte vendosur të hante drekën me komandantin e këtij garnizoni, Robert Zinken, bjondin syllarush, me të cilin e lidhnin disa kujtime të ëmbla. Edhe Roberti në rininë e hershme i kishte rënë violinës në orkestër, por lufta ia kishte hequr këtë privilegj të artë. Katzeni kishte dëgjuar se Roberti, sapo ishin vendosur në qytet, ditën e evakuimit, i kishte rrëmbyer violinën një cigani dhe kishte luajtur me të si një i fantaksur. Atij i kishte pëlqyer që do të ngulej në këto brigje në pritje të trupave fantazmë. "Kështu do të kem kohë të luaj dhe në violinë", kishte thënë ai.

Katzeni nuk e gjeti Robertin mbi violinë. I thanë se kishte shkuar të peshkonte. Nuk i erdhi mirë, megjithatë qetësisht urdhëroi njërin nga ushtarët që ta thërrisnin. Me hapa të vegjël shkoi drejt bregut. Rëra e lagur kërciste nën shollën e çizmeve. Pra Roberti përsëri e kishte lënë violinën; kishte gjetur si gjënë më të këndshme peshkinin. Mbase s'e kishte keq. Mundej që një ditë dhe ai të bashkohej me bjondin

sylarush. Edhe këtej qyteti shikohej mirë. Tashmë kishte filluar ta njihje disi. Madje shpesh disa lagje, veçanërisht pjesa ku shtëpitë rrinin mbështetur në kodër, pranë mureve të kështjellës së lashtë, i kujtonin Nurembergun. Kjo mbase sepse si në këtë qytet, edhe në vendlindjen e tij, kishin mbetur gjurmë nga kultura romake. Roberti erdhi me një frymë, i zënë ngushtë nga që komandanti e kishte gjetur duke peshkuar.

- Ç`kemi ndonjë të re, Robert? - e pyeti Johan Katzeni.

ju?

- Asgjë, herr komandant. Ditët kalojnë si pakuptuar. Po

- Edhe unë po mërzitem. Nuk di ku të shkosh. Më mirë do të ishte një qytet me njerëz, me zhurmë.

- Oh, jo, herr komandant.

- Si jo?

- Më fal, po qyteti i tillë ishte dhe na solli shumë telashe. Nuk ka si qytetet e evakuara. Do të dëshiroja që të gjithë qytetet të ishin të tillë. Në një sallë vallëzimi, herr komandant, është më mirë të kërcesh vetëm, se sa të përplasesh me supet e turmës.

Roberti vuri buzën në gaz kur pa se Johanit i kish pëlqyer krahasimi. Hynë në zyrën e tij, hoqën kapotat ushtarake dhe zunë vend në dy kolltukë të thjeshtë, thuajse përballë njeri-tjetrit.

- Nuk e ke keq Robert. Po çfarë të bëjmë?

- Fare e thjeshtë, herr komandant, të presim zbarkimin e anglezëve.

- Ashtu?! Prandaj i hedh grepat në det ti Robert, ngaqë kërkon të peshkosh i pari anglezët, - tha Katzeni dhe qeshi me zë.

Me të u bashkua e qeshura gurgulluese e me nota sinqeriteti e Robertit moskokëçarës.

- Po nëse anglezët zbarojnë, nuk do ta kemi të lehtë, përkundrazi, - vazhdoi Johani me shikim nga deti.

- Kam dëgjuar radiot e Evropës me kujdes të madh, herr

komandant dhe, me sa kuptoj unë, nuk ka asnjë shenjë të zbarkimit të tyre.

- Tani ka ikur koha e shenjave, është koha e befasisë. Na duhet t'i hapim sytë mirë.

- Natyrisht, herr komandant. Veç, kam një mendim, ne mund ta gjallërojmë disi jetën tonë në qytet, apo jo?

- Çfarë do të thuash?

- Siç thatë pak më parë edhe ju, herr komandant, u bëmë plot një javë në këtë qytet të boshatisur dhe të gjitha ditët kanë qenë të ngjashme, si të lindura nga një bark. Pse mos të bëjmë diçka për ta gjallëruar jetën tonë, flas të oficerëve, herr komandant.

- Po çfarë, përshembull?

- Sikur të hapim njërin nga klubet.

- Nuk e besoj ta pranojë komanda e lartë një propozim të tillë.

- T'ja argumentojmë. Johan i dashur, - provoi ta thërriste në emër Roberti.

- Herr komandant, thuaj! - ia ktheu Johan Katzeni.

- Si urdhëron, herr komandant!

- Mbase mund të hapet edhe një klub, - tha pas pak Katzeni. - Më jep fjalën se në klub do t'i biesh violinës ti.

- Patjetër, herr komandant, - qeshi Roberti i djallëzuar dhe i mbushi gotën me "Wiski" Johanit të dashur.

- Si do të ishte klubi pranë kinemasë?

- Mëse i përshtatshëm, herr komandant, - tha Roberti dhe sapo ndjeu hapat e kuzhinierit, vazhdoi - Dhe tani të hamë një drekë modeste, po të shijshme.

Vërtet trokitën: sollën peshqit e fërguar dhe një shishe verë.

- Shumë mirë, Robert, shumë mirë.

U dëgjua zilja e telefonit. Gjatë kësaj jave zilet e telefonave kishin qenë tepër të pakta për komandantin e aq më tepër për Robertin.

- Alo, kush jeni?... Si? Po, këtu është. Urdhëroni merreni.

Komandanti e kishte zgjatur dorën me një hije shqetësimi në fytyrë.

- Si thatë?! Një flamur i tyre mbi çati?! Po kjo nuk është e mundur!... Flamur i vogël... Jo, jo mos e hiqni! Erdha menjëherë.

Uli receptorin. Roberti pa si u zverdh e u dyllos fytyra e komandantit.

- Nau prish dreka, Robert. Duhet të largohem menjëherë.

- Po si ka ndodhur?

- Një flamur i tyre mbi çati. E çuditshme!

- Si ka mundësi që një javë patrullat tona të mos e kenë vënë re? - pyeti Roberti.

- Vërtet e habitshme! - tha Johan Katzeni, duke u drejtuar nga varësja për të marrë kapotën ushtarake.

KAPITULLI II

FLAMURI

Ishte një shtëpi e vogël, njëkatëshe, me oborr të zhveshur dhe me një çati çuditërisht të kuqe. Flamuri i vogël sa madhësia e një libri, qëndronte në kulmin e çatisë. Të jepte përshtypjen e një flugeri.

Komandanti i shoqëruar nga dhjetra ushtarake të tjerë, u vërtit disa minuta rrotull shtëpisë, si për të gjetur ndonjë gjurmë të freskët. Në kokat e të gjithëve vërtitej një pyetje: ky flamur i vogël ishte vënë mbi çati para ikjes së banorëve. apo pas ikjes së tyre? Patjetër që para ikjes, por ngaqë çatia ishte e kuqe, patrullat nuk e kishin vënë re.

- Jo patrulla, por verbëri! - tha me një zemërim të brendshëm komandanti, duke ndalur para portës kryesore të

shtëpisë, mbyllur me një dryn të madh.

- Hapeni! - urdhëroi ai.

Dy ushtarët që i rrinin në krah u afruan dhe qëlluan me automatik pak mbi dryn. Porta u hap menjëherë.

Johan Katzeni hyri i pari në atë shtëpi të braktisur si gjithë të tjerat. Ajri i ndenjtur të krijonte një ndjesi të keqe. Shtëpia kishte tre dhoma të thjeshta, me ca mindere e qilima lecke. Sergjenet dhe dollapet ishin boshatisur nga enët dhe plaçkat. Fotografitë ishin hequr nga muret: si duket të zotët e shtëpisë i kishin marrë me vete.

- Dalje për në çati nuk ka, - raportoi njeri nga oficerët.

- Atëhere logjikë e thjeshtë, flamuri është vënë nga jashtë, - tha komandanti.

- Mundet nëpërmjet manit, degët e të cilit bien në cep të çatisë, - tha Gustav Gudorfi, një ushtarak me funksionin e ndihmës komandantit të garnizoneve të dislokuara rrotull qytetit.

- Jëdhe mundet, - ia ktheu Katzeni - po ne duhet të dimë se kur është vendosur, para apo pas evakuimit.

- Natyrisht që para, - ndërhyri një oficer tjetër - nuk ekziston asnjë alibi për ta kundërshtuar.

- Shtëpia është pothuajse buzë rrugës, - tha komandant Katzeni, duke u ulur në njërin nga minderet e dhomës, që dikur ishte përdorur si kuzhinë, - dhe nuk ka mundësi që patrullat tona të mos e kenë venë re flamurin. Kësaj i thonë që plot një javë të endesh symbyllazi nëpër rrugë.

Ai e ngriti zërin dhe vartësit instiktivisht morën drejtqëndrim.

- Ma sillni flamurin!

Dy ushtarakët dolën për të zbatuar urdhërin. Në oborr, një ushtar hoqi shpejt e shpejt helmetën dhe kapotën, e pastaj me shkathësi u ngjiti në manin e madh. Katzeni e pa nga dritarja ushtarin trupmesatar dhe, padashur, imagjonoj atë tjetrin, kur para një jave, ose, (këtë nuk donte ta besonte) ose para një dite.

ishte ngjitur në po këtë pemë dhe kishte vendosur me shkathtësi flamurin e vogël mbi kulmin e çatisë.

Pas pak flamurin e sollën. Coha fërgëllonte si një shpirt. Komandanti e mori në dorë dhe e tendosi me shikim të ngulur te shqiponja dykrerëshe. Pastaj qetësisht e palosi dhe e futi në xhepin e kapotës. I shkoi ndër mend të jepte urdhër të digjnin shtëpinë, po kjo iu duk absurde, sepse ishte një ndëshkim nga i cili nuk përfitonte askush. Do vinte dita që të zotët e shtëpisë do ta pësonin. Pastaj, versioni tjetër më i mundshëm, se flamurin e kishte vendosur dikush pa dijeninë e të zotit të shtëpisë, e çarmatoste Katzenin. U ngrit nga minderi e u drejtua nga porta duke folur qetësisht:

- Në ora katër, mbledhje e komandës! Hail Hitler!

- Hail Hitler!

Në mbledhje u mbrojti versioni i parë, pra i vendosjes së flamurit para një jave. Katzenit i interesonte që e vërteta të ishte pikërisht kështu.

Kur mbledhja po i afrohej fundit, ai hodhi idenë e hapjes së një klubi.

- Një klub që do të na shërbejë vetëm ne oficerëve.

- mrekulli, mrekulli, herr komandant! - u dëgjuan disa zëra dhe të njëzetë ushtarakët e shtabit të komandës, si të dirigjuar nga Katzeni, duartrokiten.

Komandantit i qeshi fytyra.

- Kërkesën për hapjen e klubit do ta bëjmë që sot, - premtoi ai - Ma merr mendja se do ta pranojnë. Me kaq mbledhjen po e mbyllim.

Katzeni doli i pari nga salla dhe u drejtua në fund të korridorit, për te zyra e tij. Pasi palosi jashtëkun më dysh, u shtri në krevat. U kujtua që në xhepin e brendshëm të xhaketës kishte futur atë flamurin e vogël. E nxori dhe mbajti të tendosur me të dyja duart.

Plot një javë mbi çati dhe askujt nga ne nuk i ra në sy.

Pastaj e la flamurin mbi komodinë dhe ia nguli sytë

tavanit të lartë. Iu fanit e shoqja. Ana, atje në Nuremberg. Ç'bënte ajo tani. Patjetër priste lajme, lajme, lajme. Priste nga gazetat, nga radiot, nga letrat. Po çfarë t'i shkruante Anës. se ishte komandant në një qytet të boshatisur, ku do të priste me ditë, javë apo dhe muaj zbarkimin e anglezëve?! Këto nuk lejoheshin të shkruheshin në letra. Pastaj dhe nëse do t'ia shkruante, ajo patjetër që do ta mëshironte. Le pastaj po t'i përshkruante hollësisht të tilla si detaji me këtë flamur të vogël, që kishte mbirë papritmas mbi çatinë e një shtëpie njëkatëshe. Ana, energjike nga natyra, mund të mbytej nga letat e të qeshurit. Asgjë nuk do t'i shkruante, absolutisht asgjë, përndryshe ai nuk do të kishte ca shenja të lehta triumfi.

U dëgjuan gjashtë tingëllimat e forta të sahatit. U përmend. Nuk kishte arritur të shihte përfundimin e bukur të diellit mbi suprinën e detit. Kur pushuan tingujt e orës, vuri re se i kishte shtrënguar akoma më fort kapakët e syve. Më i qetë, Johan, ky është vetëm fillimi, i tha vetes. Duhet të mësohesh edhe me një qytet të evakuar. Nuk thonë kot: ena hosh bënë zhurmë të madhe.

Kërceu nga shtrati, hapi sirtarin e komodinës, mori flamurin dhe e flaku brenda. Pastaj hodhi supëve kapotën, u pa shpejt në pasqyrën paqë derës dhe doli. Vendosi të bënte një inspektim në qendër të qytetit. I shoqëruar nga katër ushtarë, në fillim u drejtua majtas godinës së komandaturës, në shtëpitë rrotull xhamisë së madhe. Ishin disa shtëpi të vjetra, si të kërrusura nga pleqëria. Natyrisht asnjë zhurmë gjallese. Gjithçka e vdekur. Ngjitur me xhaminë ngriheshin muret e kështjellës, të cilat vazhdonin tutje deri në breg të detit. Ishin muret rrethuese që kishin mbrojtur qytetin nga sulmet romake e bizantine. Ai kishte arritur t'ia thithte lëngun qytetit e ta linte të thatë, pa njerëz. Veç ai flamuri... U dëgjua një klithmë. Ushtarët u gjetën të papërgatitur, por menjëherë vunë duart në këmbëzat dhe karikatorët e automatikëve. Komandanti Katzen u përmbajt. Një klithmë në pragatë, në një qytet pa jetë,

patjetër që të zgjon emocione frike e çudie të përziera bashkë. Në çast një shpend nate fluturoi nga një çati aty pranë dhe ndali te kulla e sahatit.

- Mos u frikësoni, - tha Katzeni - në këtë qytet vetëm kukuvajkat dhe sorrat kanë mbetur.

Ushtarët qeshën.

- Tani shkojmë më tej, rreth shtëpisë ku gjetëm flamurin.

Nata u bë e gjithëpushtetshme dhe Katzeni ndezi elektrikun e dorës. Një shirit drite rrëshqiti para tij. Përsëri po përjetonte një gjendje të çuditshme, që, siç dukej, kishte lidhje me atë flamur të vogël sa një pëllëmbë burri. Dikushi e kishte ngjitur në çati patjetër për të sfiduar atë dhe forcat që ai komandonte. Kontrollloi përsëri rrotull asaj shtëpie me çati tepër të kuqe dhe pastaj zbriti në lagjen e pazarit.

Në ditët e para të hyrjes së trupave të tyre në qytet, ai kishte vëzhguar disa herë lëvizjet në treg dhe gjithmonë ishte larguar me ndjesinë se në një vend si ky, me kaq lëvizje e zhurmë, ishte e pamundur të blije sekrete. Vetëm spiunët e regjitur mund ta përballonin një vështirësi të tillë. Dhe spiunët nuk kishin qenë të paktë. Në ditët e terrorit, ata i kishin dhënë një ndihmë të madhe për kapjen e shumë elementëve të rrezikshëm. Ndali para një shtëpie, e cila kishte qenë bazë ilegale.

- Hapeni! - urdhëroi ushtarët.

Njeri prej tyre qëlloi me automatik mbi drynin e portës së jashtme. Jehona e krismave u shkri me përtesë në hapësirën e ftohtë të natës. Hynë në oborr. Një kumbull e vogël me degë të zhveshura, dukej sikur përgjonte.

- Hapeni dhe derën e shtëpisë!

Përsëri krismat e automatikut. Shiriti i bardhë i elektrikut të dorës lëpiu faqet e jashtme të murit të asaj baze ilegale, që tashmë ishte një shtëpi e rëndomtë. Hyri brenda menjëherë pas shiritit lëpirës. Asgjë. Natyrishy asgjë. Megjithatë iu duk sikur të gjitha orënditë e ndiqnin me disa sy të padukshëm ankthi. Të

zotin e shtëpisë e kishin marrë zvarrë deri në zyrat e Gestapos. Pastaj patjetër që e kishin hipur në trenat që vraponin drejt kampeve të përqëndrimit.

Doli nga shtëpia. Ajri i lagësht i atij fillimi dimri sikur ia kthjelloi trurin. Vendosi ta mbyllte këtë inspektim fare të kotë. Do thërriste shoferin dhe do të shkonte ta kalonte natën me Robertin, në plazhin e braktisur.

KAFITULLI III

SHTEPIA MBI KESHTJELLE. "PIRATI"

As komandantit Johan Katzen, as oficerëve që ai kishte në vartësi e aq më tepër ushtarëve, nuk mund t'u shkonte ndër mend se në qytetin e evakuar kishin mbetur tre banorë, një çift me vajzën e tyre të paralizuar.

Para se të vendosnin për të qëndruar në qytet, çifti kishte diskutuar gjatë. I shoqi kishte ngulur këmbë të qëndronin, kurse Shpresa në fillim kishte kundërshtuar me argumentin e vetëm bindës: gjermanët patjetër do të na kapin e do të na vrasin. Epidami i kishte thënë se evakuimi nuk do të zgjaste shumë, kështu që për pak kohë mund të qëndronin të fshehur fare mirë. Ushqime kemi, mbledhim dhe ca rezerva e vendosim të rrimë. E pastaj, kishte vazhduar ai, shtëpia jonë është vërtet strategjike, nën themelet tona zgjaten katakombet e kështjellës.

për të cilat nuk dinë gjë jo vetëm gjermanët, po as spiunët më të vjetër. Unë kam hallin e vajzës, kishte thënë Shpresa. të bëhet si është më mirë për Jetën.

Jeta, vajza e tyre shtatë vjeçare, ishte trembur nga një bombë që kishte plasur shumë pranë shtëpisë, në kohën kur ajo po luante. Ishte trembur kaq tepër, sa që kishte rënë në vend pa ndjenja, me këmbë e duar të paralizuara. Kur ishte përmendur, prindërit kishin vënë re jo vetëm paralizën e saj, por edhe humbjen e logjikës, si dhe rrënjosjen e një frike në sytë e pastër. Çdo zhurmë e fortë, ulërimë, krismë automatiku, plasje bombe, e bënte vajzën si të çakërdisur, lëshonte disa klithma ngjethëse që të preknin zemrën. Ku të shkonin me vajzën e tyre, nën cilën çati? Në dimrin që po afronte, aq më tepër në zemër të luftës, kur armiqtë ishin egërsuar shumë, ishte tepër e vështirë ta përballoje jetën në shtëpinë tënde e jo më në shtëpitë e botës, apo në udhë, si muhaxhirët. Për të gjitha këto, më në fund, Shpresa kishte pranuar. Do të qëndronin në qytet. Të fshehur.

Epidami kishte dalë në treg dhe, ashtu si të gjithë qytetarët, kishte blerë ushqimet që do t'i duheshin për ditët e evakuimit. Dyqanet kishin një gjallëri të çuditshme, megjithëse të gjithë blerësit thuajse ishin të varfër. Po, më shumë se sa paraja, e gjallëronin bisedat. Fjalët e banorëve kullonin sharje, mallkime, urrejtje. Pak a shumë e njëjta temë. Nuk ishte e lehtë të shkëputesh nga shtëpia jote, nga ai pak rehat e ajo pak siguri që të jep në kohë lufte çatia mbi kokë. As çatia, as themelet nuk merreshin dot me vete, atje ku do t'i degdisnin. Flitej se do t'i çorin në Tiranë, në oborret e kishave e xhamive, nën strehët e dyqaneve, do t'i grumbullonin në disa fusha djerrë, si të ishin kuaj në prag ngordhje, ose do t'i linin të zinin një copëz strehë nëpër farefisëri. Mirëpo, vëlla i dashur, jo të gjithë kanë miq në qytetet e fshatrat rrotull.

Epidami, u jepte të drejtë atyre njerëzve. I ziu njeri, thoshte një plak i krrusur, fare mirë mund ta quash edhe hall,

hall me dy këmbë e me një zemër. i gjori njeri! Epidami ishte disi i qetë që Shpresa kishte pranuar të qëndronin. Planin e qëndrimit e kishte thurur thjesht: ditën e evakuimit, ku patjetër do të kontrolloheshin shtëpitë, ata të tre do të zbrisnin poshtë në dhomën e nëndheshme, e cila kishte lidhje me katakombet e kështjellës. Këto katakombe i kishte zbuluar babai i tij më 1939, dy muaj para pushtimit të qytetit nga fashistët italianë dhe familja e kishte parë të arsyeshme të mos tregonin asgjë. S' dihej si vinin kohërat, këto dhoma e korridore të nëndheshme, mbase edhe mund t'i ndihmonin. Dhe vërtet që koha kishte ardhur. Prindërit e tij kishin vdekur dy vjet më parë, në fillim babai e pas katër muajsh nëna, kështu që e fshehta e shtëpisë dihej vetëm nga ai dhe Shpresa.

Gjatë atyre tre ditëve që kishin mbetur deri në evakuim, ai doli disa herë dhe bleu shumë ushqime: mish, miell, sheqer, fasule, patate, makarona, oriz, gjalpë, vaj, djathë, marmalatë, qepë, salcë si dhe disa bukë. Pazarin e bëri në dyoancë të ndryshme që të mos hinte në sy për këtë sasi të madhe ushqimesh që, natyrisht, duke u krahasuar me pazarin e banorëve të tjerë, të linte menjëherë përshtypjen se kjo më tepër kishte të bënte me ngujim e zaire dimri, se sa me shpërngulje. Se fundja, edhe atje ku do të shkonin, banorët do të gjenin ca ushqime për të mbajtur gjallë fillin e jetës.

Mëngjesin e evakuimit, Epidami dhe Shpresa nuk e kishin fiksuar në kujtesë ashtu si të tjerët. Natën, para evakuimit, ai kishte dalë, kishte mbyllur portën e jashtme me dryn dhe nga një e çarë e murit të oborrit kishte hyrë përsëri në shtëpi dhe kishte mbyllur derën nga brenda. Shumë plaçka të domosdoshme i kishin zbritur në dhomën e poshtme. Në dhomën e fshehtë fare mirë mund të ndizje edhe zjarr. Soba kishte si qyngj labirinthet e kështjellës, kështu që tymi nuk mund t'i tradhtonte të ishehurit.

Pra, në mëngjesin e evakuimit, çifti përgjonte tërë sy e veshë. Jeta flinte e qetë në shtratin e saj. Dëgjoheshin zëra,

thirrje të oficerëve e ushtarëve nazistë dhe një rrahje e vazhdueshme hapash me një ritëm të çoroditur. U dukej sikur zhurma vinte nga thellësia e jo nga sipërfaqja e tokës. Orën me gostek Epidami e mbante gjithnjë në dorë. Kaluan plot dy orë dhe ajo zhurma e mbytur e hapave, thirrjet, zërat, u tretën, thuajse u bënë baltë e u ngjitën diku sipër kokave të tyre.

- Po tani? - pyeti Shpresa - A thua shpëtuam?

- Ma merr mendja se po, - ia ktheu i shoqi. - Forcat gjermane do të jenë në pritje të zbarkimit të anglezëve, kështu që detyrimisht ata do të përqëndrohen në brigje dhe do të na lenë të qetë në hallet tona.

Java kaloi shpejt. Në ditën e shtatë të evakuimit, në drekë, ata dëgjuan disa krisma. (Ushtarët kishin qëlluar me automatik në portën e shtëpisë me flamur).

- Çfarë ka ndodhur, thua? - pyeti e shoqja.

- Nuk e di. Krismat janë disi larg. Them të ngjitem një herë e të vëzhgoj nga dritarja.

- Mirë, - tha ajo.

Epidami me një dylbi detarësh në dorë, u ngjit në dhomën lart. Largoi pak perdet dhe vuri dylbitë. Dritarja ishte vërtet në një pikë strategjike, sy që shihte thuajse tërë pjesën verilindore dhe jugore të qytetit. Iu deshën vetëm pak sekonda që dylbitë të përqëndroheshin në skaj të këndit të shikimit, në veri të qytetit, ku ishin mbledhur dhjetra ushtarë dhe oficerë nazistë. Duhej të ishte shtëpia e mjeshtrit të punimit të enëve prej balte. Nuk e kuptoi se ç'kishin dhe pse kishin qëlluar. Papritmas mbi çati u ngjit një ushtar pa kapotë e pa kapele, i cili këmbadoras shkoi drejt kulmit të çatisë... Vetëm atëhere pa një flamur të vogël ngulur në çatinë më të kuqe të qytetit. I afroi më tepër dylbitë si për të afruar flamurin dhe, njëkohësisht, habinë e tij. Një flamur... Domethënë në qytet nuk kishte mbetur vetëm familja e tij, por edhe dikush tjetër. Ose më shumë të tjerë. Thërriti Shpresën, e cila u ngjit menjëherë.

- Na merri dylbitë dhe shiko atje.

- Çfarë ka ndodhur?
- Dikush ka ngritur një flamur në shtëpinë e atij mjeshtrit të enëve prej balte. Ja atje. E shikon?

- Po. Ushitari po zbret me flamurin. Po cili e ka vënë?

- Nuk e di.

- Mbase e kanë ngritur para evakuimit, - tha ajo.

- Edhe mbase. Megjithatë se ç'kam një parandjenjë se nuk duhet të jemi të vetmit në këtë qytet.

Ky mendim sikur i turbulloi.

- Nëse ai flamur është vënë në ditët e evakuimit, atëhere kjo është shenjë rezistence, - tha ajo.

- Dhe mund të jetë rezistencë. - tha ai i ndezur nga ideja befasuese.

Epidami ia mori së shoqes dylbitë dhe rinisi vëzhgimin.

- Po qe se vërtet është rezistencë, na takon që edhe ne të bëjmë diçka. - vazhdoi ai.

- Kam frikë - tha ajo - Pastaj, mos harro vajzën.

- Natyrisht, - tha ai - Dhe nëse do të veprojmë, do tregohemi jashtëzakonisht të kujdesur. Mos harro se ne jemi të fshehur mbase më mirë se kushdo tjetër. Shiko, shiko, gjermanët po dalin. Janë në oborr. Diçka po flasin midis tyre.

- Kam frikë mos ia nisin terrorit të dytë.

- O, jo, ata e kanë fjetur mendjen. Dhe nga sa kam vënë re unë, shumë pak patrulla kanë lënë rrugëve të qytetit.

- Megjithatë nëse do të ketë rezistencë, nazistët nuk do të rrinë duarlidhur, apo jo? - tha Shpresa.

- Të kam ditur më trimëreshë - i tha ai - Po në fund të fundit ne do të shohim si do të rrjedhin ujërat.

Përsëri u krijua heshtje. Epidami hodhi sytë nëpër dhomën e zhveshur, tashmë të mbuluar nga pluhurat e parë. Në një qoshe merimanga kishte thurur pezhishkën e saj, grackë të insekteve.

Flamuri i vogël në çatinë e shtëpisë së mjeshtrit të panimit të enëve prej balte, kishte hyrë si padashje në jetën e

çiftit të fshehur dhe kishte zgjuar te Epidami dëshirën që të vepronte. E shoqja, megjithëse e trembur nga fatkeqësia e vajzës, nuk ishte pengesë e pakapërcyeshme.

- Duhet të veprojmë disi larg shtëpisë sonë. Dhe natyrisht vetëm natën. Të përfitojmë nga errësira, - tha ai me vete, duke pritur reagimin e Shpresës.

- Po ç' do të bëjmë? - pyeti e shoqja

- Ta mendojmë, - tha ai dhe i hodhi krahun në sup.

- Nuk është kaq e lehtë, - ia ktheu ajo - Kësaj i thonë të luash me zjarrin.

- Ja që lufta na detyron të luajmë me zjarrin - tha ai. - Ne nuk kemi e nuk do të luftojmë me armë... Veprimet tona do të jenë tepër të thjeshta...

- Nuk di ç' të them... Veç kujdes të keqen, se mos na hanë kokën.

- Kuptohet që me shumë kujdes, e qetësoi ai. - Rrallë e për mall, - shtoi pas pak.

- Megjithatë duhet të ruhem i mirë, - foli Shpresa.

- Po sikur të hyjmë në tunelet e kështjellës? - pyeti ai - Mbase gjejmë edhe ndonjë strehë tjetër për ditë të zezë.

- Atje ka lagështirë, - tha ajo.

- S' është keq të kontrollojmë njëherë, - tha ai dhe ajo përsëri kuptoi se i shoqi kishte marrë vendim.

Nga shënimet në ditar:

Ishte e para herë që hyja në katakombet e kështjellës. Kërkoja vende të fshehta ku në rast nevoje të strehohesha me vajzën e sëmure dhe gruan. Me vete mora fenerin dhe një lopatë të vogël, nga ata që përdornin xhenjerët italianë. Në fillim labirintet tërë lagështirë, kalohen lehtë po pastaj çdo gjë vështirësohet. M'u desh të përdorja lopatën për disa orë. U kaheva majtas. Ajri u bë më i rëndë. Dëgjohej pikimi i ujit. Ecu

edhe pak. Papritmas u ndala. Përpara meje shtrihej një gjol i vogël, vërtet i bukur e i pastër si rezervuar lotësh. Afroj fenerin. Shtangem. Nën ujin e kulluar shoh një vajzë magjepëse deri në legjendë, fytyrrumbullake, syzezë, me flokë të shkurtëra dhe me veshje të mozaikë. Duket sikur fle dhe ëndërron. E njoha menjëherë cila ishte: Bukuroshja e qytetit, mozaiku me famë, i ndërtuar që në shekullin e katërt para erës sonë. Për Bukuroshen është folur kaq shumë, saqë është kthyer në një totem për qytetin. Mua si mësues historie, gjithmonë më kanë tërhequr legjendat e thurura rreth vajzës prej mozaiku. Pleqtë tregojnë, me një gjuhë gjithnjë legjendare, se para një çerek shekulli, Bukuroshja ishte zgjuar njëherë, kishte çelur sytë e habitur dhe papritmas zbuluesit e saj, disa ushtarë austriakë të Luftës së Parë Botërore, të cilët po gërmonin për të hapur një vendstrehim, kishin parë se ajo krijesë, si të ishte prej mjegulle, u kishte rrëshqitur nga duart dhe ishte zhdukur.

Pra ushtarët e paskan parë vërtet. Po ata nuk mund ta merrnin me mend se Bukuroshja kishte hyrë nëpërmjet labirintëve në thellësi të kështjellës.

Në këto çaste mendoj: mbase dhe tani në Luftën e Dytë, ajo mund të zgjohet përsëri, këtë rradhë për të kundërshtuar ca ushtarë të tjerë, që flasin të njëjtën gjuhë si ata të parët.

Njeriu që kishte vendosur flamurin, ishte një mesoburrë dyzet e pesë vjeç. vejan. me njërin sy të mbuluar me cohë të zezë, si piratët e dikurshëm. E quanin Qamil dhe kishte punuar si timonier në motobarkën e Angjelin Gjeçajt, njerit prej tregtarëve më të njohur të qytetit. Me historinë e tij Qamili ishte bërë i famshëm në tërë qytetin. Katër ditë para kapitullimit të Italisë, pronari i motobarkës kishte organizuar me paramendim një festë të vogël në anije, ku kishte ftuar shumë pak njerëz; tre italianë (dy ushtarë dhe një nëntoger), Qamilin dhe dy detarë të tjerë si dhe familjen e tij: nënën, gruan dhe vajzën. Qamili e kishte nuhatur vonë hilenë e darkës, pasi pronari kishte

propozuar të shëtisnin me motobarkë. Nga të njëmbëdhjetë njerëzit e ceremonialit fallco, vetëm Qamili nuk kishte dijeni për arratisjen. Atë e kishin marrë, sepse ishte një timonier i zoti, dhe se e kishte bërë zakon që të flinte në anije. Nuk mund ta shkulloje dot. Kishin lundruar pak milje kur nisi fortunali. Ishte diçka e papritur ky egërsim i natyrës. Deti po kthehej në një masë ferri. Dallgëzimi i fortë, i ndihmuar dhe nga Qamili, kishte thyer timonin. Tani motovelera vërtitej pa shpresa në detin e hapur, me duart e drekëve të ngritura lart, si besimtarët në një lutje. Tregtari Angjelin Gjeçaj dhe tre italianët ishin përpjekur ta vinin në punë Qamilin, po ai nuk kishte pranuar. Atëhere, në kulmin e zemërimit, të nxitur nga tmerri i paravdekjes, ata nuk e kishin vrarë Qamilin, po e kishin hedhur në detin e tërbuar. Ishte e pabesueshme, po ujku i detit, "pirati" i regjur në fortune të tilla, kishte arritur që, me ndihmën e krahëve të fuqishëm si dhe të një trungu (mbeturinë e ndonjë anijeje fatkeqe), të shpëtonte nga mbytja.

Kish përfunduar në një breg tërë leshterikë, ku kishte ndenjur shtrirë pa ndjenja në një gjumë vdekjeje plot dymbëdhjetë orë. Kur kishte hapur syrin e vetëm, kishte kuptuar se ndodhej në veri të qytetit të tij. Moti ishte kthjelluar, siç ndodh zakonisht pas një shtrëngate. Rrobot i qenë tharë.

Sapo kishte shkuar në qytet, lajmi kishte marrë dhenë: pronari i një motobarkë të madhe, Angjelin Gjeçaj me familjen e tij si dhe tre italianë dhe dy detarë, ose ishin arratisur për në Itali, ose kishin mbërritur në fund të detit. Për banorët ishte e pabesueshme dhe habiteshin si kishte arritur të shpëtonte ai njeri në mes të detit me damlla.

Për dy muaj rresht, qyteti foli e përfoli rreth historisë që nisi me daljen e Qamilit në breg e që vazhdoi, si për ironi, edhe me daljen në breg, po shumë e shumë milje më tej, të ekuipazhit të arratisur mbi karakatinën që tashmë s'mund të quhej anije. Nëna e pronarit kishte humbur jetën. Angjelin Gjeçaj kishte luajtur nga mendtë kur kishte marrë vesh shpëtimin e Qamilit,

dëshmitarit të vetëm.

Hyrja e gjermanëve në qytet, terrori i egër që i parapriu operacionit të tyre për evakuimin, natyrisht që kishte shuar nga kujtesa e banorëve edhe këtë histori. Kurse te "pirati" ishte krijuar një mit me fortësi korali: dashuria për qytetin. Ashtu si në ligjin e vjetër të kapitenëve: të mbyten nëse anija mbytet, edhe Qamili kishte vendosur një ligj: do qëndronte në qytetin e lindjes. Ndaj evakuimit ai e priti i qetë.

Dhoma e tij ndodhej në afërsi të kishës. Po gjatë ditëve të evakuimit nuk do të qëndronte atje. Rreth njëqind banorë të qytetit, të afërt, miq e shokë, i kishin besuar Qamilit rolin e kujdestarit të shtëpive, madje dhe të dyqaneve, duke i lënë nga një kopje të çelësave. E kishin marrë vesh vendimin e "piratit" dhe në ditët para zbrazjes së qytetit, i kishin lënë çelësat që herë pas here të kontrollonte, sepse nuk i dihej: në shtëpitë hosh shëtit mortja. Shumica e banorëve mendonin se në qytet nuk do të kishte frymë pushtuesi e ai, Qamili i fshehur, do ta kishte të lehtë të kalonte nga njera shtëpi në tjetrën, si roje i ligjëruar. "Pirati" kishte vendosur të flinte në shtëpitë e tjera, natyrisht pa zhurmë, pa ndezur drita. Të zotët e shtëpive, veç çelësave, kishin lënë për kujdestarin edhe ca ushqime që do t'i duheshin në ditët, javët apo, kushedi, edhe muajt e vetmisë.

Javën e parë ai kishte fjetur në një shtëpi në verilindje të qytetit. Ishte banesa e një marinari të vjetër, dajlin e të cilit gjermanët e kishin degdisur larg, në kampet e vdekjes. Ai e kishte njohur Bedriun, birin e mikut dhe i pëlqente e qeshura e tij e lirshme, pa djallëzi. Një javë kishte lëvizur nëpër tre dhomat, kishte kërkuar nëpër sirtaret për të gjetur diçka që ta lidhte më shumë me Bedriun dhe rastësisht kish gjetur një flamur të vogël, të palosur në katërsh. E qeshura e ëmbël e djaloshtit kishte shpërthyer papritmas dhe Qamili kishte vendosur: do të ngjitej në një nga çatitë e qytetit dhe do të vendoste mbi të flamurin. Ky vendim nuk ishte pjekur rastësisht, por dalëngadalë siç pjek stina frutin. Kishte pritur rënien e errësirës

dhe kishte dalë nga shtëpia e Bedriut për ta ngjitur flamurin në një çati aty pranë. Veprimet i kishte bërë me shkathtësi, me ndihmën e një mani të madh. Flamurin e vendosi në kulmin e çatisë. Pastaj, po me shkathtësi detari, kishte zbritur dhe, nëpër ca rrugë që dukej sikur e ndihmonin, kishte arritur në një shtëpi tjetër, të cilën gjithashtu ia kishin besuar. Banesa e re ndodhej në afërsi të shtëpisë me themelet në kështjellë. Aty kishte rënë në një gjumë të thellë, pa ëndërra.

Nga lajmet në radio:

Mesazhi i Kryetarit të Këshillit të Lartë, drejtuar popullit shqiptar:

...."Ka shtete që qysh prej tre shekujsh nuk shohin asnjë kryengritje, kurse popuj të lehtë nga karakteri, të dobët nga morali, të sipërfaqshëm nga kultura, të vobekët nga dembellëku, herë pas here ngrenë krye, dhe në vend që të përparojnë bien më poshtë...".

Dialog

- Ky është idiotizëm me brirë! Duhet thënë vetëm e kundërta.

- Vërtet e kundërta... E si mund të bëjë kryengritje një shtet që s'ka krye?...

...Parashikohet të bëjë dimër i egër. Çmimi i druve arriti në 30 franga ari për një kuintal.

Çmimi i vajit në 25 franga ari për një litër...

...Në bodrumet e bashkisë së Tiranës, në oborret e kishave e xhamive, gjen të strehuar me dhjetra familje të qytetit të evakuuar... Gjendja e tyre është tepër e vështirë, ndaj duhen ndihmuar.

...Ndalohet rreptësisht zbrazja e armëve pa leje në ditët e festave...

Dialog:

- Qesharake! E dëgjove, pa leje...

- Ka kaq shumë zbrazje armësh sa vërtet që çdo ditë po kthehet në festë.

KAPITULLI IV

A PROTESTOJNE TE VDEKURIT

Një rrugë këmbësorësh. nëpërmjet kodrës, të çonte te varrezat e qytetit. Pas vdekjes së nënës dhe babait, Epidami kishte kaluar shpesh nga kjo rrugë. kështu që tani ecte shpejt dhe pa u penguar. Shtëpitë, pemët, gurët, i jepnin të njohur. Kishte marrë me vete një tufë të madhe lulësh, që e shoqja i kish mbledhur në muzg, në oborret e komshinjve. Ishte një natë me hënë të shndritshme si të sapokallaisur. Hëna kishte hyrë dhe në bisedën e tij me të shoqen.

- Ka hënë, - i kishte thënë Shpresa - mbase gjermanët kanë vënë patrulla në varreza. Do të shohin.

- S'ma merr mendja të ruajnë varrezat, - ishte përpjekur ta bindte ai - Ata i kanë sytë nga deti.

- Po hëna...

- Më mirë që kam hënë mbi vete. Do të di ku të shkoj. Lulet do t'i vendos te varret e reja.

- Mirë atëhere, kujdes, - kishte pranuar ajo.

Varret e reja u takonin të vrarëve nga terrori i ditës së parë të operacionit. Shumica kishin qenë ilegalë. Çifti kishte

vendosur ta niste me varret e dëshmorëve.

Epidami zbriti në ca shkallë bërë prej plisash të mëdhenj dhe papritmas në faqen e kodrës përballë, u shfaq varreza, fosforeshente si asnjëherë tjetër. Diçka si klithmë çudie i hapi kraharorin. Vëzhgoi me sy tërë atë hapësirë dhe asgjë të dyshimtë nuk vuri re. Duke u fshehur pas rrasave, u drejtua për nga varret e reja. Një çast ndali në varret e prindërve dhe i përkëdheli. Nuk vendosi asnjë lule, ngaqë do të ishte pakujdesi e pafalshme. Pastaj iu afrua varreve të reja, akoma me dhé të shkrifët, me nga një emër shkruar në dërrasa të thjeshta dhe shpejt shpërndau mbi to të gjitha lulet. Ishte si një spërkatje hëne dhe dashurie bashkë.

Pastaj u kthye në të njëjtën udhë, përkëdheli varret e prindërve, u ngjit në shkallëzat me plisa dhe nxitoi në rrugicën që kishte shtuar mirënjohjen.

Po arrinte pranë shtëpisë, kur nga një dritare, gati ngjitur me tokën, dëgjoi një zë si përsërimë:

- Ej, ndalu pak!

Shtangu nga befasia.

- Cili je ti?

- Eja nga porta, hyrë brenda, - ia ktheu zëri i ngrohtë i burrit në dritaren e vogël.

Epidami, i ndihmuar nga drita e hënës, e njohu fytyrën e "piratit" dhe me shpejtësi kaloi portën gjysmë të hapur. Qamili i doli përpara dhe e përqafoi me mall.

- Ku ishe? - e pyeti.

- Ti e vendosë flamurin? - ia ktheu po me pyetje Epidami.

- Po, unë. Besoj se më njeh.

- Të njoh, të njoh Qamil, po pse qëndrove në qytet, është me rrezik.

- Me rrezik?! Po ti, pse qëndrove?! Edhe një të vdekuri i qëndrojnë njerëz te koka e jo më qyteti të gjallë. Ku ishe?

- Te të vdekurit. U hodha lule mbi varre.

- Mirë bëre. Kishin nevojë. Të ka shkuar mendja bukur.
- Nuk jam vetëm.
- Ashtu? Po kush është tjetër?
- Kam gruan dhe vajzën e paralizuar. Prej saj vendosëm

të qëndrojmë.

Qamili lëvizi me nervozizëm dhe disa çelësa tingëlluan lehtë.

- Atëhere ju duhet të ruheni më shumë se unë. Po të doni ju ndihmoj që të strehoheni në shtëpitë e tjera. Kam çelësat e gati njëqind shtëpive.

Fjalët e fundit Epidamit iu dukën absurde. Si ishte e mundur që një njeri të kishte çelësat e qytetit.

- Po, mos u çudit, kam gati njëqind çelësa që m'i kanë besuar të afërmit.

- Dëgjo Qamil, faleminderit, po hë për hë, nuk është nevoja të ndërrojmë strehim. Ne jemi tre vetë, vajza është e paralizuar e natyrisht do të binim në sy me lëvizjet tona. Vendstrehimin e kemi të sigurt.

- Mirë atëhere. Veç kujdes.

Tani Epidami ia dallonte mirë tiparet, madje dhe mimikën. Mesoburri që kishte përballë ishte bërë i njohur me kundërshtimin e arratisjes.

- Çfarë shikon? - pyeti "pirati" - Gjerdanët që kam në brez e në krah?

- Oh, jo, ashtu kot.

- Thashë se po shikoje gjerdanët. Nuk kanë fishekë. Në vend të fishekëve kam futur çelësat.

- Ashtu!?-ia bëri Epidami.

- Po, çelësat. Që të mos bëjnë zhurmë kur kaloj nga një vend në tjetrin. Të gjithë i kam mbledhur me lecka. Ja, shiko.

Qamili u afrua te dritarja e vogël, poshtë së cilës shtrihej një minder dhe i tregonte të riut çelësat e mbledhura, si foshnje, në këllëfët e gjerdanit të fishekëve. Me atë sy të vetëm tërë dritë, ai i numëronte me rradhë, me një gëzim të çuditshëm, siç

numëron mbledhësi i diamanteve thesaret e tij:

- Ky është çelësi i Zefit, mësuesit. Ky tjetri, i bukëpjekësit; ky i Agos, ja i Pertefit. i Zihniut, i nënë Mclihasë, ky është çelësi i Agim varkaxhiut, çelësi i Stefan hamallit, çelësi i Neptunit, i Demir kosaxhiut, çelësi i Ilmi gazetarit, çelësi i Prokop fotografit...

- I kujt? - e ndërpreu Epidami.

- I Prokop fotografit, e njeh besoj.

- E kam patur mik. Po, atë e vranë gjermanët.

- Ma dha celësin i vëllai. "Merre se duhet", më tha. Nuk ja prisha.

- Shumë mirë ke bërë, Qamil.

- Po ty, si të quajnë?

- Epidam.

- E gëzofsh! Dëgjo këtu, Epidam. Kam nevojë për ndihmën tënde. Mbase edhe të gruas. Kam menduar diçka.

- Çfarë?!

- Nesër në të gdhirë të ndezim zjarre në vatrat e disa shtëpive.

- Po ka rrezik që gjermanët t'i djegin shtëpitë.

- Nuk e besoj. Ata do të ngulmojnë të gjejnë njeriun që vepron. Tymi në oxhaqet flet shumë, - tha "pirati" dhe syri i tij shkëlqeu përsëri si në çastet kur numëronte çelësat. Patjetër që me sytë e mendjes numëronte oxhaqet me tym. Tymi i zjarrit në qytetin me dimër, është jetë.

- Mirë Qamil, nesër në të gdhirë.

- Po të jap çelësat e shtëpive që ti i njeh e që ngrihen në krahun matanë, pranë molit. Çelësat e shtëpive që janë rrotull lagjes "Lule", po i mbaj vetë. Po munda, jot shoqe le të ndez ca zjarre në vatrat e shtëpive këtu rrotull. Na merri dhe jepi këto katër çelësa. I kam mbledhur me lecka apo letra dhe sipër u kam shkruar emrat e të zotërve të shtëpive. Kujdes Epidam.

· Biseduan edhe gjysmë ore. Bënë një plan të hollësishëm për mënyrën si do t'i ndiznin zjarret në vatra dhe pastaj u ndanë.

Komandanti Katzen ndihej i lodhur, tejet i lodhur. Atje në kryeqytet kishte qëndruar gjithë ditën në këmbë. Ku nuk kishte qenë: në komandën e Korparmatës, në Këshillin e Regjencës, madje edhe në burgun e Tiranës, ku ishin përplasur shumë nga banorët e qytetit e të qarkut që ai komandonte. Në Këshillin e Regjencës i thanë se një komision i përbërë nga banorët pa çati, kishin kërkuar lirin nga burgu të qytetarëve. Dang-dang-dang! Ora tingëllonte si gongu në ringun e boksit. Këshilli i Regjencës i kishte përcjellë ata banorë të zemëruar me fjalët: "Nuk mund të bëjmë asnjë veprim, kjo çështje u përket gjermanëve". Dang-dang-dang! Vazhdonte protestën e saj ora e madhe mbi kryet e komandantit Katzen. Pastaj, sipas porosisë së Komandës së Korparmatës, Katzeni kishte dërguar në burg një major, i cili u kishte thënë qytetarëve se gjermanët nuk kanë asnjë faj për burgosjen e tyre, sepse ata kishin bërë thjesht detyrën e policit, sipas urdhërit të qeverisë shqiptare. Të burgosur, siç i tregoi majori, kishin vënë buzën në gaz. Ishte një ironi therëse, e ftohtë, si heje akulli. Dang-dang-dang.

E kishte shumë keq punën me këtë orë të mallkuar, që kishte filluar të tingëllonte, atëhere kur nuk duhej, si për t'ia ndrydhur gjykimin. Çdo tingull i saj i prerë, ishte si një ogur i zi. Një flamur mbi çati. Lule në varret e të vvarëve të fundit. Iu fanit varreza, vërtet e çuditshme, e artë, protestuese. A thua, mendoi ai, të protestojnë dhe të vdekurit. Shtrëngoi tëmthat me pëllëmbë, duke u përpjekur të dëbonte nga mendja një ide absurde: kishin harruar të urdhëronin evakuimin e kufomave nga varret.

Ngriti receptorin e telefonit dhe u lidh me Robertin.

- Alo, Robert, nuk paske rënë në gjumë?

- Oh, jo, herr komandant. Po luaj shah. Po të doni ejani.

- Mirë, po vij. Jam aq i lodhur saqë do të dëshiroja një

mbremje të këndshme.

- Atëherë po përgatis diçka, - u dëgjua zëri i përtejme.

- Më prisni, - tha Katzeni.

Uli receptorin dhe shpejt zbriti shkallët e komandaturës.

Si gjithnjë makina e priste poshtë. Shoferi, në një gjendje përgjumjeje, zuri vend mirë në sedile dhe lëvizi çelësin e shkeli gazin.

- Te Roberti, - i tha shkurt komandanti Katzen, me shikim të ngulur përpara te muret e kështjellës, nga të cilat dukej sikur buronte një dritë e mistershme hëne.

Gurët e shahut në skakierë gjithashtu ishin në një rrëmujë dehjeje. Të dy mbretërit, i bardhi dhe i ziu, ndodheshin pranë e pranë si në një takim armëpushimi. Disa ushtarë puthnin fytyrat inteligjente të kuajve. Kurse oficerët flinin. Vetëm kalatë, si gjithnjë, meditonin.

- Po për hapjen e klubit, u the gjë, Johan?

- Herr komandant, thuaj!

- A u the gjë për klubin, herr komandant?

- U thashë. Madje pranuan ta hapim. Veç jo për orgji, më thanë, po sa për t'u krijuar një kusht lehtësimi oficerëve, sa për t'u çlodhur disi. Mos harro Robert, se jemi në luftë, bile në kulmin e luftës. Operacioni ynë i Dimërit duhet të jetë vendimtar në arritjen e fitores.

- Natyrisht, herr komandant. Dhe ç' thuhet për anglezët, do zbarkojnë?

- Akoma nuk i dihet, Robert, akoma. Ne kemi detyrë të presim.

- Pasesër janë krishtlindjet, herr komandant. A nuk do të ishte mirë që klubin ta përrurojmë në këtë ditë të shënuar?

- A, Krishtlindjet! Do përriqemi Robert. Po meqë më kujtove pashkët, ma çove mendjen përsëri te varreza e qytetit.

- Lëre varrezën tani, herr komandant. Në mëngjes do të

kontrollojnë përsëri dhe çdo gjë do të zgjidhet shpejt. Do të jetë ndonjë aventurier mendjefyell e asgjë tjetër.

- Tani jam i bindur se vërtet dikush vepron në qytet. Vërtitet si fantazmë, ngre flamurin në kulmin e çatisë, vendos lule te të vrrarët e fundit... Do ta gjej sikur dhe në foletë e minjve të jetë fshehur!

- Hajt, gëzuar! - Roberti toku gotën e tij me atë të Katzenit.

- Gëzuar! Gëzuar Robert! Dhe dëgjo, hapjen e klubit po ta besoj ty.

- O, shumë mirë, herr komandant, do të filloj që nesër. Po me çfarë do ta mbushim?

- Problem i thjeshtë. Hë për hë në depon kryesore kemi gjendje të kënaqshme për furnizim. Më vonë dërgojmë një makinë dhe furnizohemi në Tiranë.

- Bukur! - tha Roberti i kënaqur - Si thoni, herr komandant, a vendosim një bredh krishtlindjeje në sallën e klubit?

- Ti je djall i vërtetë, Robert. Vendose, vendose. Me kaq dëshirë sa e ke marrë ti, kam besim se do të bësh një klub modern si në Berlin. Ha-ha-ha! - qeshi me të madhe komandanti Katzen dhe Roberti finok e shoqëronte duke kthyer herë pas here gotën me shampanjë.

- Kurse idenë time për të fjetur te vila e mbretit, komanda e lartë e refuzoi, nuk e di për ç'arsye. Mbase është shumë e ekspozuar përballë detit. Në gjithë atë qytet të boshatisur, më thanë, gjeni një godinë tjetër.

- E po mirë, herr komandant, gjejmë një godinë tjetër. Madje do të ishte e natyrshme që fjetorja e shtabit të ngrihej pranë klubit. Apo jo?

- Tamam, tamam ashtu, Robert. Ti ke ide të këndshme. - tha i kënaqur katzeni dhe shtriqu këmbët pa parë se ato tronditën skakierën me dy ushtritë e përgjumura. Pastaj sikur

u kujtua për diçka, pa orën dhe tha - Vajti vonë. Po marr një sy gjumë këtu e pastaj në të gdhirë shkojmë bashkë në qytet, unë për kontroll, kurse ti për klubin dhe hotelin tonë të dashur. Mirë Robert?

- Mrekulli, herr komandant! Krevatin e keni gati.

Nuk kishin vënë re se jashtë kishte nisur të frynte erë e fortë.

...**KOMENTI I RADIO-LONDRES:** Sot nuk po dëgjohen fjalë mbi fitoren e nazizmit. Edhe Dr. Gebelsi nuk mburret më me fitore, si të tjera herë, po mbështetet në shpresat e fundit, në të papriturat... Konferenca e Teheranit është garancia më e madhe për fitoren e aleatëve dhe për këtë garanton ofensiva aleate në ajër dhe tokë, në frontin e Ruisë dhe në atë të Italisë... Për të mundur t'i arrihet qëllimit sa më parë e me sukses, duhet të mobilizohet çdo energji dhe kjo duhet të bëhet jo vetëm në vendet e lira, por edhe në ato të okupuara nga nazizmi...

KAPITULLI V

TERROR MBI TYMIN DHE EREN

Zjarret duhej të ndizeshin natën, akoma pa zbardhur. Kur sabati në kullë tingëlloi tre herë, Qamili, Epidami dhe Shpresa u shpërndanë në drejtimet e caktuara më parë. Ishin të armatosur vetëm me çelësat, shkrepëset dhe pak dru pishe, për t'i nxitur zjarret në vatra.

Shpresa kishte frikë. Ishte e para herë që dilte nga shtëpia. Kishte nisur një erë e fortë. Oshëtima e dallgëve do t'i ndihmonte për të mbytur zhurmat e zakonshme të kalimit nga

një shtëpi të tjera. Jetën e kishte lënë në gjumë, në shtratin pranë sobës së vogël. Edhe nëse zgjohej, ajo do të zhytej në botën e saj të çuditshme, do të niste lojën e zakonshme me figurat fantastike që i shfaqeshin në tavanin e dhomës-bodrum. Shpresa nuk aktivizohej për të parën herë në luftën ilegale, veç pas fatkeqësisë që i ndodhi së bijës, ajo ishte tërhequr në hallin e saj. Po nuk e kishte harruar luftën. Sepse edhe lufta nuk e kishte harruar atë, njerëzit dhe shtëpinë e saj. I shoqi ishte kthyr vonë nga varrezat dhe ajo e kishte pritur me zemër të ngrirë. Hamendjet e çonin në të papritura të hidhura, në ndodhi të liga. Kishte hapur radion dhe dëgjonte lajmet.

Epidami kishte hyrë i qeshur, duke fërkuar duart, a thua se kishte përpara një mangall me prush. Ajo kishte marrë frymë e lehtësuar. Pastaj ai i kishte folur për takimin me Qamilin, atë detarin e fuqishëm që kishte notuar me mile të tëra përmes detit me tallaze. Ia kishte përshkruar me ngjyra aq të gjalla atë takim, sa që ajo e kishte vizatuar menjëherë "piratin" e veshur me gjerdane çelësash, si një simbol besimi. Flamurin mbi çati e kishte ngjitur pikërisht Qamili. I shoqi kishte vënë lule te varret e reja. Tani të tre duhej të kryenin një aksion tjetër.

Çelësat i kishte vënë në rradhë. Shtëpia ku do të ndizte zjarrin e parë ishte afro treqind metra tej shtëpisë së tyre, në krahun e djathtë të kështjellës, më pranë detit. Ishte shtëpi pa oborr, ndaj e hapi derën dhe hyri drejt e në kuzhinë. Vatra e priste atje, përballë, si e malluar për frymë njeriu. Duhej të gjente ca dru. Kërkoj poshtë një shtrati dhe gjeti disa shkarpa. Shpejt e shpejt i vendosi në formë piramide, ndezi shkrepën dhe e afroi flakëzën në shkarpat e thata, të cilat, si të gëzuara, e rrëmbyen dhe e përhapën në pëllëmbët e tyre. Pastaj mbi to vendosi dy drurë të trashë, që do ta mbanin zjarrin deri në mëngjes. U ngrit, hodhi dhe njëherë shikimin rrotull dhe doli. Tek mbyllte derën, ndiente rrahjet e shpeshtuara të zemrës. mendoi të shoqin dhe "piratin". Mbase dhe ata duhej t'i kishin

ndezur zjarret e para. Vazhdoi rrugën më tej, te shtëpia e Meçajve. Shtëpinë dhe familjen që kishte banuar atje, i njihte mirë. Kishte hyrë në të disa herë në moshën e vajzërisë dhe bisedonte me Hajrien, apo Ritën, siç i thërrisnin shkurt. Rita ishte e bukur, me kaçurela të zeza. Ishte martuar para dy vjetësh në Tiranë dhe që nga ajo kohë Shpresa e kishte parë shumë rrallë, po gjithnjë i kujtonte bisedat me të, ëndrrat e shoqes. Hyri në shtëpi. Shumë gjëra kishin ndryshuar. Instiktivisht bëri ca hapa për nga dhoma e Ritës. Shtyu derën që kërciti përvajshëm. Rita e bukur, me kaçurela, i buzëqeshte që nga korniza. Sikur i thoshte: "shpejt!" ...Kaloj në kuzhinë ku e priste një sobë e vjetër. Me ndihmën e një pische dhe ca drurëve që ndodheshin brenda në vatiën e sobës, zjarri përsëri u ndez shpejt. Shkoi dhe një herë te dhoma e Ritës dhe ia bëri me dorë fotografisë në mur. Zjarri ishte ndezur mirë dhe ajo doli. I kishin mbetur dhe dy çelësa.

Fryn erë, mendonte Qamili. Kështu tyni do të duket më mirë. Për të nuk ishte e vështirë të ndizte zjarre. Duke jetuar i vetmuar, ishte mësuar që çdo gjë ta bënte vetë. Vështirësia qëndronte te kalimi i patrullave. Dhe pse lagjia "Lule" ishte larg, diku në buzë të kënetës, gjermanët duhej të kishin vënë patrulla, veçanërisht pasi kishin zbuluar lulet e vëna në varret e reja, që ai i quante "varret e terrorit". Megjithatë do të përpiquej të mos kalonte në shumë rrugë e rrugica, po të kapërcente gardhet njeri pas tjetrit. Do të ndizte zjarre në gjashtë shtëpi. Po gjashtë zjarre do të ndizte Epidami. Kurse e shoqja e tij, katër zjarre. Gjithsejt: gjashtëmbëdhjetë. Natyrisht shumë pak për një qytet, megjithatë i mjaftueshëm për kushtet e tyre. Iu afrua shtëpisë së parë. Rrotull nuk ndiente asnjë shenjë jete. Vetëm era luante me degët e zhveshura të një kumbulle. Kapërceu gardhin, nxori nga gjerdani çelësin e parë

dhe e hapi portën. "Mirëserdhe!", dëgjoji zërin e largët të të zotit të shtëpisë.

Epidami do të vepronte në zonën rrotull molit, në lagjen "Spirancë", diku pas komandaturës. Rrugën kryesore e kaloi pas pesë minutash ngurrim, sepse larg, diku në godinën e komandaturës, dukeshin siluetat e dy ushtarëve. Vetëm kur siluetat u zhdukën në një kthesë, ai vrapo me sa i hanin këmbët. Për pesë sekonda rruga ishte kapërcyer. Shtëpitë ku do të shkonte i dinte mirë. Në këtë lagje kishte kaluar fëmijërinë dhe kjo moshë fikson në kujtesë shumë fytyra shokësh, oborre, fytyra pleqsh, pemë që e kishin shijuar. Ja çezma e vjetër. Ja furri i bukës. Pak më tutje ëmbëltorja e xha Fatit. Te shtëpia e xha Fatit do të hynte tani. Nxorri çelësin dhe hapi portën. Oborri e njihte, Nxorri dhe një çelës tjetër dhe hapi portën e shtëpisë. Sytë i ishin mësuar në errësirën dhe nuk vuajti për të gjetur sobën e madhe, atë sobë që e njihte dhe që atëhere në fëmijëri ai i kishte dhënë veti çudibërëse, pasi xha Fati bënte në të karamelle dhe kallama sheqeri. Në shtëpinë e një mjeshtri ëmbëlsirash mund të gjelesh fare lehtë sheqer dhe dru zjarri. megjithatë sheqer nuk gjeti. Xha Fati duhej t'i kishte marrë me vete në çatinë e huaj. Madje çudi si nuk kishte marrë edhe sobën. Vendosi drutë në vatër, vuri pishën mes tyre dhe pastaj ndezi shkrepësen.

"Ndizu si për një ëmbëlsirë të madhe!", i foli sobës, mbylli dorezën e saj dhe doli për në pesë shtëpitë e tjera.

Era që frynte nga jugu, e shtoi shpejtësinë. Qielli u vranësua.

Kur hyri Epidami në shtëpinë e tij, Shpresa e priste me

duar të pleksura nga nervozizmi. Ai e puthi lehtë në buzët e plasura dhe të dy, të heshtur, zbritën në dhomën e fshehtë. Tani do të prisnin. Gjermanët dihej se do të zemëroheshin shumë dhe kushedi si do të vepronin.

- Ne e kryem detyrën. - tha Epidami - Ma merr mendja se dhe Qamili do t'ia ketë arritur.

- Kështu besoj, - ia ktheu e shoqja.

Epidami hodhi sytë nga e bija, e cila flinte e qetë. Flakëza e hollë e kandilit vallëzonte lehtë në fytyrën e vogëlushes.

- Më duket më mirë këto ditë, - tha ai.

- Më mirë, vërtet. Duhet t'ia shtojmë mesazhet. Kushedi sa na duhet të presim mbyllur në brodum - tha ajo - Lajmet nuk bëjnë fare fjalë për ndonjë zbarkim në Ballkan.

- Mbase këtu nuk kanë për të zbarkuar asnjëherë - tha ai - Dëgjo tani si vajton era.

Vunë veshin. Era vërtet vajtonte me një kuje të zgjatur, si të shpërthyer nga thelbi i zemrës.

- Sikur dëgjoj krisma, - tha Shpresa.

- Krisma?! Si është e mundur? Mos e kanë zbuluar Qamilin!? Po ngjitem njëherë sipër. Mbuloje kandilin.

- Po e shuaj më mirë.

- Shuaje. M'i jep dhe dylbitë.

Me shkathtësi ngjiti shkallët e drunjta, hapi deriçkën e vogël në tavanin e dhomës së fshehtë dhe u ngjiti. I shoqja i zgjati dylbitë. Nga dritarja nuk shihte asnjë lëvizje patrulle. Krismat duhej të vinin nga hyrja e qytetit. Ishin të thata, të herëpashershme dhe nga klithmat e erës, dukej sikur hapnin plagë në trupin e saj të paformë. Rregulloi dhe njëherë dylbitë. Zemra i rrahu fort dhe fryma gati iu mbajt: tutje, në lagjen "Lule", gjashtë oxhakë nxirrmin tym. Shiritat e tymit valëviteshin në ajër dhe shpërndaheshin të nervozuara. Pas pak dalloj forca të shumta gjermane, të cilat qëllonin mbi tymin, mbi erën.

“Piratin” nuk duhej ta kishin pikasur. Paprimtas krisma të tjera, këtë rradhë në lagjon “Spirancë”.

- Gjermanët kanë filluar kontrollin, - tha ai me zë.

Shpresa, e cila kishte nxjerrë kokën në derën e tavanit, lëshoi një psherëtimë, duke lutur të shoqin të fshiheshin në dhomën - bodrum.

Johan Katzenit i dukej se gjithë ajo erë që frynte ishte një krijim imagjinate, kurse tymi, ai tym i hollë si mëndafsh, me ca kërcime tckanjoze, patjetër ishte pjellë e shampanjës që kishte pirë me Robertin.

Urdhri ishte i prerë: në pesë të mëngjesit, të gjitha patrullat në drejtime të ndryshme do të ushtronin kontroll në lagjet, rrugicat dhe shtëpitë e braktisura. Ngjarja në varrezë... Po tymi? Ç'donte ky tym! Kush i kishte ndezur zjarret në tre drejtime të ndryshme.

- Kontroll! Kontroll! - kishte thërritur Komandant Katzeni me një zë disi të holluar nga britma e zgjatur.

Roberti, që ishte pranë tij, u drodh; asnjëherë nuk e kishte parë në këtë gjendje zemërimi. Tym i oxhakëve kishte çmendur jo vetëm komandantin Katzen, po të gjithë oficerët dhe ushtarët. Patrullat bënëin habi se nuk kishin vënë re asnjë lëvizje dyshuese. Pastaj ky nuk ishte rasti i parë, por i treti. Aksione të çuditshme vërtet, ca lojëra me simbole, po që e irritonin shumë. E keqja ishte se njeriu, apo njerëzit, ishin të padukshëm. Vepronin dhe humbisnin, treteshin.

- Po çmendem, Robert. Po kësaj, ç'i thua?!

- Lajthitje, lajthitje, Joh..., më fal, herr komandant. Patjetër që është ndonjë i krisur. Mos u mërzitni kaq shumë. Kontrolli do të bëhet i imët.

- Më mirë ta kisha qytetin e populluar me njerëz, se sa kështu, foli me vete Katzeni dhe Robertit i erdhi keq për krizën që kalonte miku i tij.

Makina shkoi drejt komandaturës, majtas dhe djathtas

së cilës, oxhaqe të tjerë nxirrnin tymëra, si dufe të brendshme.

- Zjarret duhet të jenë ndezur thuajse në një kohë, - vuri në dukje Roberti, - pra ka mundësi të jenë ndezur nga disa njerëz.

- Mundet, mundet. Eja hyjmë në një shtëpi me zjarr? Po s'e dogja që nga themelet, mos më thënin Johan Katzeni.

Hynë në shtëpinë e mjeshtrit të ëmbëlsirave. Në sobën e madhe zjarri ishte në të shuar. Komandant Katzeni u kthye nga Roberti:

- Një gjë më çudit dhe më duket vërtet absurde: në të gjitha shtëpitë që kemi hyrë jemi detyruar që dyert t'i hapim me plumba. Po zjarrvënësit si kanë hyrë pa lënë një shenjë, pa thyer një xham, pa lëvizur të paktën një tjegull. A nuk të bëhet të besosh se në qytet nuk lëvizin njerëz, po fantazma, djaj, hije të vdekurish. O zot, sa u lodha!

Roberti ia aprovoi mendimet. Si kishte mundësi të ndizeshin zjarret pa u hapur dyert. Ose...

- Vërtet e çuditshme, herr komandant, asnjë portë e hapur asnjë dritare, asnjë...

Që nga ky çast te komandant Katzeni, te Roberti dhe ushtarakët e tjerë, te patrullat, madje edhe larg në garnizonet e vendosura gjatë bregut, nisi të hidhte rrënjë një dyshim e një psikozë masive: në qytet nuk lëvizin njerëz, po fantazma. Po ky ishte vetëm embrioni i legjendës së re, sepse për disa ditë ky dyshim sikur u step nga një ngjarje vërtet e habitshme, por që ndihmoi në qetësimin e nervave të komandantit si dhe fatmirësisht, edhe të njerëzve që vërtet kishin kryer aksione simbolike.

KAPITULLI VI

SHURDHMEMECI MES PELLUMBAVE

Në qytetin e evakuar, veç familjes së Epidamit dhe Qamilit, ndodhej dhe një njeri tjetër, ose më saktë një gjysmë njeriu me emrin Kosta. Ishte një idjot shurdhmemec, i dashuruar pas pëllumbave. Jetonte nën çatinë e një magazine. Në ditën e evakuimit Kosta Pëllumbi (kështu ia kishin ngjitur llagapin qytetarët), ishte trembur nga lëvizja e madhe e njerëzve të shoqëruar nga ushtarët e armatosur dhe që fshehur nën çatinë e magazinës, në një qoshe larg kthinės ku ai banonte. Kuptohet se gjermanëve, madje as spiunëve, nuk u kishte shkuar mendja te idjoti Kosta Pëllumbi. Ishte një gjysmënjeri që më tepër nuk binte në sy. Kishte dëshirë të jetonte i fshehur, të flinte e dremiste pranë pëllumbave, të zhgaraviste ca pusulla të çuditshme, të cilat ua lidhte në këmbë pëllumbave postierë. Banorë të ndryshëm, shumica fëmijë e adoleshentë, i gjenin pusullat të shpërndara nëpër zonën aty rrotull, nën hapësirën ku fluturonin pëllumbat, që natyrisht nuk ishin postierë. Thonin se këto pusulla ai ia dërgonte diellit, hënës, yjeve, Çezarit, Pompeut, reve, shiut, erës, Badolios, anijeve, shteteve, avionëve bombardues, Hitlerit, Gëringut, bananeve, murgjve budistë, Zeusit, ylberit, mamuthëve, ëngjëjve, Adamit dhe Evës, sheikëve, perandorit kinez Pu Ji... të gjallëve e të vdekurve, kafshëve dhe shpendëve. Njëherë kishte pasur një fizarmonikë të vogël shkatarraqe, por dikush ia kishte vjedhur dhe për një javë Kosta i giorë kishte qarë me ca lotë rrëshinorë, vetëm me lotë, pa zë. Pas vjedhjes së fizarmonikës ishte dhënë i tëri pas pëllumbave. edhe shpendët fisnikë e donin zotin e tyre.

Në ditët e evakuimit, para se të ndodhte kontrolli i nazistëve në shtëpitë me zjarre, Kosta Pëllumbi i lehtë si pupël, kish arritur të jetonte pa rënë në sytë e në veshët e pushtuesve, i mbrojtur nga dashuria pëllumbore. Në fillim kishte jetuar me ç'të mundëte, sepse tani nuk e ndihmonte askush, as komshijtë, as fëmijët, as të lypurit nëpër dyqane. Pastaj kishte mbetur pa pikë ushqimi, ndaj ishte detyruar të hante pëllumbat e tij, ata që i rrinin Kostës disi më larg. Mirëpo, megjithëse pëllumbat e mençur ia kishin kuptuar hallin Kostës së tyre, nuk pranuan të bëheshin theror për të, ndaj dalëngadalë e braktisën. Kjo ndodhi pikërisht dy ditë para terrorit nazist mbi tymin e oxhakëve. Atëhere Kosta ra i sëmurë në shtrat, i mbuluar me të gjitha rrobat që përbënin varfërinë e tij. Bëri një gjumë të gjatë e të thellë idjoti. Vetëm në mëngjesin e terrorit mbi tymin, ai u zgjua nga zhurma e zorrëve të uritur, e vetmja zhurmë që ndiente shurdhmemeci. U zgjua dhe nisi të kërkonte më kot nën çatinë e magazinës. Edhe pëllumbat, ishin më tutje, në çatitë e tjera. Pikërisht duke pasur shikimin e fortë, (teoria e kompensimit të shqisave edhe te ky i mjerë kishte vepruar me bujari), që nga çatia e magazinës Kosta Pëllumbi kishte pikasur tyme oxhaqesh. Tyme... Një gëzim i çuditshëm e kishte pushtuar të tërin, kishte bërë disa kollotumba nën çati, e pastaj me një gjallëri vërtet të habitshme, gjithnjë duke menduar se në qytet ishin kthyer disa nga banorët, shurdhmemeci idjot kishte rendur nga njëra çati në tjetrën, duke u bërë shenja pëllumbave të tij. Ishte mëngjes me erë të fortë, po ai nuk pyeste për erën, ishte tepër i shkathët. Vetëm një gjë kishte harruar: nazistët.

Të tërbuar nga tymi i gjashtëmbëdhjetë oxhaqeve, gjermanët me në krye komandantin, deshën ta shoshisnin të gjithë qytetin për të gjetur zjarrvënësit. Kështu që sapo Kosta Pëllumbi kishte kapërcyer çatitë e para, gjermanët e kishin parë dhe kishin rendur pas tij. Askush nga nazistët nuk e njihte të çmendurin, madje ajo ikja e tij nëpër çati, çdo ushtari i krijonte

bindjen se pikërisht ky njeri i shkathët, që shoqërohet nga pëllumba fluturakë, patjetër duhej të qe zjarrvënësi.

Johan Katzeni dhe Roberti, shqyen sytë të habitur kur panë njeriun që vraponte mbi çatitë e shtëpive, që zbriste e ngjitej përsëri.

- Ai është. ai! - kishte pëshpëritur si në ethe komandanti Katzen - Ta kapim të gjallë!

Më në fund Kosta Pëllumbi i kishte vënë re lukunitë e ushtarëve, donte të vraponte edhe më, por e ndiente se forcat po i shteronin. Gëzimi i të uriturit tani ishte zhgënjimi më i hidhur. Dhe në një çast, kur shumë pranë një çifti pëllumbash, shurdhmemeci u bë gati të zbriste, një tjegull e vjetër rrëshqiti e bashkë me të, u rrokullis e u përplas në oborr edhe Kosta Pëllumbi. Kishte vdekur.

Këtë skenë jo të zakonshme, pëllumbat me sytë e tyre të butë e kishin ndjekur tërë ankth. Shumë çifte i kishin fluturuar pranë si për ta ndihmuar ikjen e tij, por nuk kishin arritur ta pengonin rrëzimin e idjotit të rraskapitur. Tani, rreth kufomës së rreckosur, u mblodhën pëllumba të hirtë, të bardhë e të kuqërremtë, me solemnitetin e vajtojçave. Pas pëllumbave mbërritën gjermanët. E kthyen Kosta Pëllumbin me fytyrë nga qielli, po nuk vunë re asnjë shenjë jete. Pëllumbat ndiqnin skenën me vështrimet e tyre të kadifenjta.

Komandant Katzenit i erdhi keq që nuk e kapi zjarrvënësin të gjallë, sepse patjetër do të mësonte shumë gjëra prej tij. I thanë se të porsavdekurit nuk i gjetën asnjë dokument. U afrua dhe e tronditi ajo fytyrë e verdhë, e parruar dhe ata sy të hapur, në retinat e të cilëve ishin fiksuar të ngrirë pëllumba, vetëm pëllumba. Kjo e tmerroi komandantin. Megjithatë ai qetësisht iu drejtua njerit prej oficerëve:

- Të merret vesh se cili është ky njeri. Të sillen ndonjë spiun i regjur i qytetit. Të mos varroset pa u identifikuar. Në zonat e tjera të qytetit vazhdonin kontrollet.

Komandanti kish urdhëruar të mos digjej asnjë shtëpi, e para sepse ky do të ishte një veprim idjoti, njëlloj si Kserksi i Persisë kur kishte kamxhikuar detin e pafajshëm dhe e dyta, sepse do t'u duhej një punë shumë e madhe të shuanin zjarret në këtë mot me erë. Me gjetjen e Kosta Pëllumbit të paidentifikuar, edhe terrori mbi tymin dhe erën kishte marrë fund. Qyteti ra përsëri në qetësi. Kurse era e fortë vazhdonte të frynte nga Jugu.

KAPITULLI VII

ÇFARE SHIHET DHE NUK SHIHET ME DYLBË

Ushtarët kishin kaluar dhe në rrugicën e tyre. Të shtënat kishin shqetësuar Jetën e vogël, e-cila vazhdonte të shikonte në tavanin e dhomës së fshehtë me një kureshti të veçantë, a thua se kishte përballë një ekran kinemaje. Shpresa shtrëngonte krahun e të shoqit me një forcë të çuditshme.

- Mos u frikëso, - e kishte qetësuar Epidami - do të kalojë, patjetër do të kalojë.

Gjermanët nuk kishin arritur deri lart, te shtëpia e tyre. Si papritur krismat në këtë anë ishin ndërprerë. Diçka me rëndësi duhej të kishte ndodhur. Çifti dihaste nga frika. Pastaj zhurmat ishin fashitur dhe vogëlushen e kishte zënë gjumi.

Gjysmë ore pas pushimit të krismave, Epidami, dhe pse e shoqja e kishte kundërshtuar, vendosi të ngjitej në dhomën lart e të vëzhgonte se çfarë po ndodhte. Mori dylbitë dhe u ngjit. Frika se mos kishte ndodhur gjë me Qamilin ia kishte mpirë gjymtyrët. Vuri dylbitë para syve dhe u përpoq të kapte sa më shpejt të gjithë qytetin që shtrihej në këmbët e kodrës. Shikimin e ndali thua se përballë dritares, në shtëpitë që ngriheshin në krahun e djathtë të komandaturës. Disa ushtarë

bënin roje në një shtëpi me oborr. Në mes të oborrit dukeshin këmbët e një njeriu të shtrirë. Fytyra e të shtririt mbulohej nga një qoshe avllie. Mirëpo në oborr, në muret e avllive rrotull, në çati, mbi pemët e zhveshura, kishin qëndruar me dhjetra pëllumba, a thua se i shtriri të ishte ai, Kosta Pëllumbi, historitë e të cilit me tekstet e pusullave, e kishin bërë të qeshte edhe Epidamin. Mendimi se ai trup i shtrirë ishte kufoma e Qamilit, binte poshtë edhe nga që "pirati" kishte vepruar thuajse në krahun e kundërt të qytetit dhe ishte më e arsyeshme të qe fshehur aty rrotull, megjithatë ekzistonte dhe mundësia që Qamilin ta kishin kapur e ta kishin sjellë në zonën ku ishin ndezur zjarret e tjera.

Trupi vazhdonte të rrinte shtrirë. Pëllumbat qëndronin si të hutuar. Ushtarët me automatikët krahëqafë bënin roje para shtëpisë dhe brenda në oborr. Epidami ktheu dylbitë më djathtas, nga moli. Në rrugën kryesore po kalonte makina e vogël e komandantit. Makina ndali pranë ndërtesës dykatëshe, e cila para kapitullimit të Italisë ishte e vetmja shtëpi publike e qytetit. Komandanti dhe një ushtarak tjetër zbritën nga makina, shtynë portën e hapur të asaj godine dhe hynë brenda në të, natyrisht jo me pamje klientësh të rëndomtë. Mbase kërkojnë të fshehurit e tjerë, mendoi Epidami.

- Çfarë po sheh? - e pyeti e shoqja.

- Shtëpinë publike - u përgjigj ai.

- Çfarë!? - u habit ajo - Mos bëj shaka tani.

- Natyrisht që nuk bëj shaka. Komandanti i qytetit dhe një oficer tjetër, sapo hynë në shtëpinë publike.

- Atëhere diçka kërkojnë, - tha ajo. - Po me kufomën çfarë po bëjnë?

- Asgjë. Ja, merri dylbitë dhe shikoji vetë.

Ja zgjati dylbitë së shoqes. Shpresa e ndali shikimin te oborri me pëllumba dhe me roje që ruanin kufomën.

- Po çfarë presin kështu? - ia bëri ajo - Pse nuk japin urdhër ta varrosin.

- Kërkojnë të tjerët, - tha ai.
- S'ma merr mendja. Të tjerët nuk kërkohen pa lëvizje e aq më pak në atë shtëpinë e qelbur.
- Kushedi si janë punët - tha ai - Po ne më mirë zbresim poshtë dhe presim.
- Mirë, zbresim. Lart duhet të ngjitemi sa më rrallë, sa më rrallë.
- Epidami nuk foli.

Robertit i lindi ideja që për fjetorë të oficerëve madhorë të shtabit të komandës, të përdomin ndërtesën e bukur dykatëshe, e cila më parë kishte qenë shtëpi publike.

- Eshtë luksoze, herr komandant, me shtretër të rehatshëm, me vaska banje, në afërsi të bregut. Eja të hyjmë shohim njëherë.

Johan Katzeni kishte rrudhur buzët, megjithatë kishte pranuar ta shihte ndërtesën nga brenda. Nuk i pëlqente që shtabi i tij të strehohej në një ish shtëpi publike. Ata ishin oficerë të Rajhut, një ushtri e moralshme dhe sipas tij, ky fakt do të kishte një tingëllim anekdotik. Po para kujt? Ia tha këtë mendim Robertit, por pa pyetjen. Por miku i tij finok ia ktheu me zgjuarsi:

- Tingëllim anekdotik?! Po para cilit? Ne, ose më saktë shtabi do të flejë këtu disa javë. Unë them se nuk ka ndonjë të keqe, madje vetëm të mira: komoditet i nevojshëm, ngrohje me kaloriferë njëlloj si atje lart, në vilën e mbretit.

Katzenit po i pëlqente kjo godinë me dhomat e rehtashme. Megjithatë se si i dukej, një fyerje të jetonte këtu, në krevatet ku dikur...

- Jo, jo në asnjë mënyrë nuk do të vendosni këtu. Mund të ishte një vend i përshtatshëm për ushtrinë që kapitulloi, kurse për ushtrinë e Rajhut, kjo do të ishte vërtet anekdotike.

- Po qyteti pa njerëz...

- Në asnjë mënyrë!... Nuk e ndien aromën e livandos që të shpon hundët, megjithëse ka kaluar kaq kohë nga mbyllja e kësaj shtëpie? Pastaj si mund të bësh rehat në një shtrat ku dikur janë përpëlitur trupa në spazmë, në orgazmë... Jo, jo, absolutisht jo!

Roberti nuk kishte kundërshtuar, megjithëse nuk i vinte mirë që miku i tij vuante nga ca komplekse të çuditshme.

- Atëherë, herr komandant, vendosni që të flini në hotelin pranë klubit.

- Ashtu do të bëhet. Dhe pse në kushte më të thjeshta, do të vendosemi në atë hotel. Po të paktën nuk do të biem era livando e nuk do të shohim ëndrra lakuriqe, - bëri shaka Johan Katzeni dhe Roberti ia plasi të qeshurit.

I hipën përsëri makinës.

- Mezi pres të vijë agjenti që do të identifikojë të vdekurin - tha Katzeni - Do të sjellin atë spiunin e regjur, Servet Dackën. E di, Robert? Një qytet edhe i boshatisur të jetë, paska nevojë për agjentë.

- Ashtu siç ka nevojë për klube, për femra, për këngë, për zhurmë, për xhama që thyhen. - ia ktheu tjetri.

- Mjaft me këto dokrra, Robert! Ja, arritëm edhe te klubi.

Klubi, kinemaja dhe hoteli ndodheshin shumë pranë njeri tjetrit, aq sa Katzeni i tha vetes e pastaj Robertit, se që në fillim duhej të kishte vendosur që shtabi të banonte këtu. Nuk hynë brenda në klub, pasi dy ushtarë me zorrë uji në duar po pastronin dyshtemenë.

- Kam porositur që të sjellin edhe një bredh - tha Roberti - Krishtlindjet do t'i festojmë, apo jo?

- Ma merr mendja se po. Kuptohet, thjesht, pa bujë. Megjithatë nuk i dihet ç'na sjell dita e nesërme. Operacioni ynë i Dimrit sapo ka filluar.

- "Gjenerali Dimër", - shtoi Roberti.

- Po, Gjenerali Dimër, - ia ktheu ftohtë Katzeni.

Roberti ishte i zgjuar dhe kishte ditur të bëhej një hije e këndshme e mikut të tij, ish dirigjentit të orkestrës së Nurenbergut. I njohur si qejfli, hokatar, ai kishte arritur të fitonte zemrat e shumë eprorëve e natyrisht gati të të gjithë vartësve. Jo më kot ai kishte bërë i pari propozimin për hapjen e klubit. Vërtet garnizonet e tyre prisnin zbarkimin e trupave armike, por të lodhur nga lufta e gjatë, shumë prej ushtarakëve të Rajhut e veçanërisht ushtarëve, u kishte ardhur shpirti në majë të hundës. Nguljen e garnizoneve në këto brigje, ai e kishte quajtur njëlloj pushimi. Sepse nuk ishte e lehtë në këtë dimër, kur në male kishte nisur cingërima, të përballoje gjithë ato marshime e beteja. Kurse këtu, në brigjet e buta, në një zonë të papopulluar, edhe dimri do të ishte më i shtuar, edhe ngacmime të partizanëve nuk do të kishte. Këto Justëra me simbole që komandantin e tij e irritonin më shumë se sa duhej, Robertit i dukeshin si disa kapriço fëmije. E ç'ishin një flamur, ca lule e pak zjarr. Një hiçasgjë, i dashur Johan Katzen, herr Johan, herr Katzen, herr dirigjent i orkestrës së Nurenbergut apo i orkestrës së ferrit. Herr-ferr! Asgjë! Kurse një klub, një mbrëmje e këndshme e pse jo edhe gjumi i rehatshëm në një shtëpi publike me aromë livandoje, këto ishin gjithçka, disa simbole më me vlerë për jetën e tyre, për shëndetin e ushtarakëve.

Komandanti Katzen dha urdhër të pastrohej edhe hoteli me sallën e kinemasë. E kishte marrë malli të shihte ndonjë film me Greta Garbon e Herri Kuperin. Dhe iu kujtua përsëri një natë e bukur maji kur bashkë me të fejuarën, Anën dhe motrën e saj, Helgën, kishin shkuar në kinema për të parë një film sentimental. Në mbarim të filmit Ana kishte qarë, kurse ai dhe Helga qeshnin me lotët e saj. "Budallaqe! Budallaqe! Budallaqe! - i thoshte e motra, për një histori të tillë gjynah të qash...". Atëherë Ana, me atë karakterin e saj të ndjeshëm, por edhe të fortë, kishte kërcyer papritur: "Po përse më sollët në kinema, që të luaj symbyllazi?!" ...Symbyllazi...

- Pse qesh? - e pyeti Roberti.

- Ah, jo, ashtu kot. M'u kujtua diçka që ka ngjarë para shumë vjetësh...

- Edhe mua më kujtohen shumë ndodhi. - tha Roberti - Mëjje disa herë kam dëshirë t'i kujtoj vazhdimisht. Kujtimet qenkan përsëritëse për njeriun si tema në një vepër muzikore.

- Ashtu vërtet, - tha gjoja ftohtë Johan Katzeni dhe bëri mbrapakthehu për të dalë nga salla e kinemasë.

Spiuni Servet Dacka erdhi mbasdite. Komandanti kishte çuar ta merrnin me makinë. Ishte një burrë rreth të dyzetëepesave, i shkurtër, flokërrënë, me një bark të kërcyer pak si para kohe. Kishte dy sy të qullët, që dukej sikur shikonin vetëm pjerrtazi e që bashkëbiseduesit i krijonin përshtypjen se ai, për çdo mendim, merrte pëlqimin e një të treti të padukshëm, që ndodhej ngjitur me ta.

E çuan drejt e te kufoma. Rrugës i kishin dhënë pak sqarime dhe ai e kishte kuptuar se i vdekuri ishte Kosta Pëllumbi. Megjithatë nuk e kishte hapur gojën, jo për t'i dhënë më shumë rëndësi vetes, por për të bluar më mirë se çfarë mund të kishte ndodhur në të vërtetë. Sapo hyri në rrugicën ku gjendej viktima, Servet Dacka ngriti kokën dhe vështroi çatinë e magazinës, ku dikur strehohej idjoti shurdhmemec. Ai duhet të ketë kaluar këtej, mendoi, në shtëpitë e ulta që i kanë çatinë gati ngjitur.

Zbritën nga makina. Që nga porta e hapur e oborrit Serveti e njohu idjotin Kosta. Po ky njihet që është idjot, tha me vete. Tani nuk dinte të zgjidhte tonin, mënyrën për të shprehur identifikimin e kufomës. Si t'u thoshte gjermanëve që e prisnin: "Është një idjot shurdhmemec. Është Kosta, Kosta Pëllumbi, një i çmendur i rëndomtë, që nuk di t'i ketë bërë keq asnjëri". Apo: "Ky njeri, me sa di unë, ka qenë i lajthitur dhe nuk është përzier aspak me politikë. Megjithëse, megjithëse në realitet

thonë se në pusullat që u vinte në këmbë pëllumbave ka patur letërkëmbim edhe me Hitlerin e Badolion, madje edhe me Çezarin, mirëpo, mirëpo...". Iu kujtua se edhe kryetari i qeverisë kuislinge, i kishte nisur telegram Hitlerit, ku e siguronte se do ta ndihmonte në luftën e tij fisnike.

- E njihni? - e pyeti oficeri që e shoqëronte.

- Eh, po, po, natyrisht e njoh. Njeri i parrezikshëm.

- Si?! I parrezikshëm?!

- Eshhtë shurdhmemec. Duhet të ketë mbetur rastësisht në qytet.

- Pastaj?...

- Nuk ma merr mendja të ketë vepruar ky njeri, veçse...

- Veçse çfarë? - pyeste oficeri.

- Veçse në qoftë se është hequr idiot... megjithëse...

- Megjithëse çfarë?!

- Megjithëse ai kështu, domethënë idiot ka qenë gjithë jetën, që fëmijë. Jam i sigurt, zoti oficer, se ky njeri...

Servet Dacka, i mbuluar me djersë, e ndërpreu fjalën.

Po binte brenda me këmbët e tij, sepse në qoftë se atë flamur, ato drej lule dhe ato palo zjarre nuk i kishte vënë ky idiot i vdekur, atëhere cili, cili do t'i kishte organizuar? Gjermanët kishin ushtruar kontrole të imëta dhe nuk kishin gjetur asnjë shenjë. Mos vallë i duhej të thoshte të kundërtën, pra që ky njeri i shtrirë para tij, edhe mund t'i kishte kryer ato aksione që në njëfarë mënyre ishin pa zarar, madje, nuk kishin pothuajse asgjë armiqësore...Asgjë armiqësore?! Hë Servet Dacka, Servet Dacka, dhe ma mban veten ujk të regjur. Armiqësore, bile tepër armiqësore!

- Më çoni te komandanti, zoti oficer.

- Mirë. Hipni në makinë.

Tapi kishte kohë që për pak minuta të bluante më me gjakftohtësi se çfarë do t'i thoshte komandantit të qytetit. Më mirë t'i hapte letrat pa hile. Duhej të dyshohej se në qytet mund

të vepronin të tjerë. Këtë dyshim e përforconte fakti që, siç i treguan pak më parë zjarret ishin ndezur në tre lagje shumë larg njera-tjetrës. Pastaj, zoti komandant e dinte se ky qytet prandaj dhe u boshatis, që të mos kishin ngacmimet e njerëzve në prapashpinë. Bile, ju e dimi zoti komandant, se për bastisjen e qytetit dhe për terrorin nuk u kërkua ndihma e bashkisë, e xhandarmërisë dhe policisë së qytetit, sepse edhe në këto vende... Natyrisht unë s'jam "një i tyre", sepse unë dhe tim nip e përplasa atje larg, në kampet e përqëndrimit. Fshiu përsëri ballin nga djersët e ftohta. Nuk e mendoj se vdekja e Kosta Pëllumbi do t'i sillte kaq telashë. Po ç'dreqin kishte! Çdo gjë ishte e thjeshtë: ky, zoti komandant, është një i sëmurë psikik, s'ma merr mendja që në këto aksione të jetë dora e tij. Po të doni ju, unë qëndroj disa ditë në qytet dhe mbase zgjidhim diçka dhe i zbulojmë ilegalët. Kështu do t'i thoshte, më se e logjikshme.

Komandanti e priste në zyrën e tij, lart në ish ndërtesën e Bashkisë. Oficeri që e shoqëronte trokiti në derën e komandantit. U dëgjua "hyrë" dhe për katër sekonda Servet Dacka e pa veten të ulur përballë fytyrës disi të hequr të Johan Katzenit.

- E patë kufomën? Çfarë mendimi keni?

- Kufoma, zoti komandant, quhet Kosta. Llagapin qytetarët ia kishin vënë Pëllumbi, ngaqë jetonte vetëm me pëllumba.

- Ka qenë idiot?!

- Si urdhëron zoti komandant. Madje një idiot i parrezikshëm.

- Si ka mundësi?! Po ai, ai vraponte nëpër çatitë dhe oborret si një i çm..., domethënë si një njeri që donte t'i shpëtonte....

Edhe komandantit i ishin lidhur e bërë nyje mendimet, ngaqë ishte kapur në befasi nga fjalët e spiunit të vjetër. Po kjo

ishite qesharake: një idiot!

- Unë mendoj, zoti komandant, se në qytet duhet të ketë njeri tjetër veç atij... Mbase dhe mund të jenë lenë nga komunistët, mbase kanë qëndruar në kokë të tyre, por ma merr mendja se duhet të ketë.

- Po ne kemi kontrolluar dhe sot në mëngjes kapëm vetëm atë, pëllumbin idiot, - tha me një mlllef të veçantë komandanti Katzen - Mirë atëherë zoti Dacka, ju do të qëndroni këtu në qytet disa ditë.

- Pranoj megjithëqejf, zoti komandant, megjithëse dhe atje në Tiranë punët janë të shumta.

- Me ata të Tiranës flas unë. Sepse, nuk është e arsyeshme që në qytetin e evakuuar të veprojnë ilegalë. Madje kjo është luftë e hapur dhe unë nuk mund ta lejoj!

Dang-Dang-dang-dang-dang!

Ora ishte pesë. Jashtë ishte ngrysur. Komandanti Katzen i kishte shpëtuar përsëri pa e parë perëndimin e diellit.

- Vend për të fjetur ka kudo. - foli përsëri Katzeni - Po të doni mund të flini te ajo ndërtesa, që dikur ka qenë shtëpi publike.

Servet Dacka u kollit.

- Do të flini rehat. Kushtet i keni mjaft të mira.

- Mirë, zoti komandant. pranoj. - tha i lehtësuar agjenti dhe doli duke nderuar alla hitler.

Era kishte pushuar. Retë e shumta ngjyrë gri qëndronin pezull. Filloi një i ftohtë i hidhur. Servet Dacka nuk kishte guxuar t'i kërkonte komandantit të flinte në shtëpinë e tij. Dhe mbase kishte bërë mirë. Kështu do të ruante edhe kokën, edhe shtëpinë. Pastaj edhe plaçkat e domosdoshme nuk i kishte. Ndërtesa e shtëpisë publike ngrihej buzë rrugës kryesore, kontrollohej nga patrulla, kurse shtëpia e tij ishte thellë, rrëzë mureve të kështjellës. Vendosi të kalonte njëherë nga shtëpia e t'i hidhte një sy. Këmbët e çuan shpejt në kështjellën

buzëdetit. Rrugës, formalisht e ndalën dy patrulla, po ai, gjithashtu formalisht, u tregoi dokumentet dhe vazhdoi rrugën.

Shtëpia ishte e qetë, e shurdhët, e struktur nën peshën e reve dimërore. Nxori çelësin dhe hyri brenda. Sipas porosisë të së shoqes, hapi dritaret për ajrosje. I dukej sikur nuk do të ktheheshin kurrë në këtë shtëpi. Hyri në dhomën e gjumit, hapi dritaret, kontrolloi dollapin dhe disa robe verore të varura në kremastare. Edhe pse e braktisur, shtëpia i solli një çlodhje të përgjithshme. Por jo sigurinë, mendoj Serveti. Siguria e tij kishte humbur. Tani toka i dridhej nën këmbë. Veçanërisht këto ditë pas evakuimit të qytetit, e kishte patur të vështirë. Banorët kudo ku kishin shkuar, kishin gjetur ngrohtësinë e vatrave.

Më mirë që do të kalonte ca kohë në vendlindjen e tij, megjithëse të boshatisur. Falenderoi një çast Kosta Pëllumbin, identifikimi i të cilit e kishte sjellë në qytet. Mirëpo nuk e kishte të lehtë. Duhet të gjente gjilpërën që lëvizte në një fushë me kashtë. Nuk e ke të lehtë Servet Dacka, aspak të lehtë. Dhe më e keqja do të jetë sikur ato aksionet e vogla t'i ketë bërë vërtet ai Kosta Pëllumbi, ose ndonjë tjetër që mbase mund t'ia ketë mbathur me varkë përmes kënetës... Këto hamendje dyshuese patjetër duhej t'ia kishte thënë, ose të paktën t'ia thoshte nesër komandantit. Jo, jo në asnjë mënyrë, jo! Ej, drejt, ç'po i pillte belaja! Instiktivisht nisi të mbyllte dritaret, duke sharë nëpër dhëmbë atë Kosta Pëllumbin, i cili e solli këtu në qytetin që asnjëherë nuk e kishte dashur, veç në fëmijëri, kur nuk merrej me politikë. Pastaj nisi të çonte nëpër mend disa nga ata të rezistencës që kishin shpëtuar pa u terrorizuar. Cili prej tyre mund të kishte mbetur? E kishte të pamundur të fiksonte diçka.

Arriti te shtëpia publike, e cila pas ikjes së italianëve kishte mbetur pa jetë, si t'ia kishte rënë murtaja. Hyri brenda dhe instiktivisht ngjiti shkallët për në katin e dytë, në dhomën 13, ku dikur edhe kishte qenë klient i Loretës, ose si i thoshte

me përkëdheli "Fiore d'amore". Loreta ishte një italiankë e bukur, brune me ca sy të mëdhenj si bajame. Hapi derën dhe shtypi çelësin e dritave. Një mi i vockël vrapoi i trembur dhe u fsheh në një vrimë në qoshe të dhomës. Qeshi me pahir. Dikur Loreta e kishte pritur me buzëqeshje, me ëmbëlsinë e saj të njohur, me një veshje fërgëlluese, plot elegancë dhe e pshore njëkohësisht. Kurse tani, prostituta sikur kishte pësuar një metamorfozë dhe ishte kthyer në atë miuk të pështirë, që fshihej i trembur nga ai, Servet Dacka. U shtri në krevatin dopio, ku mbase i duhej të flinte disa ditë dhe as vetë s' e kuptoi si i doli një psherëtimë që shpesh përcakton një psikologji të çastit, apo një filozofi të tërë:

- Sa shpejt u rrokulliskan vitet, shtetet, fatet!

Në atë psherëtimë padashur kishte nxjerrë edhe gjithë atë hidhërim e frikë që e gryente prej disa orësh. Ndjen një aromë të lehtë livandoje, iu kujtua përsëri "Fiore d'amore" dhe qetësisht, si me magji, u zhyt në një gjumë të ëmbël.

Natën vonë, tepër vonë, Qamili u kthye në dhomën e tij, lart në lagjen "Kala". Hoqi gjerdanin me çelësa dhe nisi të fliste me vete:

- Të poshtërit! Kanë sjellë atë spiunin me damkë, Servet Dackën. Pësk do ta kemi tani. Do të vërtitet në qytet si hija e këtyre nazistëve. Qeni!

U shtri në minderin ngjitur me dritaren e vogël dhe me shikim nga qielli kujtoi dhe një herë tërë heqjet e asaj dite. Kishte shpëtuar për mrekulli. Patjetër që dhe Epidami me Shpresën e kishin kapërcyer rrezikun. E kishte pësuar vetëm i gjori Kosta.

Syri po i xixëllonte, e po i vishej me ca flutura të bardha. E fërkoj syrin e gjallë, po prapë xixëllonjat e bardha nuk pushonin. U afrua pranë xhamit dhe pa se tej dritares frymonte

dëborë. Ishte një dëborë e butë, e butë, sikur kërkonte të merrte me të mira qytetin e egërsuar.

U mbulua me një velenxë të trashë dhe e zuri gjumi.

Nga lajmet në radio:

...Nën admirali Ferral, kryetari misionit detar francez në Shtetet e Bashkuara, deklaroi se pak ditë më parë, disa anije franceze luftime, fundosën gjasthtë anije të një karvani gjerman në detin Adriatik.

...U vërtetua se tetë aeroplanë sulmues gjermanë, u shkatërruan mbi Angli gjatë natës së mbrëmshme.

...Punohen tabute dhe kurora artistike për të ndjerët. Mjeshtrat specialistë kërkojnë çmime të arsyeshme.

...Komiteti për ndihmën e të mjeruarve nga lufta ju bën thirrje për të ndihmuar qindra banorë të qytetit të evakuar, të cilët janë përplasur ku të munden, sikur s'janë njerëz po zogj qyqeje.

...Kinema "Nacional" shfaq superfilmin muzikor "Gruaja është e lëvizshme" me Loreta Jung.

KAPITULLI VIII

KRISHTLINDJET

Garnizonet gjermane shtriheshin gjatë bregut që nga Kepi R. deri në Shkëmbin K. Vëzhgonin detin në pritje të

zbarkimit të mundshëm. Frynte erë shumë e fortë. Edhe të ftohtit ishte i hidhur.

Ushtarët, nënoficerët dhe oficerët diskutonin rreth lajmeve që jepte radioja si dhe ato pak gazeta që arrinin të vinin. Mendohej se Anglia nuk do të bënte sakrifica gjaku, ndaj dhe mbase zbarkimi i tyre në Ballkan e në këto brigje, ose do të shtyhej, ose nuk do të bëhej fare. Beteja detare e Sicilisë e kishte dëmtuar flotën e tyre në këtë zonë. Buzët, sytë dhe veshët e garnizoneve thithnin lajmet që lidheshin me beteja detare. Këto lajme luanin rolin e melhemit mbi plagën e maisur.

“Vazhdimi i luftës detare tregon se Gjermania, paralelisht edhe Japonia, kanë një prirje të favorshme në këto dy pika: e para, nëndetëset kanë filluar sulmet e tyre në të gjitha detrat dhe e dyta, aeroplanët torpilues dhe bombardues gjermanë e japonezë, jo vetëm mbrojnë brigjet që zotërojnë, por sulmojnë edhe larg nëpër dete”.

Lajme si këto i qetësonin disa, u kthenin ndjenjën e humorit për të cilën kanë shumë nevojë ushtarët. Po lajme të tjera rrëzonin në çast ndërtesat e vogla prej kristali.

Nga një pikë vendqëndrimi në tjetrën, pëshpëritej se në qytet, megjithëse i boshatisur, nuk kishte qetësi. Thonin se lëviznin hije të vdekurish, që me një logjikë të gjalli, dinin të vepronin. Në biseda përflitej edhe zemërimi i komandantit Katzen, i cili më tepër se me inspektimet në bregdet, ishte marrë me shërbimet në kryeqytet dhe kontrollet në qytetin e evakuar. Ushtarët, nënoficerët, madje dhe oficerët diskutonin në mes tyre nëse do të kishte apo jo zbarkim të anglezëve. Shumica besonin se jo, Ndiqnin me një etje të zhuritur lajmet nga të gjitha frontet, propagandën e Gëbelsit dhe antipropagandën e Antantës, bënin balancime në disa peshore të sakta që në ushtritë e luftës kanë si masë matëse plumbin e vdekjes, dhe nxirrnin konkluzione të ndryshme, shumica të përafërta: do ta kishin tepër, tepër të vështirë. Fati i kishte sjellë

në këtë cep të Ballkanit, në një vend me shumë male e gurë e me pak fushë e brigje të buta. Ngulitja në këtë bregdet, në qoftë se nuk do të kishte zbarkim, natyrisht do të ishte një fat i rënë nga qielli, kështu si kjo borë e imët, që kishte nisur në mesnatë dhe vazhdonte edhe tani në mëngjesin e Krishtlindjes. Flitej se në qytet me këtë rast për ushtarakët ishte hapur edhe një klub. Pritej gjithashtu që një anije e tyre të ankorohej në port; në të kishte shumë veshmbathje dhe ushqime që do t'u duheshin garnizoneve për dimërim. Vërtet, nëse nuk do të ketë zbarkim të anglezëve, do të jetë një fat, një fat i madh...

Dëbora vazhdonte të zbardhte çatitë, rrugët, kodrat e qytetit. Ishte nata e parë që Katzeni dhe të tjerët flinin në hotelin "Adriatik", i cili, nga sa morën vesh, kishte hyrë në historinë e qytetit si vendi ku qe mbledhur Kongresi i qeverisë në vitin 1918. Nuk kishin fjetur keq. Në mëngjes, pamja e mrekullueshme me borën e parë në qytetin bregdetar, ia forcoi Johan Katzenit ndjesinë e kënaqësisë. Në hotel flinin dhjetë ushtarakë madhorë që nuk kishin të bënin drejtpërdrejtë me trupat e garnizoneve: shumica e tyre ishin në shtab dhe i kishin vendosur zyrat në ish ndërtesën e Bashkisë, nën një çati me Johan Katzenin. Komandanti nuk kishte krijuar shumë lidhje me ta, madje u qëndronte disi ftohtë. Të gjithëve ua dinte aftësitë e për këto i respektonte, por në muajt e fundit kishte arritur në përfundimin se një ushtaraku në luftë nuk i duhen lidhjet intime. Jo pak oficerë të Rajhut e kishin pësuar ngaqë i kishin hapur barkun njeri-tjetrit. Prandaj ishte lidhur vetëm me Robertin, i cili gjithashtu vinte nga Bavaria, nga qyteti i vogël Koblenz. Veç kësaj ata i kishte lidhur edhe muzika.

Roberti ishte treguar vërtet i shkathët dhe brenda një dite kishte bërë gati gjithçka: hotelin, klubin dhe kishte vendosur disa ushtarë në specialitetet e kuzhinierëve, banakierëve dhe kamarierëve. Klubi hë për hë kishte një furnizim të kënaqshëm. Ishte një klub vërtet i këndshëm, tepër i preferueshëm para

evakuimit. Faqet e mureve qenë veshur me lëkurë ujqërish, sorkadhesh dhe delesh, kështu që e ndieje veten në një mjedis të ngrohtë. Robertit i kishte shkrepur mendimi që dita e përrimit të përkonte me Krishtlindjet. Dhe mëngjesi i festës kishte ardhur si pakuptuar. Violinisti me uniformë priste përgëzimet e komandantit dhe të kolegëve të tjerë.

Johan Katzeni u vesh duke ffishkëllyer një motiv nga Moxarti. Çoi mendjen te shtrati i tij në zyrë dhe çuditej si kishte fjetur ato net atje, duke bluar nervat e tij në ingranazhet e sahatit. Jo sikur kishte fjetur në një shtrat të zakonshëm, po në shtratin mitologjik të Prokrustit. Hodhi shikimin nga dritarja. Makina e priste poshtë, Ushtarakët e tjerë duhej të kishin shkuar për të ngrënë mëngjesin në mensën e garnizonit të afërt. Ishte mëngjesi i fundit që do të ushqeheshin larg. Duke filluar nga darka e krishtlindjes, do të shërbuhej në lokalin pranë hotelit. Zbriti shkallët. Shoferi i buzëqeshi duke ndezur makinën.

- Fjetët mirë, komandant?
- Shumë mirë, Hans, shumë mirë.
- Ku do të shkojmë, në zyrë?
- Jo, në fillim në mensë.

Rruga për në mensën e vogël ishte mbuluar me një cipë të hollë dëbore dhe rrotat e makinës linin pas dy vrraga të copëtuarra. Komandantit i zunë sytë dy patrulla. Nga ndërtesa e shtëpisë publike pa të zbriste agjenti Servet Dacka. Thuajse e kishte harruar fare, ndaj ndjeu një turbullim të brendshëm. Tek ai spiun kishte një besim të veçantë. Tani ato irritimet për gjëra të vogla do të përcilleshin, ashtu si rryma elektrike, te i sapoardhuri, i cili do të bënte çmos që të gjente, nëse kishte, ilegalët e fshehur. Atij si komandant i duhej që të ruante vetëpërbajtjen olimpike. Servet Dacka e nderoi me pëllëmbën e shtirë "Hail Hitler!". Edhe Johan Katzeni ngriti pak pëllëmbën për t'i kthyer përshëndetjen.

- - Ndale pak, - i tha shoferit.

Makina frenoi dhe ca cifla dëbore kapërcyen mbi këpucët e agjentit.

- Mirëmëngjes, herr komandant!

- Si fjetët? - e pyeti Katzeni me një buzëqeshje të hollë ironike, duke menduar se në një shtëpi publike flihet mirë, vetëm kur ka prostituta.

- Jo keq, herr komandant. Ne jemi mësuar të ngopemi dhe me lugë të zbrazur - bëri shaka Servet Dacka - Megjithatë rrofshin kujtimet e ëmbëla!

Johanit ky njeri i dukej vërtet i zgjuar, dhëlpër fabulash.

- Do të filloni sot?

- Patjetër, herr komandant. Megjithëse ma merr mendja se nuk do të ketë asnjë lëvizje të dyshimtë; do t'u ruhen gjurmëve në dëborë.

- Po dëbora mund të qëndrojë një javë apo një muaj pa shkrimë, kërkoj që ata të kapen sa më parë, ia ktheu Katzeni - Duhet të veprosht sa më shpejt. Do të jap urdhër të të shoqërojë edhe një patrullë.

- Faleminderit, herr komandant. Kurse sa për dëborën, mos u bëni merak: në këto brigje dëbora vdes shpejt.

- Ashtu qoftë! - tha Katzeni dhe i bëri shenjë shoferit t'i jepte gazit.

Agjenti mbeti mbrapa, duke sjellë edhe një herë ndërmend përgjigjet që i kishte dhënë komandantit gjerman. Mbeti i kënaqur.

Një makinë e madhe ndali para klubit. Roberti zbriti nga kabina dhe iu drejtua ushtarëve që ishin brenda në klub:

- Ejani shpejt të merrni bredhin.

Ushtarët me mëngët e përveshura, ia behën menjëherë, ulën spondin e makinës dhe para tyre u shfaq një bredh i madh, i bukur, shtrirë barkas, si i plagosur në ije.

- Ta zbresim me kujdes. Ruani degët të mos thyhen, - u thoshte Roberti.

E mbartën bredhin, e vendosën vertikalisht në një vazò të madhe, të cilën e mbuluan me gurë e dhë të sjella posaçërisht për pemën. Duke parë ushtarët që merreshim me rregullimin e saj, Robertit i shkoi mendja larg. në qytetin e tij buzë lumit të rrëmbyer, në një mbrëmje Krishtlindje pesë vjet më parë. Ishte i fejuar me Evën. Në dhomën e ngrohtë kishin ndezur qirinj. E fejuara nisi të bënte disa lëvizje rrotulluese vallëzimi rreth bredhit të vogël.

“Dukesh si e dehur”, i kishte thënë Roberti

“Jo dukem, Robert, por jam”.

“Të ka dehur dashuria”.

“Jam e lumtur, vërtet, e lumtur, e lumtur, e lumtur...”.

Dhe vallëzimi dehës i kishte përfshirë dy të fejuarit. Pastaj ai kishte rrëmbyer violinën dhe u kishte rënë, gjithnjë si i dehur, tre prej kapriçiove të Paganinit. Eva i rrinte e mbështetur te supi herë puthte Robertin, herë violinën e tij. I lumtur..., i lumtur..., i lumtur!...

- Po tani, çfarë të bëjmë komandant? - ia ndërpre në kujtimet ushtarët që kishin kryer punë me vendosjen e bredhit.

- Tani, merruni me zbukurimin e tij. Kam porositur të na sjellin edhe qirinj. Dua që komandant Katzeni dhe gjithë oficerët e tjerë, të mbeten të befasuar e të kënaqur, - tha Roberti dhe doli në rrugën e veshur me dëborë, me dëshirën për të vazhduar kujtimet e sapozguara.

Në lentet e dylhive Epidami pa si nxitonin në rrugën kryesore, mbase drejt kinemasë, disa oficerë që bisedonin, këndonin e qeshnin me njeri-tjetrin. I tregoi së shoqes.

- Janë kërshëndëllat, - i tha Shpresa - E dëgjuam dhe në radio.

- Vit për të festuar Krishtlindje është ky! E paskan gjetur! - foli Epidami pa i ulur dylbitë - Megjithëse, në artikullin e tij, Gëbelsi theksoi se në Gjermani askush nuk mendon t'i japë luftës një mbarim të parakoshëm, unë jam i

sigurt se atyre u ka ardhur fundi. Çdo gjë, madje edhe Krishtlindjet, ata i festojnë për të ngushëlluar veten, për të harruar disfatat. Për këtë jam i bindur.

Shpresa qeshi.

- Pse qesh? - e pyeti ai.

- Sepse po flet si një politikan i madh. A mos ke qenë gjë në Teheran?

Tani qeshi Epidami. Lajmet për takimin e Teheranit. burrë e grua i kishin ndjekur me një etje shkretëtire.

- Dëgjo, - foli ai - veçse ka dëborë e lë gjurmë, po sot do të kisha dalë patjetër për të bërë diçka.

- Përshembull? - pyeti ajo - Ne nuk kemi çfarë të bëjmë më.

- Kemi shumë. Duhet të përfitojmë nga fakti që në qytet ka pak forca.

- Pastaj, edhe ai, Qamili, nuk po bëhet i gjallë, - u hodh Shpresa.

- Më pengon dëbora, po do kisha dalë ta kërkoja Qamilin. Patjetër te shtëpia këtu pranë duhet të jetë fshehur.

- Ti nxitohesh, - i tha e shoqja - Tani eja. Erdhi ora t'i bëjmë masazhin vajzës.

Epidami zbriti në dhomën e fshehtë, la dylbitë në sirtarin e komodinës dhe iu afrua Jetës. e cila vazhdonte të krijonte figura me duart e saj të holla, gati të tejdukshme.

- Jeta, xhan, - foli Epidami - tani babi do të luajë me ty. Vogëlushja puliti sytë e ëmbël, një nga mënyrat e pakta me të cilën shprehte dashurinë e saj. I ati kalonte pëllëmbët mbi gjymtyrët pa gjallëri, duke i kënduar Jetës një këngë të bukur.

Papritmas çifti ndjeu një zhurmë jo shumë të largët avionash luftarakë. Epidami përsëri ngjiti shkallët me shpejtësi dhe u gjend te dritarja. Tashmë dylbitë i drejtoi nga qielli i plasaritur i dhjetorit, andej nga vinte zhurma e bombarduesve. Beteja qiellore zhvillohej diku përtej qytetit. Avionët gjermanë e anglezë mitralonin njeri-tjetrin. U ngjiti edhe Shpresa.

Epidami ia la dylbitë së shoqes dhe vetë u përpoq ta ndiqte betejën me sy. Ishte disi e vështirë, ndaj e uli shikimin në rrugën kryesore, ku veç dy patrullave, që gjithashtu kishin ngritur sytë nga qielli verior i qytetit, dukej dhe ai qeni, Servet Dacka, i veshur me pallto të zezë.

- Ra një aeroplan. - i tha e shoqja - Obobo ç'bëhet!

Avioni i bombarduar shigjetonte drejt tokës, i ndjekur nga tymi i zi.

- Servet Dacka me dy patrulla - tha ai - Më duket se kanë dalë për kontroll.

- Mos! - tha ajo e trembur dhe uli menjëherë dylbitë nga rruga. Dalloi spiunin dhe pa folur nxitoi për në dhomën e fshhtë. Pas saj, zbriti edhe Epidami, duke i vënë rrezin deriçkës së tavanit.

Beteja mes avionëve vazhdoi edhe dhjetë minuta, u rrëzuan dhe dy avionë të tjerë, një anglez e një gjerman e pastaj skuadriliet e dëmtuara, u tërhoqën. Servet Dacka vuri buzën në gaz sikur nuk kish parë një betejë në qiell, po një film në ekranin e kinemasë.

- Të kontrollojmë! - u tha ai ushtarëve dhe dy patrullat i shkuan pas drejt lagjes "Kala".

Servet Dacka nuk dinte nga t'ia fillonte më parë. megjithatë, hija e dyshimit për shumë arsye binte mbi këtë lagje, e para sepse flamuri ishte ngritur jo më shumë se pesëqind metra në krah të saj, e dyta sepse edhe tymi ishte valëvitur në disa oxhaqe këtej rrotull dhe e treta, gjatë terrorit para evakuimit pikërisht në këtë lagje ishte hasur një qëndresë e veçantë. Duke ngjitur rrugën me kalldrëm, agjenti dhe patrullat bënin kujdes të mos rrëshqisnin. Koka e madhe e Servetit gatuate lloj-lloj planesh, shkëndijonte dyshime, madje fantazonte edhe kapjen e të fshehurve. Do të ishte idiotësi që ai të kontrollonte çdo shtëpi të kësaj lagjeje të madhe. Aq më tepër që të gjitha shtëpitë ishin të mbyllura me

dryna e çelësa të markave të ndryshme, nga të vjetrat deri te të rejat. Ndaj do të bënte thjesht një hetim, një si nuhatje të përgjithshme të një shenje, të një gjurme...

Në krah të rrugës, ultas, gati ngjitur me kalldrëmin, ishin disa dritare të vogla. Mundet që i fshehuri, apo të fshehurit, të lëviznin edhe nëpërmjet dritareve, mendoj Serveti dhe shtyu disa prej tyre. Por më kot. Vëzhgoi brendësitë e dhomave, por asgjë të dyshimtë; kudo zhveshje, pluhur, pezhishka, cijasje minjsh, heshkje mortore. Shtëpitë i dukeshin si ca nofulla të kyçura. Kapërceu një gardh të vogël dhe iu afrua një dritareje. Asgjë për të dyshuar. Kështu kaloi nëpër dhjetra shtëpi. Ushtarët e patrullave i ndiqnin qetësisht veprimet e tij. Spiuni përpigëj të sillte ndërmend fytyrat e atyre që banonin në këto shtëpi të ftohta, por ishte e pamundur. Pastaj për çfarë mund t'i hynin në punë ato fytyra të fantazuara. Ai kërkonte diçka më shumë, një fakt, një gjurmë, një hije.

- Po bie nata - tha Servet Dacka - Sot s'kemi ku kërkojmë më. Të shohim nesër në mëngjes. Mbase mund të gjejmë në zonat e tjera.

Qamili i kishte ndier hapat e patrullave dhe të atij zagarit, që kur ishin në krye të rrugës së kalldrëmtë. Kishte dalë nga dhoma, për t'u fshehur diku pas murit të shtëpisë fqinjë, e cila ngrihej në kurriz të strehës ku ai ishte vendosur para disa ditësh. Dy gjerdanët me çelësa i kishte hedhur në krah. Kapërceu murin me lehtësinë e një atleti e pastaj u mbështet pas tij. Nëse patrullat do të hynin në oborrin e shtëpisë, atëhere ai qetësisht do të kalonte djathtas, nëpër një të çarë muri dhe do të futej në bodrumin e një tregtari, çelësat e të cilit gjithashtu i kishte ai. Priti me zemrën e mekur derisa patrullat e kaluan rrugën. Nga zhurma e hapave duken se janë

katër ose pesë vetë, mendoj Qamili, duke mbajtur veshët ngrehur. Veç fjalëve të Servet Dackës, disa xhamave që thyheshin herë pas here, "pirati" nuk dëgjoi asnjë zhurmë tjetër.

Syri i shkëlqeu nga një ide e lindur papritmas: spiuni dhe patrullat kishin lënë gjurmët e tyre në kalldrëmin me shtresë dëborë, domethënë ai mund të ecte mbi këtë rrugë sa të shkonte deri te shtëpia e çiflit për të ndërruar një fjalë. Priti dhe disa minuta, pastaj rikapërceu murin e vjetër, hyri në dhomën buzë kalldrëmit, hapi dritaren dhe me kujdes rrëshqiti që andej e doli në rrugë. Përpiquej të shkelte mbi gjurmët freskëta. E ndihmoi fakti që Servet Dacka kishte hyrë dhe në oborrin e shtëpisë së çiflit. Kaloi në vijën që kishte krijuar bashkimi i gjurmëve dhe shkoi te dritarja. Asgjë nuk pipëtinte. Trokiti. Asnjë shenjë jete. Si duket të zotët e shtëpisë dyshonin se mos spiuni dhe ushtarët, akoma nuk qenë larguar. Përsëri trokiti tri herë. Përgjigje të tilla gjithnjë vonojnë. Trokiti sërish duke folur ngadalë:

- Hapeni, jam unë, Qamili, hapeni!

Halli dëgjon dhe mendimet e jo më zërin e njeriut. Pas pak, tutje në qoshe të dhomës, fshehur pas një bufeje të vogël e të vjetër, u duk koka e Epidamit.

- Ti je Qamil? Prit se erdha të hap dritaren.

Përballë njeri-tjetrit, ata buzëqeshën. I riu çeli dritaren dhe "pirati" me hapin e madh, s'e pati të vështirë për të hyrë brenda.

- Mirë jeni? - pyeti Qamili.

- Mjaft mirë. Po ti? U bëmë merak.

- E pësoi Kosta i shkretë, ai që merrej me pëllumbat.

- Po, e kuptuam, megjithëse në fillim na shkoi mendja

te ti.

- Pëllumbat nuk afrohen te unë - foli Qamili - i tremben syrit të piratit, kurse pulëbardhat po, ato më njohin. Pastaj

vështirë të kaloja deri te lagjia "Spirancë". Më duket se patrullat në qytet janë shtuar.

- Eshhtë shtuar dhe ai, Servet Dacka - sltoi Epidami.

- E di. Para gjysmë ore kaloi në rrugën tonë. Mirë që nuk dyshoi. Paska ardhur deri këtu, në dritaren tuaj.

- E ndiem. Na ngriu zemra. Po mirë që nuk nuhati gjë. Po eja, eja zbresim poshtë. Shpresa na pret.

Zbritën shkallët. Shpresa toku duart me Qamilin. Bashkë takoheshin për herë të parë.

- Mirë që paskeni shpëtuar. - foli ajo - Gjermanët i kanë shtuar kontrollet.

- Edhe zemërimin, - tha "pirati"

- Ardhja e spiunit do të na e vështirësojë punën, - tha i shqetësuar Epidami.

- Do t'i rregullojmë, do t'i rregullojmë. Pa hapeni pak radion të dëgjojmë lajmet, se vaji ora më duket.

Shpresa hapi radion gjithnjë me volumin në minimum. Vazhdonte programi muzikor.

- Si është vajza? - pyeti detari i vjetër, duke iu afruar shtratit të të sëmurës.

- Sikur po përmirësohet dalngadalë. I bëjmë masazh katër herë në ditë - u përgjegj Epidami.

- Dru zjarri a kemi?

- Po kemi. Dhe fatmirësisht tymi i sobës kalon andej nga katakombet e kështjellës. Ja, shikoje.

Epidami lëvizi portëzën prej llamarine dhe para tyre u shfaq tuneli i lartë sa një bojë njeriu.

- Qenka vendi i mrekullueshëm për t'u fshehur. - u habit Qamili - Ndonjë ditë mund të na hyjë në punë.

- Në fund të labirintheve kam takuar Bukuroshen. - zbuloi sekretin Epidami. duke parë me kërshtëri se ç'përshtypje do t'i bënin tjetrit këto fjalë.

- Si?! Bukuroshen?!... Atë të legjendës?... Mozaikun!?!...

Qamili ishte kthyer në sinonim të habitës. Në ato vite prej gati gjysmëshekullore të jetës së tij çfarë nuk kishte dëgjuar për mozaikun e asaj vaje të mrekullueshme. Madje në Luftën e Parë, kur ishte adoleshent, kishte dëgjuar legjenda nga më të çuditshme për të. Bukuroshja ishte simboli i lindjes.

- Domethënë është atje brenda, ëë?...-pyeti ai gjithnjë në mënyrë habitore.

- Atje...Duket sikur pret diçka.

- A bënë të shkojmë tani te Bukuroshja? - pyeti i ndezur Qamili.

- Shkojmë, - tha Epidami.

I zoti i shtëpisë mori menjëherë një nga fenerët, e ndezi, hapi portën e llamarintë dhe priu para Qamilit. I dyti ishte përfshirë nga ca ethe të çuditshme.

Kur u ndodh para mozaikut, Qamili lëshoi një "ah!" kënaqësie e befasismi.

- Po kjo është mrekulli, mrekulli! - tha i mallëngjyer.

Pastaj u përkul në gjunjë, futi duart në ujin e kulluar dhe nisi të përkëdhelte gurët shumëngjyrësh të mozaikut të madh.

- A nuk të duket sikur Bukuroshja, ashtu si në legjendë, bën roje për qytetin? - pyeti Epidami.

- Për këtë unë kam krijuar bindjen - tha Qamili, i cili vazhdonte të ishte si i dehur, me sytë e ngulur te tiparet e nimfës prej mozaiku.

Ai i tregoi Epidamit disa prej legjendave dhe Bukuroshja dukej sikur e dëgjonte buzagaz. Mbas një ore u kthyen në dhomën e fshehtë. Qamili fliste i frymëzuar.

- Duhet t'i shtojmë aksionet tona...

- Filloi dimri i vërtetë - tha si e menduar Shpresa - Madje edhe borë. Tani është e vështirë të lëvizim, të veprojmë.

- Dëbora do të shkrijë - u hodh Qamili - Kurse nën shi veprohet më mirë, sepse në asfalte e në kalldrëme nuk do të lemë asnjë gjurmë, përkundrazi, rrjedha do të na i fshijë gjurmët.

- Çfarë ke menduar të bëjmë? - e pyeti Epidami.

- Të përdorim armët tona, çelësat - tha Qamili.

Burrë e grua iu afruan "piratit". Qamili kishte kryqëzuar në gjoks dy gjerdanet e çelësave. Në atë çast programi muzikor mbaroi dhe radioja nisi lajmet.

"Sot në këtë ditë feste, e cila na kujton lindjen e njeriut që predikoi paqen e dashurinë mbi botë, mendimi ynë dëshiron të jetë një përkëdhelje për të gjithë vëllezërit e motrat që vuajnë në dhimbje, në skamje e pocaqi..."

"Pirati" hoqi nga supi njeriu nga gjerdanët dhe i përkëdheli vezmet me çelësa.

- Ja këtu janë çelësat e fotograf Prokopit. Prokop Stresës. Në mëngjesin e aksionit të zjarreve, atje u fsheha.

- Në dyqan, apo në shtëpi? - pyeti Epidami.

- Në shtëpinë e Prokopit. Njerën nga dhomat ai e kishte kthyer në laborator, ku qëndrova i mbyllur me orë të tëra. Pashë shumë filma dhe ata më folën...

- Në ç'kuptim e ke? - pyeti përsëri Epidami.

Qamili u ngrit nga krevati i vogëlushes dhe nisi të bëjë ecejake në dhomën e vogël.

- Në filma ishin shokët që tashmë nuk rrojnë, apo që tani kushedi ku dergjen në kampet e përqëndrimeve. Pashë Kozmanë, Verin, Xhevdetin, Sotirin, Naunin, Dritën, Hënë, Telatin...

- Domethënë ti mendon se... -foli Shpresa.

- Po, unë mendoj se ata filma ne mund t'i bëjmë fotografi. Në dhomën - laborator të Prokopit, letër fotografike kishte boll, hile edhe në formate të mëdha.

- A nuk ka rrezik kjo punë, - u hodh Epidami.

- Çfarë rreziku?

- Gjermanët nuk ia përtojnë dhe i venë zjarrin të gjitha dyqaneve të fotografëve.

- Po në qytet janë afro dhjetë dyqane të tilla. Pastaj, edhe nëse bëjnë terror ndaj dyqaneve, kjo do tregojë tërbimin e tyre. Për ne kanë rëndësi njerëzit.

- Po një ditë ata njerëz do të kthehen, u presim bukën e gojës - foli Shpresa.

- Nëse mendojmë kaq gjatë, do të ngatërrohem. - u hodh Epidami - Po të ishim kapur pas "sikurave", edhe luftën nuk do ta kishim nisur.

- Tani fole shumë mirë. - tha "pirati" - Fundja duhet të kapemi te një fakt: deri tani, gjatë këtyre tre javëve, kemi bërë tre aksione të vogla dhe gjermanët nuk kanë djegur asnjë shtëpi. Atyre u duhemi ne dhe jo shtëpitë.

Qamili u afrua te soba dhe hapi kapakun e një tenxhereje.

- Paskeni fasule, do të ha një pjatë me ju.

- Më mirë fli me ne, ka vend. - i tha Epidami.

- Jo, do të shkoj. Mëngjesi duhet të më gjejë në shtëpinë tjetër.

- Po për aksionin si do t'ia bëjmë, - pyeti i riu.

- Ti e di shtëpinë e Prokopit?

- Po, e di. Është përtej shtëpisë ku vendose flamurin, apo jo?

- Tamam. Pasesër, nëse nuk do të bjerë më dëborë, të pres atje mbas orës dhjetë të natës. Ti di t'i përdorësh aparatet dhe ma merr mendja se dhjetë fotografi, në tre katër kopje secila, do të na mjaftonin.

- Mirë janë kaq.

- Mbarojmë punë, marrim fotografitë dhe i shpërndajmë që atë natë.

- E mira është t'i ngjisim në mure, t'i vendosim në vitrina. - u hodh Shpresa.

- Edhe këtë mund ta bëjmë, - tha detari i vjetër - bile kështu ka më shumë vlerë.

Ai tashmë ishte ulur në tryezën e vogël, përballë pjatës

me fasule, që po avullonte.

- Ndonjë ditë, - tha përsëri Qamili - na duhet të kontrollojmë në depot e tregtarëve se mos gjejmë pak ushqim.

- Aha, në këtë aksion patjetër do të dështojmë - bëri shkaka lëpidami - Nga një lajm në radio, mora vesh se disa nga tregtarët edhe varkat i kishin ngarkuar në makina drejt kryeqytetit.

Qamili mezi e mbajti të qeshurën e tij, që duhej të ishte buçimtare.

- Si kështu, edhe varkat! Na e paskan lënë portin batall. Po ku do të lundrojnë, në Dajt? Ha-ha-ha!

- Kemi dhe ca ushqime akoma, - foli Shpresa - Po deshe të ndihmojmë edhe ty. Jemi përgatitur si për zaire.

- Miqtë që më kanë besuar çelësat, kanë menduar edhe për mua - tha "pirati".

- Po veç kujdes nga minjtë.

- E vërteta është se më kanë dëmtuar ca, po në fund të fundit me karar - përgjigjej "pirati", duke prerë bukën me biçak e pastaj e fuste në gojë.

Epidami i filloi së bijës masazhin e zakonshëm.

- Dhe pak do të dëgjojmë emisionin tjetër të lajmeve - tha Shpresa - Gjermania në të gjitha frontet po pëson disfata.

- Hitleri nuk e ka të gjatë, jo - ia ktheu i shoqi.

"Pirati" vazhdonte të hante.

Natën e Krishtlindjes Johan Katzeni përpiquej të dukej me humor të mirë. Madje, kur Roberti interpretoi në violinë një vals të Shtrausit, ishte ngritur me një pirun në vend të paketit, kishte dirigjuar të gjithë oficerët, të cilët i kishin shoqëruar tingujt me fjalë. Këtë mbrëmje të shenjtë kishte vendosur t'i harronte të gjitha ato që thoshte zyra ndërkombëtare gjermane e lajmeve, radio-Moska, radio-Bari, radio-Londra e

radio-Tirana. Të gjitha! Do të pinte konjak "Metaksa", verë, shampanjë, birrë apo uiski sa të kënaqej, veç mundësisht, të mos dehej. Po edhe nëse dehej, kjo nuk kishte rëndësi. Ai patjetër do të dehej i fundit, kështuqë nuk kishte se kush të raportonte më lart. Pastaj dhe ata të Komandës së Korparmatës, patjetër që deheshin. Madje kishin edhe femra. Ah...! Aty para gotës së konjakut përsëri i shkoj mendja te Ana e tij, të cilën e kishte tradhtuar vetëm një herë, një herë të vetme, me një greke të bukur, pesë muaj më parë. Ktheu "Metaksanë" me fund duke pëshpëritur:

- Për ty greke! Për ty Ana! Për ty vdekje!

Në tryezën aty pranë, disa oficerë kishin gjetur një shkak tjetër nxitës e justifikues për pijen: betejën qiellore, ku avionët e tyre, sipas lajmeve, kishin rrëzuar katër bombardues anglezë "Spitfajër".

Përsëri një vals. Tanimë ushtarakët ishin mundur nga pijet e shumta dhe u ngritën tërë zhurmë. Papritmas, të gjitha lëkurët e ujqëve, të deleve e të sorkadheve, u shkëputën nga muret dhe ranë në dysheme me një marramendje dehëse. Robertit po i pëlqente kjo aventurë. Ujqrit sikur u kujtuan për rolin e tyre dhe nisën të rendnin pas deleve dhe sorkadheve, të cilat, të pafajshme, me sy të përlotur, vërtiteshin e ngatërroheshin mes këmbëve të veshura me çizme; oficerët vallëzonin pa pyetur për blegërimat e deleve, për vajet e sorkadheve, madje u bënë aleatë me ujqrit, u bashkuan me lukuninë e tyre dhe vraponin me gojë të shkyera drejt deleve dhe sorkadheve. Këto të fundit, e kuptuan se në dysheme do ta kishin të vështirë, ndaj duke përfutuar nga vrulli dhe shtytja e çizmeve të dehura në vals, u përplasën në mur dhe mbetën të mbërthyera atje, duke dihatur lodhje dhe frikë. Si të urdhëruar, pranë tyre u gjendën lëkurët e ujqve, gjithnjë duke dihatur e duke përsëritur se kjo lojë e egër do të përsëritej së shpejti.

KAPITULLI IX

FOTOGRAFITE

Nuk ishte e lehtë të vendosje fotografitë e mëdha nëpër muret dhe vitrinat e qytetit. Patrullat ishin shtuar. Spiuni Servet Dacka kishte tri ditë e tri net që vërtitej rrugëve e rrugicave, hynte nëpër shtëpitë e boshatisura, kërkonte kudo. Kishte hyrë dhe nëpër bodrumet, në magazina, në kisha e xhami, madje dhe në çati të ngjashme me atë ku kishte banuar i ndjeri Kosta Pëllumbi. Po asgjë. As-gjë!

Qamili dhe Epidami ishin takuar në shtëpinë e fotografit Prokop, menjëherë pas shkrirjes së dëborës, e cila nuk kishte mbajtur as njëzet e katër orë. Epidami, që kishte punuar ca kohë si ndihmës fotograf, i hyri punës me një dëshirë të veçantë. Fytyrat që stamponte në letrat fotografike, i njihte. Disa i kishte patur dhe miq. Tani ata, të vdekur e të gjallë, i buzëqeshnin nga fotografitë e zmadhuara.

- Ky do të jetë aksioni ynë më i rrezikshëm dhe më shprehësi, - i thoshte Qamilit, sa herë që përkulej mbi aparatit e stamposjes, apo fuste letrat në solucionin zhvillues.

- Dhe unë kështu mendoj. - ia kishte kthyer "pirati" - Veç tani duhet të ruheni më shumë.

Pastaj kishin takuar Shpresën dhe, natën, gjithnjë natën, me fotografitë ende të pathara mirë, ishin shpërndarë në tre drejtime, te lagjet "Pusi i Tapanasë", "Spirancë" dhe "Torra e molos". Çelësat përsëri do t'i ndihmonin të hynin në dyqane e magazina, vitrinat e të cilave do të luanin rolin e kornizave. Shumë fotografi do t'i ngjithnin me tutkall, në mure, mundësisht në vende të vepronte te lagja e tij "Torra e molit".

Qamili vendosi të vepronte te lagja e tij "Torra e molit", rreth ndërtesës Bankës, si pjesa më e njohur për të, por edhe

me rrezik më të madh. Aty pranë ishte vendosur garnizoni i tretë. Nuk kishte kohë të hynte në shtëpinë e tij, vetëm i hodhi një shikim si për ta përshëndetur dhe u largua. Kisha ngrihej disa metra më tej. Vendosi që një fotografi ta ngjiste lart në çatinë e madhe. I shkathët, si në fëmijëri, kaloi të gjitha pengesat dhe u ndodh para portës së rëndë të kishës.

Nga porta nuk mund të hynte dot. Kaloi majtas. Futi një levë të vogël në njëren nga dritaret, e cila kërciti pak e pastaj hyri brenda. "Fillim të mbarë!", i pëshpëriti vetes. Gjithë ajo kishë e madhe, e ftohtë, e errët, të fuste të dridhura. Ndjeu lëvizjen e minjve, të cilët si duket kishin me se të ushqeheshin në banesën me aromë qirinjsh. U mësua me errësirën dhe shkoi mbrapa, në hajat, ku gjeti shkallët e larta, të cilat i vendosi në murin përballë. Pastaj tërhoqi një fotografi dhe u ngjit nëpër shkallë drejt çatisë. Me forcën e muskujve të krahut, kërcëu mbi trarët e tavanit dhe pas tre hapash u gjend atje ku ishte kryqi. Fotografinë e vendosi me fytyrë nga deti. Kaloi dhe ai shikimin nga deti dhe një psherëtimë malli i rëndoi zemrën. I gjithë bregu nxinte. Porti i vogël dukej si një pus i braktisur. Pastaj shpejt zbriti shkallët, të cilat i çoi përsëri në hajat dhe me hapa të lehta, mes minjve që shkonin e vinin si dhjakë të vegjël, iu afrua dritares së hapur.

Ndërtesa e Bankës, Torra dhe moli, ruheshin me ushtarë. Duhej të vepronte disi larg tyre. Sipas planit vendosi fotografi në murin e shtëpisë së njerit prej tregtarëve më të pasur, në vitrinën e dyqanit të kosaxhiut; në portën e shkollës fillore; në ëmbëltoaren buzë rrugës; te shtëpia e ish pronarit të tij; në një mur të bardhë ku ishte stamposur kryqi i thyer nazist (fotografinë e ngjiti mbi këtë kryq). Vendosi gjithashtu, për inat të Servet Dackës, një fotografi në krah të shtëpisë publike, ku flinte spiuni; dy të tjera i vendosi në portat e shtëpive që dikur kishin qenë baza ilegale e që në ditët e terrorit i kishin shkatërruar; një tjetër te porta e një vile të fisme, ku dikur, në

rininë e Qamilit, kishte banuar vajza më e bukur e qytetit... Njëzetë fotografi. Tani kishte mbaruar punë. Me shkathtësi kaloi një rrugicë dhe iu afrua shtëpisë së Servet Dackës, ku sipas planit të thurur me Epidamin, ai do të fshihej.

Komandanti Katzen po shihetë në ëndërr sikur po dirigjonte me bajonetë një orkestër madhështore të përbërë prej mijëra vetësh, me muzikantë që në koka mbanin helmata, të cilët i buzëqeshnin të lumtur drejtuesit të tyre. I buzëqeshnin dhe pse po luanin një rekuem madhështor, që shoqëronte kufomën e një të vdekuri të rëndomtë me fytyrë tërë qime, e ngjashme me fytyrën e një idioti që shoqërohej nga pëllumbat. Dang! Dang! Dang! - tingëllonin pjatat e orkestrës, njëlloj si sahati i madh. Dang! Dang! Dang! Pushoni! Pushoooooni! Dang! Dang! Dang! Hapi sytë. Po troksanin në derën e dhomës së tij.

- Hyrë! - foli i përgjumur.

Ishte nënoficeri, që shërbente si roje hoteli.

- Zoti komandant, më falni që ju zgjova kaq herët, por..

- Ç'ka ngjarë? - pyeti komandanti Katzen dhe ndjeu se diçka e keqe kishte ndodhur.

- Njëpër qytet janë parë të vdekurit...

- Çfarë thua, idiot! - u nxeh Katzeni dhe u ngrit nga shtrati - Fol qartë!

- Kanë vendosur disa fotografi të mëdha, herr komandant...

- Fotografi?!!

- Po, herr komandant, - mjekra e nënoficerit dridhej nga frika - fotografitë e atyre rebelëve që tani janë në varreza....

"Doli ëndrra", tha me vete Katzeni dhe kapi kokën me duar.

- Mirë. Dil jashtë. Po bëhem gati shpejt. Më thërrisni atë, Servet Dackën! - shtoi i zemëruar.

- Siurdhëron, zoti komandant! - foli nënoficeri, gjithnjë

me zë e zemër të dridhur.

Servet Dackën ushtarët e kishin zgjuar të parin, sepse pikërisht disa nga fotografitë në lagjen "Torra e molos", kishin rënë më parë në sytë e patrullës. Ishte ora katër e mëngjesit. Spiuni i shtrirë në shtratin e "Fiore d'amores", u ngrit i trembur dhe doli nga shtëpia publike duke u veshur. Patrulla e shoqëronte nëpër vitrinat, portat dhe muret nga ku e shihnin me sy zhbirues, të rinj e të reja që ai, Servet Dacka, i kishte njohur mirë.

- T'i zhdukim! T'i heqim! - u foli në gjermanisht ushtarëve, po ata tundën kokat në shenjë mohimi.

- Kemi çuar të lajmërojmë komandantin, - i tha njeri prej tyre.

Servet Dacka e ndjeu rrezikun. I dukej sikur vërtet në qytet vepronin fantazma, xhindër, shpirtra të vdekurish. Po të paktën të dilte njera prej tyre, të shfaqej dhe ta shpëtonte nga pozita e vështirë ku kishte rënë.

Ecte nëpër rrugët e rrugicat, shihej sy më sy me të vdekurit e gjallë në mure, vitrina, porta, madje dhe atje lart në kishë dhe sa vinte e më shumë bënte fajtor veten, po veten, sepse fare mirë, more teveqel, të kishe thënë se mundej që edhe Kosta Pëllumbi t'i kishte kryer ato aksionet e thjeshta. Kështu kishe shpëtuar, ktheheshe përsëri në Tiranë e pastaj s'dihej se si merrte puna. Ec e dëgjoje tani komandant Katzenin. Megjithatë nisi ta qetësonte veten me mendimin se brenda ditës ai do ta kapte atë që bënte këto veprime tepër të çuditshme. Ju, premtoj herr komandant, se sot patjetër do t'i gjeni vënësit e fotografive. Patjetër! Po ku t'i gjente? Ishte gjithë ky qytet me mijëra shtëpi. Pastaj, pastaj...zoti komandant, çuditëm, vërtet çuditëm me një gjë: tërë këto patrulla si nuk kanë vënë re një lëvizje xhanëm, një lëvizje të vockël, një dorë, një këmbë, një hije...Papritmas ndali. Nga një fotografi po e shihte me një

shikim plot urrejtje. i nipi. Ç`donte ai këtu. Sikur nuk ishin fotografi, po fantazma. Nëpër kujtesë u rrokullisën tërë përpjekjet që kishte bërë për t`ia nxjerrë të nipit fshehtësitë e gproposura, pastaj pështyma e djaloshtit dhe ato fjalët tashmë të zakonshme për të: "tradhtar i ndyrë!" si dhe mendimi i tij përfundimtar para Gestapos se dhe i nipi duhej të internohej në kampet e përqëndrimit. Ç`më sheh ashtu, iu kthye Servet Dacka fotografisë, apo kërkon të tallesh me pozitën time. Po unë nuk do të lë të kënaqesh gjatë, jo!... Unë do t`i gjej shokët e tu, do t`i gjej! Mirëpo djaloshi në fotografi vazhdonte ta shihte me urrejtjen e pandryshueshme.

Makina e komandantit u duk përballë dhe agjenti i hoqi sytë nga i nipi.

Johan Katzeni, tani me gjak më të ftohtë, e ftoi spiunin të ngjitej në makinë.

- E çuditshme, zoti komandant. Në kontrollet e bëra nuk shohim asnjë shenjë jete, patrullat nuk venë re asnjë lëvizje kurse....

- Kurse rrebelët, marrin guximin dhe na shohin nga vitrinat, nga muret, nga portat, - vazhdoi komandanti mendimin e Servet Dackës.

Drita e mëngjesit ishte përhapur mbi qytet, i cili dukej që nuk kishte fjetur, po kishte qëndruar tërë sy e veshë.

- Ec shumë ngadalë, - i tha shoferit dhe që nga brenda vëzhgonte fytyrat e të rinjve dhe të rejave, që sikur kishin mbirë në vitrinat, muret dhe portat e kësaj lagjeje.

Eshtë e tmerrshme, mendoi, këtu nuk vepron një njeri po disa, madje më duket sikur një ditë kam për të dhënë urdhër që garnizonet e dislokuara në brigje, ta lenë vëzhgimin e detit dhe të hidhen në ofensivë për zhdukjen e këtij zbarkimi të padukshëm në qytetin e boshatisur.

- Kalo në lagjen "Pusi i Tapanasë"!

- Siurdhëron, herr komandant!

Servet Dacka nuk i kishte parë fotografitë në lagjet “Spirancë” dhe “Pusi i Tapanasë”.

- Eshhtë e pamundur, zoti komandant, e pamundur. Kaq patrulla që veprojnë në qytet...

- Mjaft! - thirri Johan Katzeni - E para, në qytet nuk veprojnë shumë patrulla, sepse ai është i evakuuar, kupton? Dhe e dyta, ju dhashë një javë afat, java po mbyllet kurse ju nuk keni zbuluar akoma një gjurmë të freskët.

- Sot, brenda ditës zoti komandant do bëj çmos të zbuloj këta rrebelë aventurierë. Ma merr mendja se në këtë aksionin e fotografive, ata patjetër do të kenë lënë një gjurmë, një shenjë...

- Të shohim.

- Mbase do të ishte e nevojshme të kishim edhe një qen special, nuhatja e të cilit do të na çonte te të fshehurit.

- Mirë, edhe qenin do të ta sjell, - tha Johan Katzeni dhe i shkoi mendja te qeni i specializuar që mbante Roberti në garnizonin e tij.

Qeni i madh si ujk, nuhati disa fotografi dhe si i babëzitur u vërsul përpara nëpër rrugët e rrugicat e lagjes “Torra e molos”, ku ishin vendosur më shumë fotografi. Pas i shkonin oficerë, ushtarë si dhe Servet Dacka me shpresa të shumta te ajo kafshë e zezë. Mirëpo qeni, ndonëse i stërvitur mirë, nisi të bënte disa veprime absurde, ndalte para çdo fotografie dhe lehte, a thua se njera fotografi kishte vendosur tjetrën e kështu në reaksion zinxhir.

- Janë gjurmë të njëjta, prandaj, - sqaronte nënoficeri që ishte dhe instruktori i qenit.

Kafsha vërtitej, sikur kishte pirë hashash, nga njera portë te tjera, nga njera vitrinë te tjera. Kafsha e trulllosur u kthye përsëri në fotografinë e parë. Servet Dacka sa nuk po tërbohej. Të ishte në kushte të tjera do ta kishte vrarë këtë qen

të mallkuar, që siç dukej, po ia shkurtonte jetën.

- Kalojmë njëherë në lagjen tjetër, - tha Serveti.

Oficerët pranuan. Po edhe në lagjen "Spirancë" po e njëjta gjë, qeni nuhaste, vërtitej, lehtë dhe bënte disa rrotullime gati anormale. Kurse te rrugët dhe rrugicat e lagjes së vjetër "Pusi i Topanasë", edhe vetë qeni e humbi durimin dhe ia dha një kuje të çuditshme, që instruktori e përktheu heshturazi: "Nuk kam ç' të bëj më".

Tërë qyteti me rrugët dhe rrugicat e tij, ishte kthyer në një rebus, që askush nuk arrinte ta zbërthente.

Atëherë Servet Dacka, i cili ishte zotuar para komandantit të qytetit se do ta gjente patjetër rrebelin, tha si i përhumur:

- Hiqeni qenin! Do të kërkoj vetë!

Oficerët dhe ushtarët, të cilët kishin tre orë që vërtiteshin nëpër qytet, e lanë të vetëm spiunin. Oficeri që drejtonte grupin e kontrollit, shkoi t'i raportonte gjendjen komandantit Katzen. Kurse agjenti i dërrmuar, tani me funksionin e një qeni, nisi të vërtitej nëpër tre lagjet me fotografi. Këto dhjetra fotografi, që vazhdonin të rrinin në vendet e tyre gjer në një urdhër të dytë të komandantit, e shikonin Servet Dackën me sy tërë zemërim, si shuplaka.

Spiunin e çuan këmbët në shtëpinë e tij. Nxori çelësin, hapi derën dhe pikërisht atje ngriu nga një mendim që i kishte lindur papritur: çelësi! Të gjitha dyqanet me vitrina ishin me dyer të mbyllura! Pra dikush i kishte çelësat e tyre. Madje, madje, o zot, edhe dyqanet e fotografëve ishin me dyer të mbyllura! Dikush kishte dhe çelësat e këtyre dyqaneve. Kjo ishte fare, fare e thjeshtë. Dhe meqë nuk po i gjenin mbartësit e çelësave, pra ata që vepronin me ndihmën e tyre, atëherë të kërkonin nga krahu tjetër, të gjenin të zotët e dyqaneve dhe t'i pyesnin, po të ishte nevoja edhe me tortura, se cilëve ua kishin besuar çelësat.

- Ky është një zbulim i madh! Shpëtova!! - tha me zë

Servet Dacka - Çelësat! Çelësat! Çelësat!

- Çfarë çelësash?! - dëgjoi një zë me akustikë të veçantë.

Menjëherë nxori revolverin. Mirëpo ndjeu një shtrëngim të fortë në fyt, një goditje në dorën e djathtë dhe revolveri ra në dysHEME.

- Cili je ti? - pyeti i frikësuar agjenti, i cili akoma nuk e kishte vënë re fytyrën e njeriut të fuqishëm.

Tjetri ia ktheu kokën, si të një kukulle të lemeritur. Kukulla njohu "piratin".

- Qamil!... Ti?!...

Donte ta zbuste detarin e regjur, i cili vazhdonte ta mbante të mbërthyer.

- Dëgjo këtu Servet Dacka, mos hidh shkelma!

Qamili e shtyu një çast agjentin dhe mori armën në dorën e tij të madhe. Tyta e revolverit qëndronte e drejtuar në lulen e ballit. Servet Dacka u mbulua me djersë të ftohta frike dhe mjekra i dridhej tej mase.

- Tani kemi pak punë bashkë....

- Çfarë pune?! - u frikësua spiuni - Mos më vrit... Unë..., unë nuk kam treguar gjë.

- Dëgjo këtu Servet Dacka... as nuk ke për të treguar gjë, sepse, sepse me mua vepron dhe Bukuroshja e qytetit.

- Bukuroshja! - habia ishte tepër e madhe.

- Po, Bukuroshja, nuk e sheh?... - ishte një pyetje e pamenduar e Qamilit, mirëpo te spiuni pati një ndikim të çuditshëm, hipnotizues, sepse vërtet ai pa një figurë fantastike. Fërkoj sytë me shpinën e pëllëmbëve, megjithatë qënia mitike, për të cilën edhe ai kishte dëgjuar me dhjetra legjenda, ndodhej aty, brenda në shtëpinë e tij.

- Ngrihu! - e urdhëroi Qamili.

Ai u ngrit, duke u dridhur nga frika, nga befasia e shfaqjes së "piratit" si dhe e kësaj qënie mitike.

- Nxirr laps e letër dhe shkruaj!

- Çfarë të shkruaj!
- Këto që do të diktoj unë!

Kush fliste Qamili apo ajo qenie mitike, apo të dy sëbashku. Veshët i ushtonin, a thua se në timpane përplasej deti. Me ca lëvizje si të kurdisura, gjithnjë i tmerruar, Servet Dacka nxori laps e leçetër, u ul në tryezën e zhveshur dhe priste ç' do t' i diktonte ai njeriu me një sy, i cili mbase duhej të ishte zhdukur që para disa muajsh, kur ishte kthyer në simbol për qytetin.

- Atëherë shkruaj! - urdhëroi Qamili duke e shtyrë me tytën e revolverit.

Spiuni u bë gati të shënonte mbi letren e bardhë.

"Sot, unë Servet Dacka, gjatë kontrollit për gjetjen e rrebelëve që vendosën fotografitë e të vrarëve, takova fajtoreshën e vetme: ajo është Bukuroshja e qytetit, e shekullit të katërt para erës së re.

Të gjitha aksionet i ka kryer Bukuroshja; është kjo urësyeja që nuk kemi gjetur asnjë gjurmë nëpër rrugët, shtëpitë, dyqanet dhe në varrezat e qytetit.

Servet Dacka shkruante i hutuar, koka i ishte mbushur me një tym marramendës. Shkruante dhe tundte kokën, duke i besuar të gjitha fjalëve që diktonte ai Qamili, apo ajo krijesë magjike, përrallore, që tani thuajse e kishte përballë, ose më saktë: kudo.

- Shkruaj!

*Bukuroshja nuk do ta lejojë vdekjen e qytetit të lashtë!
Këto m' i tha vetë Bukuroshja, sot më 30 dhjetor 1943,
ora shtatëmbëdhjetë.*

Servet Dacka ngriti kokën, fërkoji sytë dhe po bindëj se gjithçka ishte e vërtetë.

Në fund shëno emrin tënd dhe firmose!

- Siurdhëron!

Qamili e mori letrën në dorën e lirë dhe i hodhi një shikim të shpejtë.

- Shumë mirë, - tha. - Dhe tani Servet Dacka, në emër të popullit, të qytetit dhe të Bukuroshes, je i dënuar me vdekje!

- Mos! Mos! - thirri tjetri i lemeritur nga frika e vdekjes - Unë do t'ju ndihmoj.

Qamili me revolen në kafkën e Servet Dackës, nuk priti më, po shkeli këmbëzën. Krisma që e thatë dhe nuk besoj të ishte dëgjuar.

- Tani - tha Qamili - t'ia lë revolen në dorë kësaj kërme të ndyrë. Le të mendojnë për vetvrasje. Kurse letra do të bëjë punën e saj. Deri tani aksioni shkoi si jo më mirë. Epidami dhe Shpresa do të kënaqen. Patjetër dhe Bukuroshja.

Letra e shkurtër e spiunit, të cilin patrullat e gjetën të vetëvlarë në shtëpinë e tij, komandantit Katzen në fillim iu duk një absurditet, një rrjedhje mendsh, justifikim i një besniku të pafat. Mirëpo logjika e letrës, argumentet e saj, i kundërshtonin të gjitha këto.

Eshtë kjo arsyeja që ne nuk kemi gjetur asnjë gjurmë nëpër rrugët, shtëpitë, dyqanet dhe varrezat e qytetit.

Kjo është e vërtetë, mendoi Johan Katzeni. Ishte i detyruar që përsëri, për shqetësimet në qytet, të mblidhte komandën. Oficerët e kishin marrë vesh çfarë i kishte ndodhur spiunit, madje gati të gjithë e kishin mësuar përmendsh atë letër të shkurtër e të çuditshme që Servet Dacka (kaligrafia u identifikua) e kishte shkruar me dorën e tij disa minuta para se të vriste veten. Në të katër garnizonet pëshpëritej jo vetëm teksti i letrës së spiunit, por edhe thureshin variante nga më të

habitshmet për mundësinë e shfaqjes së Bukuroshes, për luftën e saj me simbole, për zhdukjen e gjurmëve. Ushtarët, gjithnjë në pritje të ndonjë zbarkimi të mundshëm, ishin të etur për fjalë, thashetheme, legjenda, gënjeshtër, përralla, ëndrra, të cilat, në front, luanin rolin e letrave të bixhozit. Ata nuk po e kuptonin se zbarkimi kishte ndodhur, por jo nga deti, përkundrazi, nga mbrapashpina, nga qyteti.

- Thonë se ishte agjent besnik. Vrau veten dhe tregoi të vërtetën.

- Pse ta vriste veten... Të tregonte njëherë.

- Komandanti i kishte vënë afat.

- Spiuni e kishte lakun në fyt. Edhe ti po të ishte do t'ia përmblihdje vetes me një karikator.

- Kurrë!... Shpresoj të mbetem gjallë.

- Lus zotin për këtë...

- Ku do ta varrosin, në qytet?...

- Nuk i dihet... Mbase kufomën e dërgojnë pranë familjes.

- Kjo nuk ka fare rëndësi... Mua dhe në gjumë më del teksti i asaj letrë të çuditshme...

- A ka pasur raste të ngjashme me këtë, domethënë me Bukuroshen?...

- Nuk e di...

- Disa thonë se në...

- Unë nuk besoj te asnjëra. Të gjitha i thur ose rezistenca, ose frika...

- Mirëpo letra ishte e spiunit. Shkrimi u identifikua...

- Edhe spiuni ka pasur frikë...

Diskutime të shumta, habi dhe frikë. Mosbesimi si një urith i stërmadh, brente rrënjët e moralit të ushtarëve të Rajhut.

Deri në çastin kur komandanti Katzen kishte marrë në dorë letërcudinë, qyteti për dymbëdhjetë orë rresht vazhdonte të qëndronte i populluar nga fotografitë e dëshmorëve dhe të internuarve. Tashmë ishte qyteti me popullsinë më të çuditshme në botë, thuajse të gjithë të vdekur, me plagë në trup. Madje

te disa nga oficerët po krijohej bindja së fotografitë po shumëfishobeshin. Mbase ishte ky shkak, që papritmas Komandantj Katzen lëshoi më në fund urdhrin gojor:

- Zhdukini fotografitë!

Kishte nga ata ushtarë e oficerë që mendonin se mbase Bukuroshja do ta kundërshtonte edhe zhdukjen e fotografive, dhe sipas tyre, ky qytet do të qëndronte përjetësisht me ato fotografi të mëdha. Komandanti Katzen, zëvendëskomandanti Gudorf, ky i dyti një skeptik i klasit të parë, si dhe shumë oficerë të tjerë, nuk shkonin deri në këta kufij fantazistë.

Menjëherë pas urdhrin, patrullat vërshuan në rrugët e rrugicat e tre lagjeve me një histeri të pashoqe. Nisi kështu një terror tjetër, ndaj po atyre njerëzve që para dyzetë ditësh i kishin masakruar dhe vrarë njëherë. Terrori ndaj fotografive, dukej më i thjeshtë sepse, siç mendonin ushtarët, nuk do t'i zinte gjaku e nuk do t'u sillte natën dhembje koke. Ky terror ishte njëlloj si djegia e librave në sheshet e qyteteve, apo diçka e përafërt me këtë. Megjithatë, po të shihje ata ushtarë me nofulla të shtrënguara, me sy të kërcyer si të zhabave, kuptoje se, veç gjakut, të zinte edhe vështrimi i syve të kthjellët, madje edhe buzëqeshja e atyre fotografive.

Pastaj, fotografitë e bëra shoshë nga plumbat, i mblodhën në sheshin e madh para komandës dhe i dogjën si në një auodafe inkuizicioni.

KAPITULLI X

HAMEJTE E BORES

Anija kishte ditë që priste në kalatën e portit të vogël. Komanda e Korparmatës kishte urdhëruar që për përpunimin e anijes të thirreshin disa nga dokerët. Gjithashtu për furnizimin

e katër garnizoneve me bukë, duhej të vihej në punë dhe fabrika e miellit.

Disa nga dokerët dhe punëtorët e fabrikës, sapo lexuan lajmin në gazetë, ditën e caktuar u paraqitën te postblloku në hyrje të qytetit. Atje i priste komandanti Katzen mbi makinë, si atëherë kur qyteti ishte boshatisur. Me punëtorët kishin ardhur edhe një nga drejtuesit e fabrikës, një nga drejtuesit e portit si dhe një punonjës dogane, i cili e njëjtte gjermanishten dhe do të luante rolin e përkthyesit. Komandanti Katzen i thirri të dy drejtuesit dhe me anë të punonjësit të doganës u paraqiti kushtet e punës. Të dy tundën kokat në heshtje. Pastaj njeri prej tyre, ai i fabrikës së miellit, u ngjiti në trotuarin anës rrugës dhe iu drejtua punëtorëve që prisnin:

- Dëgjoni këtu. Komandanti thotë se do të punoni në qytetet për disa ditë dhe do të paguheni normalisht. Menjëherë pas punës ditore do të largohemi me makinën e gjermanëve e do të kthehemi përsëri në shtëpitë tona. Gjatë kalimit në rrugën për në port e fabrikë, nuk do të bëhet asnjë shkëputje nga grupet. Çdo orvajtje për shkëputje, çdo lëvizje e tepërt, e dyshimtë, do të ketë pasoja të rënda! Kaq!

Komandanti Katzen, gjithnjë në makinën e tij, foli dhe përkthyesi ngriti zërin:

- Ka ndonjë pyetje?

Një nga dokerët, një burrë i fuqishëm, me kokë të shogët, veshur me një xhakëtë të hollë e të arnuar, foli qetë-qetë:

- A nuk do të ishte më mirë që këto ditë të banonim në qytet? Kështu nuk do të lodheshim e do të punonim më shpejt.

Johan Katzeni si duket ia thithi mendimin dokerit dhe pa prituri përkthimin e plotë, ia preti shkurt:

- Në asnjë mënyrë! Askush nuk do të flejë në qytet!

Dhe papritmas iu fanitën si të ngatërruara flamuri, tymi. Kosta Pëllumbi, lulet në varreza, fotografitë e të vrrarëve dhe të internuarve.

Pastaj punëtorët kaluan para ushtarëve të postbllokut, që kontrollohnin me imtësi.

Një varg prej dyzet e tre punëtorësh vazhdoi rrugën për në zemër të qytetit, me një mall që digjte si prush.

Lajmin për kthimin në punë të disa punëtorëve, Epidami dhe Shpresa e kishin dëgjuar në radio. Ishin hedhur nga gëzimi. Edhe vogëlushja e tyre, e cila qe disi më mirë, kishte përplasur doçkat.

Tani dylbitë, Epidami i kishte drejtuar larg, nga porta e vetme e qytetit.

- Po vijnë! Po vijnë! - foli ai me zë të dridhshëm nga emocioni.

- Janë shumë? - e pyeti e shoqja.

- Mbase pesëdhjetë, gjashtëdhjetë vetë.

- Qenkan pak.

- Megjithatë për këtë qytet janë shumë... Mbase dalngadalë pranojnë edhe të tjerët.

- S'ma merr mendja - tha ajo - Lajmi në radio nuk të linte të kuptoje kthim të banorëve.

- Ashtu është. Po kushedi ç'u pjell mendja nesër.

- Atëherë të shpresojmë.

Kishin kaq javë që shpresonin. Lajmet thuajse i përpinin nga stacionet e ndryshme të radios. Një gjë ishte e qartë: ushtrinë hitleriane po e hante dheu në të gjithë Europën. Këto ditë Shpresa ishte më e lehtë, më e freskët, më e gëzuar dhe kjo lidhej padyshim me përmirësimin e shëndetit të së bijës. Ushqimet ishin pakësuar së tepërmi, megjithëse Qamili u kishte sjellë ca pako makarona, oriz dhe sheqer.

Tani që kishte zhdukur Servet Dackën nga kjo botë, "pirati" e kishte më të lehtë lëvizjen. Nga sa kuptonte ai, Komanda e qytetit, mbase edhe Komanda e Lartë, kishin

krijuar bindje se nëpër lagje nuk vepronte njeri i gjallë. Mundej që edhe mobilizimi i forcave të bregdetit të ishte rritur. Siç dukej flotiljet angleze u ishin afruar brigjeve të Ballkanit.

Me ndihmën e dylbive të vjetra ata kishin parë anijen e ankoruar në port. prej saj do të ktheheshin në punë disa nga dokerët. Ky lajm i kishte tronditur. Në qytetin e tyre do të merrnin frymë një pjesë e banorëve. Madje Qamili kishte thënë se do të përpiqeshin të krijonin lidhje me punëtorët.

- Do të jetë e vështirë, ia kishte pritur Epidami, - sepse patjetër mbi të ardhurit do të ketë kontroll të rreptë. Pastaj, nuk duhet të harrojmë dhe mundësinë që në rradhët e tyre të ketë ndonjë provokator.

- Nëse janë dokerët që kanë punuar gjithë jetën në këtë qytet, në portin tonë, ata i njoh mirë, kishte shtuar Qamili, siç njoh pëllëmbët e mija.

- Megjithatë të vijmë njëherë se u mërzitëm vetëm, kishte thënë Shpresa.

- Ata kanë hequr më shumë se ne, - kishte ndërhyrë i shoqi.

- Qyteti, qyteti ka rëndësi. - fliste si i menduar "pirati".

Në qytet frynte një erë e ftohtë. Dokerët, të shoqëruar nga ushtarët dhe një nënoficer, ecnin në rrugën qëndrore drejt portit, duke kthyer kokat sa majtas e djathtas.

- Asgjë s'ka ndryshuar. Siç e lamë, e gjetëm, - foli me shokun në krah një mesoburrë i kërrusur.

- Shtëpia ime është matanë, në lagjen "Spirancë". Sikur të na jepnin lejë të shkonim, t'i shihnim njëherë - tha tjetri.

- Sot nuk mund të kërkojmë lejë. Dita e parë. Pastaj këta kanë frikë... - pëshpëriti mesoburri i kërrusur.

Heshtën pak. Mesoburri nxori një cigare, e ndau me tjetrin, pastaj i mori cigaren e ndezur shokut pas, për të xixosur të tijën.

- Dimër i egër, keq e kemi - foli përsëri mesoburri - Po më keq e kanë ata në male.

- Vështirë vërtet.

- Pushoni ju! - u dëgjua zëri i nënoficerit.

E mbyllën gojën.

Po afronin drejt ndërtesës së Bashkisë, tanimë të kthyer në komandaturë. Sahati shënonte nëntë pa pesë minuta.

Mesoburri i quajtur Stefan Baka, ishte nga ata të shumtët që i kishte besuar "piratit" çelësat e shtëpisë. Në atë çast po mendonte se ç'bëhej me atë njeri, i cili kishte fituar besimin e shumë njerëzve. Natyrisht që ata nuk kishin dëgjuar gjë as për Kosta Pëllumbin, as për Servet Dackën, të cilët gjermanët i kishin varrosur shpejt e shpejt, pa i lajmëruar familjet. Aq më tepër nuk mund të mendonin luftën e organizuar nga ca njerëz të mbetur në qytetin e evakuuar.

- Shumë vitrina qenkan thyer, - i foli përsëri Stefani shokut në krah.

- I shoh. Çfarë duhet të ketë ndodhur?

- Kushedi - tha Stefani dhe mendja nisi t'i punonte përsëri te "roja i qytetit". Mos vallë, mendoi, gjermanët i kishin pikasur lëvizjet e tij dhe e kishin kapur.

- Shikoji muret, portat, diçka kanë hequr prej tyre.

- Madje paska dhe vrina të krijuara nga plumbat.

- Mirë e vure re. Kudo plumba. Shikoji, shikoji dhe gëzhojat.

- Mos kanë mbetur që nga terrori, - foli një doker tjetër ngjitur me dy bashkëbiseduesit.

- Jo, jo. Unë banoj këtu pranë. Nuk ishin këto shenja, këto copëza letrash të mbetura në mure e porta, këto vitrina të thyera, shenjat e plumbave në porta...

Nënoficeri që i shoqëronte, vuri re pëshpërimat shqetësuese e kureshtarë të grupit të dokerëve, megjithatë e pa të arsyeshme të hiqej si i shurdhët.

- Filloi dëborë, - foli një djalosh me kasketë dhe u zgjat të kapte ndonjë nga flokëzat e artë-Dëbora në qytetin tonë gjithmonë ka qenë e bukur.

- Vërtet e bukur. - e mbështeti tjetri me sytë nga qielli.

Grupi prej tridhjetë vetësh shihte dëborën e imët. Mesoburri i kërrusur me emrin Stefan, përsëri mendoi Qamilin. Nëse do të kishte arritur t'i rezistonte të ftohtit dhe mungesës së ushqimeve. Ai që kaptoi detin me not, mendoi, patjetër që ka rezistuar.

Dang! Dang! Dang! Dang! Dang! Dang! Dang! Dang!
Dang!

Ora ishte nëntë.

Johan Katzeni, megjithëse e kishte ndërruar zyrën dhe kishte zbritur në katin e dytë, përsëri mbyllte veshët kur dëgjonte të rrahurat e çekanit të sahatit. I imagjinonte shpesh ato ingranazhe të mëdha se si vërtiteshin duke bluar kohën. Madje shpesh i dukej sikur arrinin të bluanin dhe atë, gjumin e tij, apo më keq akoma, besimin e tij. Nga Komanda e Korparmatës i kishin hequr vërcjtje, gjë që e kishte lënë dy net pa gjumë. I vinte ta hante veten me dhëmbë. Kishte filluar të dyshonte në aftësitë e tij. I dukej vetja i zbutur, pa forcë, pa fantazi, pa pasione. Ç'po ndodh me ty Katzen, ëë? ...Ç'po ndodh... Mbase vërtet nuk kishte vepruar mirë me atë agjentin që ia hoqi vetes, por edhe ai ia kishte punuar keq: ia kishte lënë një letër kopile, ku vërtetonte ekzistencën e Bukuroshes. Ndyrësira!

U ngrit nga karrigia dhe shkoi pranë dritares. Binte borë e lehtë, harraqe. Mbase dëbora do ta zbus pak të ftohtët, mendoi duke fërkuar duart. Kjo do të jetë mirë për ushtarët që presin në brigje. Poshtë në rrugë po kalonte grupi i hamejve që do të shkarkonin mallrat e anijes. Katzeni shihte kultrizet e tyre, shumica të kërrusura; shihte flokët e borës që binin mbi to, si në ca tambure; shkrinin, binin, shkrinin përsëri... "Hamejtë e borës", ...i erdhi ndër mend një titull absurd, mbase për opera, simfoni, koncert për piano dhe orkestër... "Hamejtë e borës". Qesharake vërtet. Fërkoi duart. Kishte ftohtë. Ca ethe

të brendshme i shpërthenin në kafkën e kokës së vogël... Koncert për bomba dhe orkestër. Qesharake Katzen i gJORë, qesharake! Dang! Dang! Dang! Do të urdhëronte që ora e qytetit të prishej. Dang! Dang! Dang! Patjetër të prishej!

"Natyrisht të priset!" - u dëgjua zëri i Gjeneralit Dimër.

Instiktivisht komandanti Katzen u ngrit në këmbë dhe mori qëndrim gatitu. Para tij ishte vetë Gjenerali Dimër, i madhërishëm, i egër, me spaleta akulli. Sa herë që fliste, shkrepëtinte.

"Një qyteti të vdekur, nuk duhet t'i rrahë pulsi, komandant.

"Siurdhëron!" - tha Johan Katzeni me sy të shkyer nga tmërri i shfaqjes së Gjeneralit Dimër, ngriti receptorin me vrull dhe, megjithëse nga ana tjetër e kabllit nuk e dëgjonte askush, foli prerë:

"Gjenerali Dimër urdhëron të priset ora mbi komandaturë!"

Pastaj hapi kanatin nën tryezën e tij të madhe, nxori që andej, gjithnjë me vrull, shishen e konjakut dhe dy gota:

"Të pimë, Gjeneral!"

"Natyrisht, të pimë!" - ia ktheu Gjenerali Dimër, i cili zuri vend në anën tjetër të tryezës, pa e hequr pallton e madhe, si të endur me fije tymi dhe zjarri.

"Po, kur erdhët, Gjeneral?"

"Si, kur erdha?... Unë këtu isha!..." - tha me habi dhe i nxehur Gjenerali Dimër.

Komandanti heshti. Nuk mund ta merrte guximin t'i thoshte shëfit se ai vetëm tani po e shihte realisht.

"Ah, po...", ia bëri sa për ta qetësuar.

Mirëpo Gjeneralit Dimër nuk i erdhi aspak mirë që komandanti i këtij qyteti, komandanti i katër garnizoneve bregdetare, i kishte bërë një pyetje kaq naive: "Kur erdhët,

Gjeneral". Domethënë se në këtë qytet nuk ndihej prania e tij. Gjeneralit Dimër. Ishte ky shkaku që këto dy muaj kishte patur ca turbullira të çuditshme, madje asnjë rezultat konkret.

"Ah, Katzen, Katzen!..."

"Pse?...Si?!...Çfarë doni të thoni?!"

"Asgjë...Asgjë..."

"Mos e keni fjalën për "Hamejtë e borës", koncert në famaxhor opus 1944...Për këtë e keni fjalën?...Atëhere, marr guximin t'ju them, Gjenerali Dimër, se ju nuk jeni asgjë. asgjë...Përkundrazi, unë jam diçka më shumë se ju....Alo, alo, alo, prisheni orën dhe ejani këtu! Kam përpara një kufomë: Gjeneralin Dimër!... Si?!...Nuk besoni?... Ejani, ejani...Dora vetë: Gjenerali Dimër!"

Komandanti Johan Katzen papritmas kaloi në një krizë nervore. Ishte fundi i muajit janar 1944. E shtruan urgjentisht në spitalin e kryeqytetit. Vendin e tij, përkohësisht e zuri zëvendëskomandanti Gustav Gudorf.

KAPITULLI XI

ÇELESAT E JETES

Qamili, tashmë i vendosur në katin e tretë të një ndërtese buzë rrugës kryesore, e kishte të vështirë të lidhej me punëtorët. Disa prej tyre i njihte mirë, kurse Stefani i kishte besuar edhe çelësin e shtëpisë. Kolona e dokerëve ruhej me fanatizëm nga tre ushtarë të armatosur dhe një nënoficer. Edhe me punëtorët e fabrikës së miellit, të cilët degëzonin gati në hyrje të qytetit ishte e pamundur të shkëmbente një vështrim, apo një fjalë. Gjëja më e mirë ishte që të vepronin, të kryenin një aksion që të binte dhe në sytë e punëtorëve. Kështu ata do ta kuptonin se ky qytet ia kishte arritur të merrte pakëz frymë në kohën e

evakuimit. Por të vepronte ishte me tepër rrezik. Zëvendëskomandanti Gudorf, tre nga projektorët e shumtë që kishin drejtuar sytë nga hapësira e pafund e detit, i kishte kthyer nga qyteti. Kështu natën, shtëpitë, rrugët, pemët, dyqanet, kishat, xhamitë, pusët, gardhet, të gjitha priteshin nga bajonetat gjigante të dritave. Mundësia e vetme për të vepruar ishte agimi, kur drita e projektorëve bëhej e pafuqishme dhe kur lodhja zaptonte patrullat. Do të vepronte vetëm, sepse çiflin e ngujuar në shtëpinë mbi kështjellë kishte ditë pa e takuar dhe nuk e besonte t'i shihte së shpejti. Po edhe vetëm mund ta bënte një aksion, të shkruante në një fasadë të dukshme muri, fjalën LIRI! Ideja e këtij aksioni i lindi pasi në shtëpinë ku strehohej gjeti një kuti me bojë të kuqe dhe një furçë. Fjalën do ta shkruante në agim, në fasadën e ndërtesës ku banonte vetë. Po pastaj ku do të shkonte? Nuk do të ishte keq të strehohej në furrën e bukëpjekësit, diku prapa ndërtesës. "Pirati" u përfshi nga ethet e aksionit të ri. I fshehur pas perdeve të dritares hodhi një shikim mbi qytetin e lëpirë nga gjuhët e projektorëve. Tutje, në krahun e majtë, dukej shtëpia mbi kështjellë. Imagjinoi ata të tre: Epidamin, Shpresën dhe Jetën e vogël, të strehuar në dhomën bodrum, e cila kishte lidhje me kështjellën dhe Bukuroshen e qytetit. Kushedi ç'bënin, mbase flinin, mbase dëgjonin lajmet e stacioneve të ndryshme të Europës, mbase bisedonin për gjallërimin e ardhshëm të qytetit.

Nëse në të gdhirë ai do të arrinte të shkruante në fasadën anësore fjalën LIRI, kjo do të ishte një fitore e vërtetë; punëtorët, që do të vinin nga e djathta e qytetit, do t'i shikonin patjetër ato shkronja-simbol dhe do të kuptonin shumë gjëra. Dhe në mbrëmje, kur të kthelleshin në strehët e tyre të varfëra, do të tregonin për vendlindjen që kishte ditur të kundërshtonte vdekjen. Nazistët nuk do të dyshonin për punëtorët, ngaqë kontrolli mbi ta ishte mjaft i rreptë dhe se, akoma pa u ngrysur, ata i hipnin në makinë dhe i largonin matanë qytetit.

Patrullat ishin mësuar të ecnin me kokat drejt dhe as njëherë lart, sepse në qiellin e qytetit nuk kishte as avionë, as pulëbardha, as zogj, kurse pëllumbat ose kishin ngordhur, ose rrinin pranë njeri-tjetrit në një shoqëri pikëllimi. Madje edhe kolegji i sorrave ishte bërë indiferente atje lart në komandanturë, apo në kubenë e xhamisë kryesore. Patrullat nuk i ngrinin kokat lart, mbase dhe nga pesha e lajmeve të zeza, që vinin nga të gjitha pikat e horizontit e që llisnin veç për një gjë-disfatën.

Mbase ishin këto arsyet që fjala LIRI shkruar nga dora e dikujt në fasadën anësore të një ndërtese, nuk u vu re as nga projektorët, as nga patrullat, madje as nga oficerët e paktë që shkonin të kthenin ndonjë gotë konjak në klubin e tyre.

Të parët që e vunë re ishin punëtorët.

- Shikoni, shikoni atje te ndërtesa mbi dyqane!

- E habitshme! Kush e ka shkruar?!

- Shshst! Bëni sikur nuk keni parë gjë! Na piu e zeza pastaj!

Mirëpo dhe drejtuesi i portit, punonjësi i doganës si dhe nënoficeri e tre ushtarët e patrullës, e kishin vënë re fjalën LIRI, që gati kishin mbushur fasadën. Nënoficeri mendoi se nuk ishin ata të parët që i kishin vënë re ato shkronja zjarri, megjithëse akoma ishte mëngjes herët, ndaj foli prerë:

- Vazhdoni rrugën!

Për të dhe tre ushtarët e patrullave, kjo ishte një e papritur tjetër, kurse për të sapoardhurit, ishte e papritura e parë.

- Domethënë ata xhamat e thyer të vitrinave, ato letrat që nuk ishin shqitur mirë nga portat dhe muret...

- Shenjat e plumbave në dyer....

- Ju thashë unë, diçka lëviz këtu.

- Shshst!

Përpara klubit nënoficeri e ndali kolonën. Nxitoi dhe hyri brenda. Përgjegjësi i patrullave qëndronte i mbështetur në

banak me një gotë konjak që s'e shkëpuste nga buzët e holla.
- Si?! - u habit nënoficeri - Ju jeni këtu dhe nuk i keni parë çfarë kanë shkruar?!

- Çfarë?!... - pyti gjysmë i dehur përgjegjësi i patrullave dhe menjëherë nxori nga këllëfi revolverin e tij.

- Eja, afrohu, shiko te ajo ndërtesa atje.

- E pamundur! - ia bëri përgjegjësi i patrullave dhe si i çmendur doli në rrugë.

Punëtorët e panë si vrapoi oficeri drejt ndërtesës, i shoqëruar nga tre ushtarët e patrullës. Çdo gjë ishte e qartë: ata po e shihnin të parët fjalën e shkruar, ndaj do ta kishin të vështirë t'i shpëtonin tërbimit të nazistëve.

Sapo dëgjoi të shtënat, zëvendëskomandanti Gustav Gudorf kërcëu nga shtrati dhe nxori kokën në dritare. Menjëherë sytë iu ngjitën te ato katër shkronja. Si ishte e mundur? Përsëri... Po kjo është vërtet e paabesueshme! U vesh shpejt e shpejt dhe doli në rrugë. Nënoficeri vazhdonte t'i mbante dokerët në një vend, thua jse përballë klubit. Dhe me të tijën nuk kishte vepruar keq. Ata ishin rreth treqind metra larg fasadës së shkruar.

- Po ti, pse i ke ngulur hamejtë këtu! Vazhdoni rrugën!
- ulëriti i tërbuar Gudorfi.

- Siurdhëron! - u përgjegj nënoficeri.

Por, kur kolona e dokerëve nuk kishte bërë as pesëdhjetë metra udhë, zëvendëskomandanti Gudorf, thërriti që nga larg:

- Alt! Alt!

Kolona përsëri ndali dhe nënoficeri u kthye me fytyrë nga eprori. Gudorfi po vinte me hap të rregullt.

- Mbajini dokerët këtu gjer në një urdhër të dytë, - i tha nënoficerit.

- Siurdhëron! - u përgjegj tjetri.

Pastaj Gustav Gudorfi, gjithnjë me hap të rregullt, u kthye përsëri në klub për të kërkuar në telefon shoferin. Gjatë

kësaj kohe banakieri i kishte sjell mëngjesin, pak proshutë dhe një gotë qumësht, të cilave Gudorfi ua nxorri fundin nxitimthi. O do ta gjente atë që kishte shkruar atë ljalë e që patjetër kishte sjellë të gjitha turbullirat në qytetin e evakuuar, ose do të pëlqiste.

Stefan Baka e mori me mend se në qytet dikush vepronte prej kohësh. Ky mund të ishte edhe Qamili. Një vrundull emocionesh i vërtitej në gjoks. I hodhi sytë nga fytyrat e dokerëve të tjerë. Edhe në to kishte rënë një hije shqetësimi.

- A nuk do të shkojmë në port? - pyeti punonjësën e doganës njeri nga hamejtë.

- Nuk e di, - ia ktheu punonjësi i doganës.

Në zërin e tij ndihej një ton që afrohej me mendimin "ç'na polli belaja!".

- Mbase do kërkojnë të kapin ata që e kanë shkruar, - tha Stefani.

Punonjësi i doganës nuk foli. Ai e kishte frikë qytetin e tij të braktisur, ku tani, sipas bisedës së gjermanëve, kishin filluar të vepronin djajtë. E kishte marrë vesh se Servet Dacka kishte ardhur këtu dhe nuk ishte kthyer më. Komanda i kishte dërguar familjes së tij, me shumë ditë ditë vonesë, një telegram ngushëllimi dhe asgjë më tepër. Madje as kufomën. Dhe njerëzit e familjes e kishin qarë Servetin jo të mbledhur rreth trupit pa jetë, siç ishte zakoni, por rreth fotografisë së të ndjerit (sikur ta dinin se pikërisht fotografitë e të vvarëve dhe të internuarve ishin shkaku kryesor i vdekjes).

Punonjësi i doganës, ashtu si dhe dy drejtuesit, e portit e të fabrikës së miellit, e kishin frikë qytetin. Këtë e kishin shprehur disa herë midis tyre. Jo më kot Komandanti i garnizoneve kishte pësuar një krizë nervore dhe ishte shtruar në spitalin e kryeqytetit.

Ishte një i ftohtë therës që ndihmohej nga era, ndaj dokerët u mblodhën pranë njeri-tjetrit, si për t'u ngrohur. Ishin

vetëm tridhjetë hamej. Punëtorët e fabrikës së miellit tani patjetër ishin duke punuar.

U dëgjua zhurma e makinës dhe dokerët kthyen kokat. Zëvendëskomandanti Gudorf, hapi xhamin e makinës dhe që andej u foli punëtorëve:

- Do të vini pas meje, kështu bashkë!

Punonjësi i doganës përktheu.

- Kurse ti eja hip në makinë. Do të përkthesh çfarë do të them unë.

- Siurdhëron! - tha i frikësuar përkthyesi dhe hipi në makinë.

Stefan Baka shtrëngoi duart e shokëve:

- Pisk e kemi punën sot!

- Të shohim ç' i ka pjellë mendja këtij qenit!

Makina ndali pranë ndërtesës së shkruar. Ndalën dhe dokerët, që sipas urdhërit të oficerit nazist, kishin ecur pas rrotave. Gustav Gudorf nxori një megalon dhe zëri i tij gjëmoi në gjermanisht. Stefan Baka dhe të tjerët kërkonin të thithnin ato fjalë të egra, kërcënuese, po s' mundën dot. Vetëm përkthimi i punonjësit të doganës i sqaroi:

- Ju që keni shkruar ato parrulla në fasadë, dorëzohuni! Dorëzohuni! Në rast se nuk dorëzoheni deri në orën dymbëdhjetë, këta tridhjetë punëtorë nuk do të kthehen të gjallë në shtëpi. Do të pushkatohen në vend!

Edhe zëri i punonjësit të doganës përpiqej të ishte i fortë, kumbues. Punëtorët, që prisnin pas makinës, dukeshin si një procesion mortor. Kishin ngrirë nga befasia e asaj ideje të çmendur që kishte pjellë mendja e nazistit.

- Kjo është e tmerrshme! - tha një burrë me kasketë - Ç' faj kemi ne?!

- Pikërisht se nuk kemi faj, e bën ai këtë - iu kthye Stefani, dhe iu fanit Qamili me cohën e zezë mbi njërin sy. Mbase mund të jetë ai, mendoi. Si erdhi puna, tani ai ka jo

vetëm çelësat e shtëpive, po edhe çelësat e jetës sonë.

Makina lëvizi përpara dhe ktheu në një rrugicë. Ecën pesëdhjetë-gjashtëdhjetë metra dhe ndalën. Procesioni i çuditshëm i dokerëve, i shtyrë nga tytat e mitralozave, vepronte si i kurdisur.

“JU QE KENI SHIKUAR ATE FJALE NE FASADE, DOREZOHUNI! NE RAST SE NUK DOREZOHINI DERI NE OREN DYMËDHJETE, KETA TRIDHJETE PUNËTORE NUK DO TE KTHIEHEN TE GJALLE NE SHITEPI! DO TE PUSHKATOHEN NE VEND!”

Në kohën që punonjësi i doganës përsëriste në megafon thirrjen, zëvendëskomandanti Gustav Gudorf kujtoi dhe njëherë letrën e spiunit Servet Dacka dhe u rrëqeth. Megjithatë ai, Gustav Gudorfi nuk do të tërhiqej. Ishte me nerva më të forta se Johan Katzeni dhe do të dinte të përballonte këtë situatë të vështirë. Planin e tij për t'i bërë presion ndonjë të fshehuri të mundshëm, do ta çonte deri në fund. Madje, në qoftë se ai ose ata nuk do të dorëzoheshin deri në orën dymbëdhjetë, do të jepte urdhër të qëllonin mbi punëtorët. Për këtë kishte vendosur.

Makina u kthye mbrapsht, kaloi përpara ndërtesës me fjalën LIRI! - dhe mori për në rrugicën tjetër. Punonjësi i doganës vazhdonte të përsëriste me ton pak më të ngritur, thirrjen dhe kërcënimin e diktuar nga nazisti.

- Po kjo nuk ka vend ku të rrijë! Eshhtë budallallëk! - tha njeri nga dokerët, ngjitur me Stefanin.

- Thamë se po punojmë disa ditë e po nxjerrim ndonjë lekë. Po na vdesin fëmijët nga uria, - foli një tjetër - kurse mendja e këtij po pjell hatanë.

- A thua vërtet do të na vrasë?

- Nuk e di, vëlla. Po këta nuk ia përtojnë. Tashmë kjo dihet. Ne jemi një grusht njerëz, kurse ata, po zhdukun me

mijëra e miliona.

- Kjo është çmenduri, çmenduri!

- Ruaj gjakftohtësinë!

Ora tingëlloi tetë herë. Dang! Dang! Dang! Dang!
Dang! Dang! Dang! Dang!

- Ka kohë akoma. Mos u temb. - iu kthye një tjetër -
Lufta duhej të të kishte burrëruar më tepër. Mbaje veten.

- Mirë, mirë...

Pësëri u krijua heshtje. Stefani ngrihi kokën nga qielli i murrmë. Në drejtim të tyre po fluturonte një pulëbardhë e vetme si një lajmëtare e martirizuar. Vetëtimthi Stefani mendoi për shpendin detar si për shpirtin e Qamilit, a thua kishte ndodhur një metamorfozë e domosdoshme për kushtet e një qyteti të boshatisur. Aq i besoi kësaj ideje, sa që i dukej sikur pulëbardha do të zbriste në rrugë, përballë makinës, përballë zëvendëskomandantit të zemëruar, përballë njeriut me altoporlant, përballë atyre tridhjetë hamejve dhe do të kthehej në një njeri trupmadh, me një sy të vetëm e do të fliste qetë-qetë: "Ja ku jam, komandant. Unë i bëra të gjitha".

Pulëbardha fluturoi dhe pak në drejtim të tyre, pastaj, si duket u kujtua që ishte larguar ca nga moli dhe brigjet me dallgë dhe bëri një rrotullim të shpejtë e u kthye. Stefanit i shpëtoi një "ah!" lehtësimi.

- Çfarë ke? - e pyetën dy shokë në krah.

Ishin mbledhur grumbull dhe psherëtima më e vogël dëgjohej nga secili.

- Agjë, asgjë. Po nuk dua që njeriu i fshehur të dorëzohet.

- Atëhere oficeri nazist do të na vrasë.

- Këtë nuk besoj ta bëjë - u hodh një tjetër - Eshtë thjesht një presion psikologjik.

- Nazistët nuk bëjnë lojëra. Po nuk u dorëzua, ai do të na vrasë.

- Unë them se i fshehuri do të dorëzohet.
 - Edhe unë.
 - Kurse unë nuk dua të dorëzohet. Ai ka jetuar në këtë qytet më shumë se dy muaj.
 - Kush ai?
 - I fshehuri. apo të fshehurit.
 - Dhe çfarë pastaj?... - tha i frikësuari - Edhe po të ishte në mal, mund të ishte vrrarë. Bile për të na shpëtuar ne, fëmijët tanë, ai do të ishte sakrifikuar.
 - Po ti, çfarë sakrifice ke bërë? - e pyeti Stefani.
 - Nuk ka ç'të duhet ty. Qaja hallin vetes. - i tha i frikësuari.
 - Atëhere të paktën mos përhap panik e frikë - tha Stefani i revoltuar. - Tregohu më i qetë. Shikoje oficerin si na vështron. Atij i bëhet qejfi po të shohë një copëz frikë në fytyrat tona.
 - Mirë e ka Stefani, asnjë fjalë. Jemi të gjithë burra. Të qëndrojmë - tha djaloshi me kasketë.
 Makina dhe, pas saj, tridhjetë dokerë, kaluan në një rrugicë tjetër. Tridhjetë mendime të ndryshme, karaktere të ndryshme, përjetime të veçanta. Po njeriu i frikësuar nuk mund ta mbyllte dot gojën. Tani po e njihnin mirë. Ishte një i papunë që kishte ardhur mes dokerëve sapo kishte lexuar lajmin në gazetë. Nuk ishte nga brumi i tyre, jo.
 - Një sahat muri është i saktë, kur lavjerësi lëkundet, - tha i frikësuari.
 - Për çfarë lëkundje e ke fjalën? - u hodh Stefani. - Ne nuk duhet të lëkundemi aspak.

NE QOFTE SE NUK DOREZOHENI BRENDA ORES DYM BEDIJETE...

- A nuk e kupton se gjermanëve po u rrëshqet toka nën këmbë dhe e kanë humbur fare logjikën? Ata le të lëkunden, madje le të bien të mundur.

...TE TRIDHJETE PUNETORET DO TE PUSHKATOHEN.

Ora dhjetë. Dang! Dang! Dang! Dang! Dang!
Dang! Dang! Dang! Dang! Dang!

- Komandanti nxori cigaren. Duket që e ka humbur durimin.

- A thua do të na vrasë! Nuk e besoj!...

- Ata janë tërbuar fare - tha i frikësuari - Mund të na vrasin edhe sikur i fshehuri të dorëzohet.

- Nuk do të dorëzohet! Qetësohu, bre burrë. Nuk e shikon si është ndezur lufta kudo.

- Të kuptoj, të kuptoj... Nuk flas më. Të bëhet si të jetë shkruar. Lavjerësi i sahatit lëkundet...

- Lëre lavjerësin! Kush dreqin ta ka mësuar këtë shprehje idiote! Ti ke zemër, je shqiptar. Lëre lavjerësin!

- E lashë, e lashë... E mbylla gojën...

**"JU QE KENI SHKRUAR NE FASADE,
DOREZOIHUNI! DOREZOIHUNI! NE RAST SE NUK
DOREZOIHENI DERI NE OREN DYMËDËHJETE, KETA
TRIDHJETE PUNETORE NUK DO TE KTHEHEN TE
GJALLE NE SHTEPI!"**

Ora njëmbëdhjetë.

Dang! Këta tridhjetë! Dang!... Punëtorë... Dang!
Nuk... Dang! do të... Dang!... Kthehen... Dang!... të gjallë
Dang!... në shtëpi! Dang! Dang! Dang! Dang! Dang!

Kishin dalë përsëri në rrugicën e parë. Tani tridhjetë dokerët prisnin pas makinës, me koka të ngritura lart, me shikimin nga fasada e madhe ku ishte shkruar njaft bukur
L I R I !

Nga goditjet e çekanit të sahatit mbi komandaturë, Qamili i fshehur të furra e usta Naimit, ndjente afrimin e orës: më të vështirë të jetës së tij. Pikërisht këtu kishte gabuar, kjo.

nuk i kishte shkuar ndër mend, që nazistët do të përdornin punëtorët për ta kapur. Dhe nuk e kishin menduar keq. Kishte më shumë se dy muaj që vepronte në qytetin e tij dhe tani i duhej ta linte, mbase përgjithmonë. Të dorëzohej?! Në këtë rast ia vlente. Ushtarët e Rajhut, nëse ai nuk do të dorëzohej, do të qëllonin patjetër mbi dokerët e pafajshëm. Megjithatë nëse do të dorëzohej, a do të besonin nazistët se të gjitha këto aksione i kishte bërë ai, i vetëm? Mbase edhe nuk do ta besonin. Këtu do ta ndihmonte Kosta Pëllumbi. Do t'u thoshte se kishte arritur t'ia mbushte mendjen shurdhmemecit që ta ndihmonte. Po, kjo mund të besohej. Atëherë çifti dhe fëmija i tyre që po shërohej, nuk do të prekeshin aspak. Pra ia vlente të dorëzohej. Në fund të fundit, që kur kishte vendosur sipas ligjit të detit, ai i kish marrë parasysht të gjitha, deri edhe vdekjen. Atëherë do të dorëzohej dhe kjo nuk ishte shenjë dobësie, përkundrazi. A nuk ishte ti, Qamil, foli me vete, që dhe pse në furtunal e kapërceve me not gjysmën e detit. Ti di të gjesh forca që të sakrifikosh një jetë për tridhjetë jetë. Mirë që makina po vërtitet këtej rrotull dhe nuk është drejtuar tutje, për në lagjen "Kala", sepse, larg qoftë, mund t'i ishte prishur mendja dhe Epidamit. Ai nuk duhet të dorëzohet. Po çelësat? Një gjerdan me çelësa e kishte akoma në gjoks, kurse gjerdanin tjetër ia kishte lënë çiftit. Çelësat nuk duhej të binin në duart e gjermanëve. Vendosi t'i fshihte në furrën e usta Naimit. E hoqi gjerdanin, përkëdheli vezmet e pastaj zgjati krahun në anën e majtë të furrës. Nëse arrij t'i them Stefanit, do të jetë gjë e mirë. Le ta dinë ku i kanë çelësat që më besuan. Nesër do të kthehen. Dang! Dang! Ora tingëlloi dy herë. Ishte njëmbëdhjetë e gjysmë. Makina ishte larguar, megjithatë zëri i panjohur vinte nga altoparlanti i dorës deri në furrën e usta Naimit.

- Po dal! - tha me zë.

Hapi derën me çelës. Doli. E mbylli përsëri dhe çelësin ia la të zotit nën kanatë. Asgjë nuk pipëtinte. Era e fortë sillte zërat e copëtvara. Deri në orën dymbëdhjetë... Do të pushkatohej... Punëtorët... Dorëzohuni! Për një çast iu duk

se mund të lëvizte lirisht. Ktheu kokën nga kështjella. Shtëpia mbi të dukej si e vizatuar. Instiktivisht ngriti kokën dhe përshëndeti shtëpinë. Mbase, mendoi, më shohin me dylbi. Gjithnjë kur kishte zhurmë dhe lëvizje, Epidami dhe Shpresa, të fshehur pas dritares, vëzhgonin me dylbinë e vjetër. U bëri ca shenja për të treguar se gjerdanin e çelësave e kishte fshehur te furra e bukëpjekësit. Pastaj, duke menduar që edhe mund të mos e shihnin me dylbi, u drejtua për nga rruga kryesore, ku ishte makina, ku prisnin punëtorët e ku njeriu me megafon kërcënonte duke e përmendur ca si më shpesh orën dymbëdhjetë, e cila po afronte. Dy-mbë-dhje-të! Edhe tetë minuta... Dy fusha të sahatit të madh mbi komandanturë (që këtej vetëm dy fusha shiheshin) tregonin të njëjtën orë: dymbëdhjetë pa tetë minuta.

Qamili bëri edhe disa hapa dhe doli i vetëm në rrugën kryesore.

Papritmas, sikur ajri të ishte prerë nga një thikë e stërmadhe, çdo gjë heshti: zëri në megafon, pëshpëritjet e dokerëve, padurimi i Gustav Gudorfrit, madje edhe akrepat e sahatit të madh, u mekën.

Qamili sikur mbiu përballë makinës, jo më larg se njëzetë metra. Dy ushtarë vrapuan drejt njeriut të çuditshëm me një sy të lidhur, si pirat klasik, dhe e kontrolluan nëse kishte armë. Asgjë. Pastaj e vunë "piratin" në mes dhe e çuan pranë komandantit, i cili i kënaqur nga loja e tij e suksesshme, zbriti nga makina me një pamje triumfatori. Pas tij, i mbuluar i tërë në djersë, zbriti dhe nëpunësi i doganë.

- Vetëm je? - pyeti të dorëzuarin Gustav Gudorfi.

- Po, vetëm?

- Si ka mandësi që të gjitha këto t'i kesh bërë vetëm?!

- Dikur më ndihmoi dhe ai, shurdhmemeci, Kosta i Pëllumbave. - tha me siguri.

- Shurdhmemeci ëëë!...Dokrra!...Megjithatë këto do t'i tregosh pak më vonë... Domethënë u dorëzove më në fund... Domethënë enigma u zgjidh.

Gustav Gudorfi i kënaqur, u vërtit njëherë rrotull të sapodorëzuarit. Ngriti sytë dhe pa hamejtë, të cilët rrinin si të magnetizuar. Nuk ishte mirë që ata t'i ndiqnin skenat e ardhshme, ndaj iu drejtua nënoficerit që i shoqëronte:

- Ju shkon dhe vazhdoni punën. Në anije ju presin.

- Si urdhëron, herr komandant!

Qamili dhe Stefani dhe pse disi larg, kryqëzuan shikimet. Nuk kishin mundësi të flisnin me zë. Të tridhjetë hamejtë, kishin ngrirë nga befasia e shfaqjes së Qamilit, shokut të tyre, që ata e njihnin kaq mirë. Po, ishte ai, Qamili i guximshëm, që kishte kundërshtuar arratisjen e Angjelin Gjeçajt dhe ia kishte dalë mbanë që me forcën e krahëve të kaptonte gjysmën e Adriatikut.

- Vazhdoni rrugën drejt portit! - u dëgjua zëri i nënoficerit gjerman dhe punonjësi i doganës, i çliruar disi nga kompleksi i frikës, nuk përktheu, por bëri vetëm me shenjë në drejtim të portit.

Dokerët ecnin ngadalë, me kokat e kthycera mbrapa.

Dang! Dang! Dang! Dang! Dang! Dang!

- Paska qenë trim i rrallë! - i tha Stefani.

Ora ishte plot dymbëdhjetë.

Dang! Dang! Dang! Dang! Dang! Dang!

Gustav Gudorfi, qetë-qetë, e shikoi "piratin" në syrin e vetëm, nënqeshi i kënaqur me veten e pastaj foli:

- Po Servet Dackën, ti e vrave? Fol!... Apo vërtet e vrau Bukuroshja? - i shpëtoi të thoshte zëvendëskomandanti.

Syri i vetëm i "piratit" shkëlqeu.

- Unë nuk kam vrrarë gjë. Besoj se Bukuroshja.

- Bukuroshja, eëë? - ulëriti Gudorfi - Ç'janë këto fantazira, përralla... Bukuroshja... Unë nuk i besoj këto! Nuk i besoj!... Servet Dackën e ke vrrarë ti!

Nëpunësi i doganës përkthente dhe ndiente djersët që i kullonin nga të gjitha porët e trupit, a thua se punonte në doganën e frikës.

- Jo unë, Bukuroshja, - u përgjegj gjithnjë i qetë Qamili.

- Atëherë, meqë e ka vrarë Bukuroshja, unë do të zhduk ty - kërcënoi Gudorfi duke nxjerrë revolverin nga këllëfi.

- Po në letërën e tij - shprehu mendimet me zë Gudorfi - agjenti ynë shkruante se aksionet i ka kryer Bukuroshja, ngaqë nuk u gjet asnjë gjurmë...

- Kjo është e vërtetë, - përforcoi Qamili.

- E vërtetë?!...Po ju pranuat se keni vepruar bashkë me atë, njeriun e pëllumbave. Atëhere?

- Por gjithnjë me ndihmën e Bukuroshes. Vetëm ajo mund të hynte e dilte në shtëpitë e qytetit pa çelësa, vetëm ajo nuk mund të linte gjurmë te flamuri, te varrezat, te pragjet e vatrat e shtëpive, te fotografitë e dëshmorëve, te shkronjat në mure...

- Mjaft!...Bukuroshja nuk ekziston!

- Gaboheni, zoti oficer, ajo ekziston. Ju mbase nuk e njihni njerën nga legjendat tona për një grua të quajtur Rozafë. I shoqi dhe kunetërit e saj nuk arrinin t'i ngrinin muret e kështjellës deri në fund, se ato shembeshin natën. Atëhere Rozafa pranoi të flijohej në themelet e kështjellës, që muret të ngriheshin normalisht. Pranoi, megjithëse nënë, me foshnje në gji...

Ndërsa njeriu me një sy tregonte legjendën. Gustav Gudorfit i shkoj mendja te "Nibelungët" dhe mendoi se si kishin arritur të krijoheshin këto perla. Cili shpirt, cila fantazi i kishte prodhuar. Ja, tani ky njeri kërkon ta bindë se Bukuroshja ekziston, madje këtë e përforcon me gruan e një legjende vërtet tronditëse, po në fund të fundit, legjendë. Deri atje ku muret e ngritura ditën, rrëzohen natën, legjenda nuk kishte ndonjë të re, madje ngjasonte disi me mitin e Sifizit, i cili gjithë jetën, me një heroizëm absurd, ngjiste dhe zbriste malin me gurin mbi supe. Mirëpo, mirëpo...përafrimi me këtë mit, shkatërrohej pikërisht nga një grua, nga një nënë me foshnje në gji, e cila për interesat e atdheut, guxonte të flijohej, të ndalonte rrëzimin e atyre mureve-sifizë e natyrisht t'i jepte një përmbajtje tepër të fuqishme legjendës. Sipas kësaj logjike,

edhe Bukuroshja duhej të ishte ajo Rozafa e Tlijuar, e cila vazhdon të kundërshtojë rrëzimin me dhunë të mureve të kështjellës. Këtë po përpiqej të argumentonte me zërin e tij të ngjirur nga kripa e jodi, apo mbase nga të ftohtët, ky njeri që i rrinte përballë si një ciklop.

- Bukuroshe nuk ka! - ulëriti përsëri Gudorfi - Nuk ka!

- Ka, zoti oficer. Dhe për këtë një ditë dhe ju do të bindeni.

Zëvendëskomandanti Gustav Gudorf, syzëurdulluar nga fjalët e atij njeriu të tmerrshëm me një sy, u tërhoq disa metra mbraja dhe urdhëroi ushtarët:

Zjaaarr!!

Breshëritë e tre automatikëve qëlluan mbi trupin e madh të Qamilit. Gjaku i tij i kuq rrodhi në të katër anët. Dëshmitarë të këtij pushkatimi ishin vetëm zëvendëskomandanti Gustav Gudorf, ushtarët e patrullave si dhe punonjësi i doganës, të cilit i kishte bërë përshtypje të rrallë ai dialog midis detarit të vjetër dhe oficerit nazist. Ky dëshmitar i vetëm, i mahnitur, i mrekulluar, i shushatur, i befasuar, do të tregonte më vonë me imtësi për fjalët e Qamilit dhe irritimin e oficerit nazist.

Dokerët po arrinin në hyrje të portit, kur dëgjuan breshëritë e automatikëve. Gjithçka ishte e qartë. Disa hoqën kapelet e nderimit. Disa pika loti rrëshqitën në fytyrën e rreshkur të Stefanit. Ngriti kokën lart dhe pa një pulëbardhë. Një pulëbardhë, si të ishte shpirti i "piratit".

Kushedi ku do t'i kishte fshehur çelësat e jetës.

KAPITULLI XII

PO JETOJME APOKALIPSIN, ROBERT

Bukuroshja sikur ndjeu krismat, dëgjoji klithjen e Shpresës, thithi valët e krahëve të pulëbardhës, ndjeu

gjakun e pastër të rridhte në porët e tokës dhe vrapoi si e dehur nëpër rrënjët e mermerta të qytetit. Ku të shkonte? Vrapoi te kali slaturues, i kërkoi ta çonte te tempulli i Artemisit, pastaj te hijerorja e Venusit. Hyu i detit, Redoni, kërkoi ta qetësonte, po Bukuroshja me lot në sy shkonte nga poli i Dhimbjes te i Dashurisë, nga Zemërimi te Urrejta, nga Vdekja në Jetë.

Këmbët më çuan te mozaiku. Bukuroshja vërtet dukej si e mbuluar nga lotët.

- Tani do ta kemi më të vështirë, - i thashë.

Ajo duhet të më ketë dëgjuar, sepse m'u duk sikur puliti sytë e zinj.

Në të katër garnizonet lajmi u përhap si zjarri në pyll: në qytet ishte kapur një njeri, një pirat i vërtetë, i cili kishte ngulur këmbë edhe para tytave të armëve, se ai i kishte kryer aksionet me ndihmën e Bukuroshes. Pra kjo nuk ishte as psikozë, as truk, as lajthitje e spiunit para vdekjes, por një e vërtetë. Dhe këtë, ushtarët e vendosur në brigjet rreth qytetit, kishin pse ta besonin. Në psikoza të tilla masive, një fakt i vogël, një fjalë, aq më tepër një lajm nga fronti i Lindjes apo i Perëndimit, kthehet në argument bindës, në një bazë të fuqishme që mbështet psikozën. Nga sa kuptonin ushtarët, punët kishin marrë rrepirën.

Ata lusnin çdo natë mosshfaqjen e luftanijeve angleze në horizont.

- Zoti na shpëtoftë!

- Megjithatë tani duhet të ruhem nga mbrapashpina.

- Bukuroshja... Ajo nuk e ka me ne të brigjeve.

- Sa naiv që bëhesh, ajo e ka me ne të gjithë. Madje ka mundësi që dëgjon dhe bisedat tona, mendimet tona.

- S'ka mundësi. Unë e kam shtëpinë në malësinë Harc, diku pranë malit Broken - ngulte këmbë ushtari me emrin Ralf.

- Po pastaj?

- Dihet se në atë mal, më 1 maj, Natën e Valpurgës, hidhet vallja e shtrigave, fantazmave.

- Këtë e thotë dhe Gëtja te "Fausti".

- Pikërisht te "Fausti". E pra unë jam nga ato anë. Madje me dhjetra herë kam marrë pjesë në festën e pranverës që bëhet në malësinë tonë. Prindërit e mi akoma besojnë se shtrigat e fërkuara me vaj fluturojnë dhe bëjnë orgji Natën e Valpurgës.

- Bukur shumë dhe Bukuroshja fluturon. bën orgji...

- Oh jo, unë nuk u besoj prindërve të mi. Unë nuk kam parë asnjë shtrigë, as një valle shtrigash, - thoshte Ralfi.

- Kurse Gëtja i ka parë dhe ti nuk je Gëtja. Ti je thjesht një idiot me uniformë.

- Mos më shaj se ti theva turinjtë! Unë të flas sinqerisht, jam nga malësia Harc, kam qenë vetë dhjetra herë në malin Broken, kurse ti, kurse ti... Qen! Pusht! Kokëgdhë!

Shokët e tërhoqën ushtarin nga malësia Harc, i cili çuditërisht ngulte këmbë se fantazmat nuk ekzistonin, kur mbase, do të bënte mirë t'u fliste të kundërtën.

Pikërisht në këtë kohë, projektori rrëshqiti gjuhën mbi detin e dhëmbëzuar. Një karikator mitrolozi sharroi dallgët.

- Kush qëlloi?

- Pse qëlluan?!

- Mos vallë është ajo?!...

- Të thashë... të thashë...!

- Unë asnjëherë nuk besoj në fantazma.

- Po ku beson?

- Te frika besoj. Dhe te nëna ime besoj. Dhe askund tjetër! Kupton, askund tjetër!

- Idiot!

Kishin vrarë një delfin. E kishi qëlluar që nga kodrat, duke dyshuar se mos ishte kurrizi i ndonjë nëndetseje, apo ndonjë polumbar armik. Sytë i kishte tepër të bukur; në to kishin ngrirë yjet e natës së ftohtë.

Roberti pa veten në pasqyrë. Flokët i qenë thinjur si qimet e harkut të violinës. Mjekrra i ishte rritur ca si shumë.

Bëri gati veglat e rrojes. Do të shkonte me shërbim në kryeqytet, së bashku me tre komandantët e tjerë të garnizoneve si dhe zëvendëskomandantin e përgjithshëm Gustav Gudorf. Në Komandën e Korparmatës do të diskutonin për Operacionin e Dimrit si dhe për fatin e mëtejshëm të trupave të vendosura në Brigjet e Pritjes. Patjetër që do të kthenin dhe në spital të vizitonin Johan Katzenin, për të cilin thoshin se në ditët e fundit kishte patur një acarim të mëtejshëm të sëmundjes. Lajmi i kapjes dhe i pushkatimit të njeriut të fshehur, i cili kishte qenë një nga shkaqet kryesore të krizës së komandantit, mbase do të luante për të rolin e ilaçit shërues. Robertit i interesonte që Johani ("herr komandant, thuaj!"), të kthehej sa më shpejt në postin e tij, sepse duke qenë i ngujuar në shtrat, ai nuk mund ta përkrahte e ndihmonte aspak. Me zëvendëskomandantin, Roberti kishte patur marrëdhënie jo shumë të mira, ngaqë Gudorfi nuk i kishte qejf oficerët me sens humori, e aq më keq, që gjenin kohë të luanin edhe në violinë. Ktheu kokën nga violina e shtrirë në tryezë, me bark të shqyer, si kufomë morgu. Të gjitha telat i kishte këputur sot pasdite vonë, kur ishte kthyer nga klubi. Gustav Gudorf i kishte thirrur t'u tregonte për të fshehurin e rrezikshëm dhe t'u tërhiqte vërejtjen të gjithëve për mungesën e syçeltësisë.

- Nuk është koha e gjumit, - kishte thënë zëvendëskomandanti - përkundrazi është koha e sulmit më të egër.

Pastaj oficerët e kishin pyetur eprorin se a kishte pohuar gjë ai "pirati".

- Asgjë...as...Doimethënë pohoi se gjithçka i ka kryer vetë, në fillim edhe me ndihmën e atij shurdhmemecit idiot.

- Po për Bukuroshen?, - kish pyetur Roberti.

Gustav Gudorf i ishte gëlltitur njëherë e pastaj kishte folur prerë, me një ndjenjë të dukshme mendjemadhësie:

- Bukuroshe nuk ka ! Nuk është e mundur të ketë! Ushtarët tanë nuk kanë nevojë për përralla të tilla. Përkundrazi. Na intereson që në rradhët e ushtarëve të ngrihet morali, si

dikur...Do të ishte me vlerë, përshembull, të flitet më shumë për "Vundervafenin" 1), si shpresa e fitores sonë.

Gjatë kohës që zëvendëskomandanti kishte marrë pak frymë, Roberti, gjithnjë në natyrën e tij, kishte ndërhyrë:

- Domethënë i fshehuri nuk tha asgjë për Bukuroshen?

Gustav Gudorfli ia nguli sytë violiniistit me veshjen e oficerit të Rajhut dhe me një ironi therëse ia ktheu:

- Nëse ne do të besojmë se ç'thonë letrat e spiunëve psikopatë, apo të ndonjë aventurierit me një sy, atëherë duhej t'i kishim ngritur duart qëkuri; duhej të kishim hedhur armët dhe të luftonim me violina.

Oficerët kishin qeshur me gjithë shpirt.

- Ushtria ka nevojë dhe për violinat ashtu si për zërin e Lili Marlenit, - iu kishte kthyer i mundur Roberti. Dhe sapo erdhi nga mbledhja në dhomë, në inat e sipër, duke sharë Gustav Gudorfli, kishte qëlluar me grusht violinën e tij dhe ishte betuar se nuk do ta prekte më me dorë këtë instrument që mund t'ia hante kokën.

Tani priste të agonte dhe të takonte Johanin.

Makina ndali para spitalit. Roberti kishte gjetur kohën ta vizitonte komandantin Katzen pak para të tjerëve. Ajo ditë e fillimit të shkurtit ishte e ftohtë dhe mbase këtë ftohtësi e shtonin edhe ato dhjetra kufoma, të pushkatuara apo të varura gjatë natës. Akoma i dëlnin para syve kufomat që lëkundeshin në trikëmbështa e në degët e pemëve. Masakra duhej të kishte qenë e madhe. Iu shfaq lumi Mozeli, i rrëmbyer, i shoqëruar nga një muzikë e Vagnerit, dhe mbi dallgët e tij bashkë me trungje notonin të mbyturit. Me këtë pamje kaloi portën e spitalit. Hyri në pavijon dhe mjeku me bluzë të bardhë e shoqëroi për të dhoma e Johanit ("herr komandant, thuaj!"). Gjatë rrugës në

1) "Vundervafen" - armë sekrete gjermane, e trumbetuar shumë në atë kohë.

korridorin e ngushtë, Robertit iu duk sikur përshkroi një nga rrethet e ferrit. Pacientët më të shumtë ishin oficerë dhe ushtarë të plagosur. Koka, sy, gjymtyrë, gjokse, trupa, gjithçka të fashuar, a thua, mendoi Roberti, sikur Fyrheri ka urdhëruar të ndërrohen uniformat.

Johan Katzeni nuk ishte shtrirë, qëndronte në këmbë pranë dritares, me vështrimin shëtitës diku tej xhamit. Hyrjen e Robertit ai e priti me gëzim të singertë.

- He, Robert, Robert, erdhe më në fund.

- Erdha Johan i dashur, erdha.

Johan Katzeni bëri sikur nuk e vuri re afrimin intim të komandantit të garnizonit të katërt. Dhe Roberti për këtë u kënaq pa masë.

- Si je me shëndet?

- Sot dukem disi më mirë.

- Ti qenke për mrekulli, miku im.

- O, jo dhe aq Robert. Mos harro se ilaçet më kanë fashuar trutë. - bëri Johani shakanë e zakonshme, natyrisht të gjetur para një jave.

- Ky korridor të mbyt me aromë jodi dhe ilaçesh - tha Roberti - S'ma merrte mendja se do të shihja kaq shumë të plagosur.

- Ke parë vetëm një korridor, Robert. Spitali është i madh dhe i mbushur me korridore të tilla, thuajse të ngjashme.

- Megjithatë Johan, rëndësi ka që ti më dukesh mjaft mirë. Do të jap dhe një lajm të gëzuar.

- Çfarë lajmi?! - pyeti Katzeni dhe një hije trishtimi i preu ballin e ngushtë.

- Në qytet kapëm një të fshehur.

- Si është e mundur?! - u habit komandanti Katzen dhe i zënë keq në befasi u ul në shtratin aty pranë.

- Mos bëra keq që ta thashë? - foli Roberti duke rrudhur buzët.

- Jo, jo, vazhdo, vazhdo.

- Ishte një mesoburrë me një sy, si piratët e dikurshëm.

Pranoi se i kishte bërë të gjitha vetë, me ndihmën e atij shurdhmemecit.

- Pastaj?

- Pastaj, në mbledhjen rrufe, unë pyeta zëvendëskomandantin Gudorf nëse i fshehuri kish folur për Bukuroshen.

- Dhe çfarë përgjigje more?

- Ironi dhe tallje, Johan i dashur. Kemi filluar t'i hamë kokat njeri-tjetrit. Sëmundja jote më dëmtoi dhe mua. Besoj se më kupton.

- Katzeni qeshi si me pahir.

- Po si arriti Gudorfi ta kapë atë të fshehurin? Apo patrullat?

- Jo patrullat. Me anë të punëtorëve.

- Ashtu?!...

- "Pirati" kishte shkruar fjalën LIRI në murin e një ndërtese buzë rrugës, pak më tej klubit.

- Po, po...

- Atë fjalë e vumë re vetëm në mëngjes. Gudorfi me altoporlant i kërkoi të fshehurit të dorëzohej, sepse në rast të kundërt do të qëllohej mbi hamejtë e portit. Gudorfi shëtiti me makinë nëpër disa rrugë e rrugica, duke lexuar thirrjen kërcënuese e më në fund i fshehuri u dorëzua.

- Hë! - Fshoi një tingull inatçor Johan Katzeni - Po ç'bënë me ta, e sollën në burg, e morën në pyetje?

- Jo, e pushkatuan në vend. - tha Roberti.

- Shumë keq! - tha prerë dhe i nevrikosur Katzeni dhe u ngrit në këmbë. - Shumë keq! Gustav Gudorfi duhej të priste. Duhej ta izolonte apo ta sillte në kryeqytet. Ai duhej të zbërthehej mirë. Gudorfi është treguar miop. Miop i madh, bile! Atë njeri të fshehur patjetër duhej ta kishte marrë në pyetje Gestapoja. Patjetër!

- Ashtu është, - e mbështeti Roberti, i cili po ndiente një kënaqësi cinike për veprimin e gabuar të zëvendëskomandantit Gudorf.

- Do t'i kërkoj Komandës së Korparmatës që të në nxjerrë nga spitali. Tani jam më i qetë.

- Po bën ndonjë kurë të mirë?

- Natyrisht. Këto në komodinë janë ilaçet e fundit. Të tjerat mund t'i marr me vete edhe në komandë.

- Po atëherë, mrekulli! Fol sa më shpejt me komandën e Korparmatës. - e nxiti Roberti.

- Mirë e ke. Pastaj do provoj t'i marrë në telefon - tha i gjallëruar Johan Katzeni - Po çfarë u tha në mbledhjen e Korparmatës?

- Shumë gjëra. Përgatitet një ofensivë tjetër. Brigadat partizane kanë pësuar humbje, u tha, por edhe humbjet tona nuk janë të pakta.

- Natyrisht. Ja, shiko spitalin dhe nxirr konkluzione.

- Në spital janë të gjallët - foli Roberti si me gjysmë zëri.

- Kuptohet... Po bëjmë mirë të mos flasim për të vرارët - tha Katzeni duke fërkuar tëmthat që kishin filluar t'i thinjeshin.

- U fol dhe për masakrën e sotme. More vesh gjë?

- Natyrisht, më thanë. Kam këtu një mik të ri, një arkeolog, i cili mbiu që në pikë të mëngjesit, duke më dërdëllisur për masakrën.

- Hasa shumë kufoma gjatë rrugës për në spital.

- T'i lemë kufomat... Po për zbarkimin, ç'u tha?

- Gjithnjë në pritje. Lufta në frontin e Italisë vazhdon të jetë e ashpër. Të forcohet gatishmëria, u tha.

- Kuptoj, kuptoj - ia bëri Johan Katzeni dhe thellë në subkoshiençë dëgjo i tingëllimin e sahatit të qytetit.

U hap dera e dhomës dhe hyri një infermier tepër i nxituar. Nga korridori vinin klithma e rënkrime të reja.

- Çfarë ka ndodhur? - pyeti Katzeni.

- Kontigjent i ri të plagosurish - tha shkurt infermieri, pastaj i nguli shikimin Robertit dhe doli pa bërë fjalë.

Derën e la të hapur dhe rënkrimet sikur shtoheshin.

- Mbylle derën - thirri Katzeni - Lufta po na vjen deri

këtu. Po jetojmë apokalipsin. Robert.

Skenën mes Qamilit dhe zëvendëskomandantit nazist, ata e kishin ndjekur të dy nëpërmjet dylbive. Gjumin ua kishte prishur ajo thirrje sa në gjermanisht e sa në shqip që i drejtohej të fshehurit me anë të një altoporlanti të vogël. Këtej, nga shtëpia mbi kështjellë, nuk shihej se çfarë ishte shkruar në fasadën anësore të ndërtesës. rrotull së cilës vërtiteshin makina. ushtarët dhe tridhjetë dokerët e portit. Epidami, duke dëgjuar fragmente nga teksti kërcënues, e kuptoi idenë e komandantit të ri dhe kishte frikë se "pirati" do të dorëzohej. Shpresa thoshte të kundërtën, se Qamili nuk duhej të ishte fare aty, po kushedi në ç'qoshe ishte fshehur. Mbase i kanë gjetur gjurmët, kishte thënë Epidami, ka lënë ndonjë shenjë. Po të kishin gjurmët, e kishin kapur fare lehtë, kishte thënë Shpresa. Dhe në ato katër orë mes çiftit ishin shuar e ndezur hamendje të llojllojshme. Dylbitë kaluan shpesh nga duart e njerit te duart e tjetrit, sytë vraponin me një shikim të ngrirë në rrugët e rrugicat ku kalonte makina. I ngujuari nuk jepte asnjë shenjë jete. Nëse ai është fshehur aty përreth, kam parandjenjë se do të dorëzohet, thoshte Epidami. Shpresa nuk dinte ç'të thonte; i kishte hipur tensioni nga ajo lojë e hidhur dhe antinjerëzore e nazistëve. Dhe pikërisht, në orën dymbëdhjetë pa tetë minuta, ajo pa atë që nuk dëshironte të shihte: Qamili që po dilte nga porta e një shtëpie përdhese, mbi të cilën ishte shkruar shtrembër "Bukëpjekësi". Ajo kishte klithur e trembur dhe ia kish zgjatur dylbinë të shoqit. Epidami mezi ishte përmbajtur. Komandanti i ri ia kishte arritur qëllimit! Para tridhjetë njerëzve të palajshëm, Qamili kishte falur jetën e tij. Në lentet e dylbive ata të dy, ilegali dhe hitleriani, diçka flisnin, bënin me shenja, kundërshtonin, pastaj një gojë e shtrembër, një urdhër i dhënë si në ngërc dhe "pirati" bie përdhe me forcën e gurit, kur ngulet për të zënë vendin e vet.

Mos! - ia bëri Epidami e pas tij edhe Shpresa.

Zjarri i karikatorëve shoshiti detarin e vjetër.

Në atë çast Bukuroshja ishte ngritur e tromaksur. kishte ardhur drejt të fshehurve, një çast. vetëm një çast. sa zgjatën krismat e armëve. e pastaj ishte tretur nëpër rrugët që vetëm ajo i njihje.

- Qamilin e vranë! - tha shkurt Epidami.

Shpresa zbriti poshtë dhe ia plasi vajit. Epidami nuk i hoqi dylbitë për të parë se ç' do të bëhej me të porsavrarin. Mirëpo në fillim komandanti me përkthyesin e pastaj ushtarët u larguan dhe "pirati" mbeti i shtrirë në mes të rrugës. sikur me anë të të sapo pushkatuarit kërkonin, t'i shtinin tmerrin atij qyteti rrebel. Po kjo zgjati pak kohë, vetëm dhjetë minuta, sepse edhe makina me komandantin e ri. edhe një grup ushtarësh, u kthyen si të trembur. mbase me frikën se mos kufomën e rrëmbenin fantazmat. E morën Qamilin. si duket me vendimin për ta kallur në dheun e varrezave.

- Lamtumirë, vëlla! - pëshpëriti i ngashëryer dhe zbriti poshtë pranë së shoqes që ishte zhytur në të thella.

- Si do t'ja bëjmë tani? - pyeti ajo - Qamili na ndihmonte shumë.

- Kuptohet ç' do të bëjmë: do të vazhdojmë. Një pjesë të çelësave i kemi ne. Kurse një gjerdan, nga sa kuptuam nga shenjat, ai duhet ta ketë fshehur te furra.

- Ato çelësa është vështirë t'i marrim përsëri.

- Do të punojmë me këto që kemi. U mësuam tani. - ia ktheu Epidami.

- Ky komandanti i ri më duket më i egër - tha Shpresa.

- Të gjithë njëlloj janë. Edhe ai tjetri. do ta kishte vranë Qamilin, do ta kishte torturuar deri në vdekje.

- Kam frikë, - tha ajo, - veçanërisht tani që Jeta është përmirësuar mjaft.

- Nga sa kuptojnë, këtyre po u vjen fundi. Radiot flasin e flasin. Brigadat partizane po fitojnë mbi ta, megjithëse mes një dimri të egër.

- Pikërisht kjo i tërbon më shumë dhe ne... - iu kthye

ajo.

- Mirë, mirë, po tani mos e kalo masën. Po na dëgjon edhe vajza.

Ë bija vërtet po ndiqte bisedën e tyre dhe, kur ata nuk e prisnin, ajo, për të parën herë, foli me logjikën e dikurshme:

- Mami, mos ki frikë... Ne do të na ndihmojë Bukuroshja.

- Foli... Foli! Foo-llii! - thërritën prindërit njëzëri dhe e mbuluan vajzën me njëmijë të puthura.

KAPITULLI XIII

HENA PREJ LETRE

Në të katër garnizonet një pjesë e ushtarëve ishin të rinj, nën moshën shtatëmbëdhjetë vjeç. Tek ata frika i ngulte kthetrat më lehtë. Lajmet e vazhdueshme nga frontet e Lindjes e të Perëndimit, disfatat në disa vende ballkanike, ku kishin luftuar vetë, përgatitën në ndërgjegjet e tyre terrenin e një sulmi gradual e të padukshëm psikologjik. Zhgënjimi kishte filluar. Proklamata e Fyrherit me rastin e Vitit të Ri, megjithëse ishte propaganduar disa herë deri në ato ditë shkurti, nuk kishte arritur të hidhte rrënjë të thella te ushtarët, madje dhe te disa nga ushtarakët më madhorë. Këtë Gustav Gudorfi e nuhaste. Ai i sugjeroi shtabit të Komandës që veçanërisht me ushtarët më të rinj, të organizonin një mbrëmje në sallën e madhe të kinemasë. Do të shfaqnin një film e pastaj ai, Gudorfi, do t'u fliste e do të ndihmonte në ngritjen e moralit të tyre. Komanda këtë sugjerim e priti mirë, veçse dikush, dhe pikërisht Roberti, u kishte kujtuar se kjo mbrëmje përkonte me fillimin e javës së karnevaleve.

- Këtu nuk ka ndonjë të keqe, - kërceu Gudorfi - karnevalet janë një festë popullore për ne, kështu që me këtë rast edhe shfaqim një film, edhe ndihmojmë në ngritjen e

moralit të ushtarëve.

Roberti nuk foli. Logjika e eprorit e kishte thyer mbase përkohësisht.

- Vërtet që kishim harruar se nesër fillojnë karnevalet.

Grosse karneval!

- Kurse te ne në Bavari ato organizohen në tetor.

- Ju i quani **Fashung**, apo jo?

- Pikërisht.

- Në këto ditë Këlni im bëhej i mrekullueshëm.

- Kujdes kohën e foljeve, - i pëshpëriti dikush.

- Ti je veshur ndonjëherë karneval?

- Natyrisht. Bile disa herë. Një herë jam veshur si muzikant dhe i bija një trompe.

- Po princ ke qenë?

- Kam qenë. Dhe princesha ishte një vajzë e mrekullueshme. Atë ditë shijoi puthjen e parë.

Gustav Gudoni i dëgjonte dialogjet që rrëshqisnin mbi syprinën e errët të tryezës së gjatë dhe në qënien e tij ndjeu një peshë malli. Edhe ai ishte veshur dikur si palaço dhe kishte parakaluar me turmën e pafund duke hedhur karamete e bombone majtas e djathtas rrugës, ku vraponin qindra fëmijë të shkathët me trasta të vogla në duar. Hidhte dhe thërriste si të tjerët: "Oleo, oleo, ole!", "Kamele!"¹⁾). Fëmijët mblidhnin karametet, bombonet, çokollatat, sheqerkat, duke bërë kullotumba e duke u thirrur karnevalistëve: "Die Naren! Die Naren!"²⁾). I gjithë qyteti ishte veshur me rrobe mbretërishe, palaçosh, muzikantësh, princeshash, ushtarësh, murgeshash, priftërinjsh, banakierësh, fshatarësh, gjeneralësh, marinarësh dhe secili përpiquej që me anë të veshjes të plotësonte një ëndërr të vjetër. Fytyrat ishin mbuluar me maska apo me njolla bojërash. Hallet kishin avulluar një çast dhe qielli i qytetit kondensonte veç gëzimin. Seriozitetit i ishin prerë këmbë e duar.

1) Thirrje karakteristike në këto ditë feste

2) Die Naren!- të marrët! (Kështu u thërrasin karnevalistëve)

Edhe kur ndonjë i papërgatitur për festën, dilte në rrugë i veshur serioz, si në ditët e zakonshme, me kostum e kravatë, pa maskë e pa grim, atëherë një pjesë e turmës shkëputej nga rrjedha duke thirrur: "Olco, olco, ole!", e fushin qytetarin serioz në mes dhe ia hiqnin kostumin, ia prisnin kravatën me gërshërë, pra e detyronin të kthehej në karneval...Këtu Gudorfi s'e mbajti dot buzëqeshjen

- Është e parë herë që e shoh të qeshë me vete, - i tha Roberti një ushtaraku në krah.

- Ka edhe ai kujtime nga jeta civile, - ia ktheu tjetri.

Ushtarët dhe oficerët erdhën nga garnizonet me makina të mëdha. Secili ndiente lumturi që kishte arritur të zgjidhej për në mbrëmje. Për ta do të shfaqej një film me të bukurën Daniel Darrie. Hynë në sallë me rregull dhe hoqën kapelet. Ushtari nga malësia Harc, i cili para disa kohësh ishte grindur me një shokun e tij për pamundësinë e shfaqjes së shtrigave e fantazmave, tani diskutonte me një tjetër për festimin e ditës së karnevaleve.

- U bëra princ. Mbretëresha, një mësuesja jonë e veshur bukur, me kurorë mbi krye, më solli pranë princeshën e mrekullueshme. Ishte me të vërtetë një vajzë për ta pirë në kupë argjendi. M'u duk vetja dhëndërr, megjithëse pesëmbëdhjetë vjeç djalë.

- Dëgjo Ralf, më mirë i lemë kujtimet. Të them të drejtën ato më ngacmojnë shumë, ndiej dhembje.

- Ndonjëherë ato duhen, Hans. Kujtimet na mbajnë gjallë.

Hansi, disi më i vjetër e më me përvojë, e uli zërin dhe iu drejtua ushtarit nga malësia:

- Sot gjithë ditën kam qenë i ngarkuar me kujtime, kupton? Dhe kam arritur në një përfundim të çuditshëm.

- Çfarë përfundimi?

- Këtë do të ta them më vonë, Ralf. Nuk është vendi

këtu.

Ralfi heshti. Kurse Hansi kaloi shikimin te rradhët para tij. I ra në sy mosha e re e ushtarëve të pranishëm. E kishte kuptuar se komanda kërkonte t'i argëtonte, t'i gëzonte, t'u shtonte optimizmin. Vërtet ata ishin të rinj, por lufta i kishte burrëruar para kohe. Një vit në luftë ishin sa për dhjetë vjet në jetën civile. Një pyetje e ngacmonte: çfarë mund të na bëjë një film limonadë, apo një fjalim i zëvendëskomandantit? Asgjë. Dhe si për dreq i erdhi ndër mend një detaj nga jeta civile: kishin shkuar në kinema një grup nxënësish për të parë Greta Garbon, mirëpo në aktin e dytë në ekran të gjithë kishin parë disa sekuenca nga filmi "Diktatori i madh" i Çarli Çaplinit, pikërisht çastet kur ai, diktatori, qëllonte me vithe globin-tollumbac. Ishte më shumë se një skandal. Patjetër vepër e antifashistëve. Akoma dhe sot çuditej se ku e kishin gjetur atë kopje filmi. Një grup nazistësh kishin kërkuar operatorin dhe e kishin pushkatuar në vend pa pritur shpjegimet e tij. Karnevalet festoheshin dhe kështu, mendoj.

— Po vijmë oficerët, - foli Ralfi

Salla u ngrit në këmbë. U shitan dritat dhe në ekran u duk ylli i kinematografisë.

Të paktë ishin ata që e ndiqnin me vëmendje të veçantë filmin "Kthehem në agim". Madje disa nga ato koka pa kapele, shumica të qethura, krijonin tituj të tjerë si "Kthehem me karnevalet", "Kthehem në pikëllim", "Nuk kthehem dhe pikë", "Kthehem në perëndim"... Edhe Roberti e ndiqte filmn pa qejf. Flitej se Katzeni do të kthehej së shpejti nga spitali. Mbase ishte kjo arsyeja që Gudorfi përpiquej të tregohej gjithnjë e më aktiv. Mirëpo nuk po i ecte. Patjetër që ishte nxituar me pushkatimin e të fshehurit.

Filmi mbaroi me një "happy and", gjë që salla e priti me duartrokitje. U ndezën dritat dhe ushtarët pushuan si me urdhër. Gustav Gudorfi u ngrit qetë-qetë, me hap të rregull ngjiti tre shkallët e drunjtë që e çonin në podiumin poshtë ekranit. Nderoi "alla Hitler" dhe nisi të fliste i sigurt, si njeriu

që kryen detyrën. Pëlqente frazat pompoze të Niçes, madje shpesh u referohej atyre, natyrisht me një gjuhë më të thjeshtëzuar.

... "Vdekja e perëndisë, pra vdekja edhe e Bukuroshes, e cila kërkon të jetë mbi ne, sjell lindjen e mbinjeriut. Kështu mund ta perifrazonim Niçen, ushtarë të Rajhut të Tretë. Pra ne jemi mbi gjithçka. Bukuroshja as nuk ka ekzistuar e as nuk ekziston në këtë qytet. Ju jeni në dijeni të ilegalit të fshehur, të cilin e zhdukëm para disa ditësh. Ai e mbase edhe ndonjë tjetër që e ka ndihmuar, kërkonin të përligjin veprimet e tyre me gjoja ekzistencën e një farë shpirti rrebel, kryengritës, që e simbolizoka me Bukuroshen. Kjo është absurde dhe pohimet e të fshehurit e vërtetuan këtë (Gudorf i u gëlltit). Zotërat, ushtarë të Rajhut, janë vetëm përfytyrime dhe pretekste poetike".

Roberti qeshi. Përsëri Niçja, tha me vete. Gudorf i po fliste nga podiumi si të ishte Zarathustra i veshur me uniformën naziste, i arratisur nga pyjet e i vendosur në këtë bregdet të butë. Ushtarët, të rinj e të vjetër, e vëzhgonin fytyrën dhe fjalimin e zëvendëskomandantit nga këndvështrime të ndryshme: miratonin, duartrokisnin, rrudhnin buzët (jo të jashtmet, po ca buzë të brendshme, diku pranë zemrës)...

"Proklamata e Hitlerit me rastin e Vitit të Ri, lajmet nga fronti i Lindjes por dhe nga fronti i Italisë, duhet të na rrisin besimin, të fshijë nga ne çdo gjurmë disfatiste, çdo psikoze të dyshimtë... Kam besim te ju, ushtarë, te eprorët tuaj... Hail Hitler!"

- Hail Hitler! - u përgjegj e tërë salla e ngritur në këmbë.

Roberti ishte afruar pranë së vërtetës: besimi i ushtarëve ishte kthyer në një anije të bombarduar gati në të mbytur, që pritej të braktisej nga dita në ditë, apo nga muaji në muaj. Madje ky mosbesim kishte filluar të bëhej brejtës, lëngatë edhe për disa nga kolegët e tij ushtarakë.

Fjalët e tua, i mjeri Gudorf, mund të ngjiten si baltë në trutë e disa ushtarëve, po përpara meje ti nuk je më shumë se

një zhabë që guak para furtunës. Me kthimin e Katzenit, gusha jote, zhabë e fëlliqur, do të pëlcasë.

Salla duartrokiste. Kishte filluar zhurma lëvizëse. Salla nisi të zbrazej. "Kanë festën e karnevaleve. foli me vete Roberti, duke parë fytyrat e gjallëruara të ushtarëve, dhe shumë prej tyre sot mund të ishin prindër, duke qeshur e lozur me vajzat e bukura si princesha".

Hansi dhe Ralfi dolën nga salla krah për krah.

- Zakon i karnevaleve është që të vishesh ashtu siç dëshiron. Atëhere ne na duhej t'i hiqnim këto rrobe ushtarake e të visheshim civilë, - thoshte Hansi.

- Këto doje të më thoje? - pyeti ushtari nga malësia Harc.

- Ka edhe më, Ralf.

- Çfarë?...

- Ëndërrat...

- Si ëndërrat?

- Ka kohë që shoh ëndërra të frikshme. Dikur ndodhte krejt ndryshe: ose nuk shihja fare, ose shihja ca ëndërra të kristalta, me mbinjerez, sipas fjalëve të mësuara... Kurse sot, sot pashë në ëndërr nënën time që zhytej në një batak duke thërritur: "Hans, ndihmë Hans, ndihmë se po mbytem!". Dhe kur unë shkova ta ndihmoja ajo nuk pranoi, po u tremb duke thërritur: "Ti nuk je Hansi, ti je thjesht një karneval që kërkon të tallesh me mua. Die Naren! Die Naren!".

Ralfi e dëgjonte syshkyer, a thua se ajo që tregonte shoku i tij po i ndodhte parasysh, në një ekran tjetër, shumë më i madh se ekрани i vjetër i kinemasë së këtij qyteti të vogël.

- Mjaft me ëndërra, Hans. Sot dua të jem i qetë.

Tjetri e qepi gojën.

Nata e gjithëpushtetshme kishte mbuluar qytetin. Ushtarët hipën përsëri në makina. Dikush, apo disa njëherësh, vunë re diçka që regëtinte në qiellin e prerë nga fashat e

projektorëve. Nata s' ishte me hënë e megjithatë ajo diçka shkëlqente si hënë në mes të qiellit.

- Nuk është hëna, është meteor.

- Qorr! A nuk e sheh se ajo është thjesht një balonë?

- Balonë?!

- Natyrisht që balonë me bisht, balonë fëmijësh...

- E pamundur!

Projektorët kërkonin të kryqëzonin atë balonë të vockël, të bardhë, të rrumbullakët si një hënëz të plotë.

- Idiotët! - shau Gudorfi ushtarët në projektorë - Pikërisht tani duhej t'i shuanin dritat. Të gjitha ato fjalë të bukura që deklamova para ushtarëve, rrezikohen të shemben nga kjo dreg balone!

Megjithatë iu duk budallallëk të vinte re një shenjz të tillë që mund të ishte ngritur edhe nga ndonjë ushtar i përmalluar ditën e karnevaleve. Makina e tij u afrua më pranë hënës prej letre. Ishte thjesht një balonë pa asnjë inicial. Gudorfi u lehtësua. Patjetër ndonjë trill ushtari, u përpoq të qetësonte veten.

Ushtarët nuk guxonin të flisnin hapur, rrallë përsërisnin në veshin e shokut apo mikut të garantuar. Ajo balonë ishte si gjithë të tjerat, si ato që kishin ngritur dikur, para disa vitesh në qytetet e tyre. Natyrisht tepër e zakonshme, prej një letre të rëndomtë, e rrumbullaktë sa një hënë, po ja që kishte dhe vetinë e hënës: po krijonte baticë në shpirtat e tyre. Kush duhej ta kishte ngritur. Ndonjë ushtar i patrullës? Kjo ishte e pamundur. Askush nuk kishte qejf të luante me kokën. Megjithatë s'i dihej: edhe mund të luante.

Makinat u larguan nga qyteti.

Ushtarët duket sikur lehin me fytyrë nga kjo hënë prej letre, mendonte Roberti.

Nga shënimet në ditar:

- Ç'të bëjmë? - më pyeti Shpresa. - Më duket se asnjë veprim nuk do të na ndihmojë.

- Të bëj një balonë për ty, Jeta? - pyeta vajzën duke i dhënë njëkohësisht përgjigjen gruas.

- Mirë babi, një balonë të bukur, po ku do ta ngremë?

- Në qiell.

- Në qiell?... - u tremb Shpresa - Po ata do të na gjejnë.

- Nuk do të na gjejnë. Ky do të jetë aksioni i vajzës.

Balonën do ta ngremë larg oborrit tonë. Pastaj në letër nuk do të shënojmë asgjë, asnjë shenjë. Mos harro, janë ditët e karnevaleve dhe ushtarët kanë ardhur për të festuar. Qyteti duhet t'u tregojë edhe atyre se ka jetë...

- Me një balonë fëmije?... - qeshi Shpresa.

- Natyrisht, - i thashë - që edhe një balonë në këtë natë pus, ka vlerat e veta.

Shpresa pa nga Jeta, e cila e kërkonte vërtet këtë balonë.

- Kam pak letër të mirë në sirtare, ja ta nxjerr, - tha ime shoqe.

KAPITULLI XIV

E R A

Frynte. Në detet rrotull vërtiteshin flotat luftarake ndaj dhe garnizonet e bregdetit ishin vënë në gatishmëri numër një.

Komandanti Johan Katzen qe kthyer përsëri në vendin tij, kurse Gustav Gudorfi, ishte tulatur si më parë. Komanda e Korparmatës i kishte folur ashpër dhe i kishte tërhequr vërejtjen për vrasjen në vend të njeriut të fshehur, sepse ai vërtet duhej të kishte kyçur në kokën e tij shumë sekrete, me të cilat Gestapoja do të ndihmohej. Dhe jo vetëm Gestapoja, por edhe qyteti misterioz.

Gjatë kësaj kohe, psikoza se në qytet vërtitej Bukuroshja, kishte përfshirë akoma më shumë masën e ushtarëve. Dhe këtë psikozë Katzeni e shihte të reflektonte dhe në raportet që i

dërgonin garnizonet e bregdetit. Duke shfletuar raportet, vetvetiu i erdhi ndër mend biseda në spital me oficerin e plagosur, me profesion arkeolog, i cili i kishte treguar se kolegu i tyre austriak në Luftën e Parë Botërore, e kishte zbuluar Bukuroshen duke hapur një vendstrehim. Atij, austriakut, i qe lidhur gjuha dhe kishte mbetur i mahnitur nga mrekullia e shfaqjes. Duhej të ishte pikërisht ky hutim, arsyeja kryesore që ajo i kishte rrëshqitur nga duart, si një masë xhelatinoze.

Johan Katzeni i kishte përpirë fjalët e arkeologut të plagosur, të cilat në vend që ta ndihmonin kurimin e tij, ia kishin acaruar më tej nervat.

“Duhej të përmbahemi, i dashur koleg, - e kishte këshilluar arkeologu.- Ndonjëherë ndodhin dhe gjëra të çuditshme që nuk kemi mundësi t'i pengojmë. Për shembull disfatat”.

“Disfatat?” - kishte pyetur me një zë të trembur Katzeni.

“Po, po, disfatat. A e keni lexuar librin e Cvajgut për jetën e Shlimanit?”.

“Po. E kam lexuar para se ta digjnin...”.

“Tërë përpjekjet e Shlimanit ishin njëlloj lufte me fitoret dhe disfatat e veta, me zhgënjime sa kozmike aq dhe të rëndomta. Dhe të gjitha këto për të gjetur një Trojë të lashtë, një epike të kthyer në gërmadhë”.

“Po që akoma mban emrin Trojë”, ndërhyri Katzeni.

“E kuptoj, e kuptoj, - ia ktheu tjetri me sytë e vegjël dinakë e të lëvizshëm si sfera zhive. - Por gjatë shekujve Trojat përsëriten”.

“Si përsëriten?! Në ç’kuptim?” - pyeti Katzeni.

“Në kuptimin më të thjeshtë: edhe historitë njerëzore përsëriten”.

Katzeni u kollit. Kjo iu duk diçka me shumë zarrar. Ishte përpjekur të zemërohej, por nuk ia kishte arritur, sepse siç duket në subkoshiençë i kishte hyrë qëkuri ai krimbi brejtës që

thërmon gradualisht edhe bindjet e dikurshme, edhe mitet e pathyeshmërisë, edhe mburrjet shoviniste për supermacinë e racës.

“Kot zemëroheni mik i dashur, ju madje doni të dilni sa më shpejt nga spitali - i ishte kthyer arkeologu i plagosur. - Këto mendimet e mia nuk janë krejtësisht origjinale. Po ju them se shumë ushtarakë të Rajhut po komandohen nga dyshimet...”

“Ju lutem e ndërpresim këtë bisedë! - i kishte thënë prerë Katzeni, duke menduar se mos ai arkeologu, kaq i çliruar nga komplekset, mund të ishte ndonjë provokator. të cilët, siç thonin, ishin shtuar jashtë mase këta muajt e fundit. Madje flitej se Hitleri, atje në Berlin, sapo kishte zbuluar një komplot të madh kundër tij, dhe po zhdukte me qindra e mijëra ushtarakë komplotistë.

Mirëpo arkeologu, duke patur përpara kolegun që komandonte një ushtri në një qytet tepër të lashtë, nuk mund të rrinte pa folur, pa zhbiruar. Hamendjet dhe dyshimet e tij kishin qenë të shumta, aq sa Katzenit atëherë i kishte shkuar në mendje se ata të dy duhej të kishin ndërruar në fillim postet, (si arkeolog tjetrit do t'i bënte mirë jeta në atë qytet të vjetër) dhe së dyti të ndërronin pavionet, Katzeni të shkonte te të plagosurit, kurse arkeologu te të sëmurët me neurozë. Këtë lojë e rebus hierarkik, ai nuk ia kishte thënë oficerit me profesion arkeolog, nga i cili, sidoqoftë, diçka kishte mësuar.

Raportimi i fundit vinte nga porti. Njoftonin se çfarë mallrash kishte shkarkuar anija e tyre. Mjaft pije si konjak, rum, uiski, liker, shampanjë, verë, do të ndihmonin ngrohjen e ushtarëve në dimër. Kishte frikë se mos do të stimulonin edhe fantazinë e frikën e ushtarëve. Era që frynte pa ndërprerë shërbente si një muzikë ilustruese e mendimeve të tij. U ngrit. Zyra e re edhe pse një kat më poshtë ingranazheve të sahatit, përsëri shikonte nga deti. Mendoi të bënte një inspektim në garnizonin e katërt. Duhej të kërkonte forcim të gatishmërisë. Katzeni dhe ushtarakët e tjerë i kishin djekur me ethe lajmet e përditshme që vinin nga fronti i Lindjes, apo nga ofensiva

ajrore në perëndim e në Jug dhe e ndienin si po rrokulliseshin në një tatëpjetë vdekjeprurëse. Nga komunikatat e vazhdueshme, Katzeni e kuptonte se terrori i tyre ishte rritur. Këto ditët e fundit diskutonte shpesh me atë shejtan Robertin.

“Në një dimër të tillë, me borë e furtunë, pa ushqim e pa veshje, si arrijnë të organizohen e të luftojn, si...”

“Ja që arrijnë, i dashur Johan, madje jo keq. Me sa kuptoj unë as “Gjenerali Dimër” nuk po ia arrin qëllinut final”.

“Megjithatë lufta vazhdon, mik i dashur dhe për ne ka rëndësi që moralin ta mbajmë gjithnjë lart”.

“Po morali, nuk është shkop i dashur Johan, morali është shpirt e në shpirt çdo gjë, sado e vogël, lënë gjurmën e vet. Kurse disfatat, thyerja e miteve, natyrisht që lë gjurmë të madhe”.

“Dëgjo këtu, Robert. Të ishte dikush tjetër, apo më saktë të ishte një kohë tjetër, përshembull para një a dy vjetësh, për këto që më the, unë do të të kisha pushkatuar”.

“Jo, nuk do të më kishte pushkatuar”, kish qeshur Roberti.

“Pse?!”.

“Sepse atëhere unë nuk kam pasur këto mendime. Dhe “Gjenerali Dimër” nuk po i ngrinte duart lart”.

Dhe të dy kishin gëlltitur, përmes lotësh, një të qeshur të hidhur sa bota.

Ngriti receptorin e telefonit dhe mori Robertin. Nuk kishte se kujt t’i telefononte tjetër.

Era vazhdonte të frynte dhe ushtarët me sytë nga deti, prisnin, Mirëpo papritmas, nga lart, jo nga ndonjë avion, po nga një kolonë gjigante ere, ranë si parashuta të vogla, me qindra fletushka. Ushtarët zgjatën duart drejt tyre.

Frynte. Deti shkulumonte dhimbje.

- Nga vjen kjo erë?... Si fryn?...

- Kjo nuk është erë, jua them unë, ky është mallkim...

- Mbylle gojën, apo u çmende?!...

- Brr!... Sa stohtë!!...

Frynte erë, ndaj dhe zëri i Robertit vinte i largët e me zhurmë fishkëlluese.

- Çfarë? Çfarë?... - pyeste komandanti Katzen.

- Era.. era,... era, Johan...

- Era?!... Si era?!...

- Një zhurmë e madhe, shungëllon... Dallgët thuajse na kanë ardhur te këmbët...

- Ç'kemi ndonjë gjë të re veç erës?...

- Asgjë... asgjë... Kur të qetësohet pak, eja po deshe.

Mirë?

- Të shoh, të shoh...

U ndanë. Tani ra zilja. E merrnin nga garnizoni i tretë.

- Alo, alo, komandant. Një erë e marrë...

- Përsëri era... E ç'më duhen mua këto njoftime idiote!

- foli Katzeni i zemëruar.

- Jo, jo herr komandant... Doja t'ju vija në dijeni se era, po, era, hodhi nga lart disa fletushka.

- Era...!? - u habit Katzeni dhe iu duk sikur në të dyja tëmthtë e goditën çekanët e saatit.

Dang! Dang! Dang!

- Po, herr komandant... Po përpiqemi t'i mbledhim po janë shumë.

- Po kush i hodhi, xhanëm, si erdhën?!

- Era, herr komandant...

- Pallavra! - u nxeh Johan Katzeni me fytyrë të kthyer nga portreti i Fyhrerit - Megjithatë po vij vetë atje... Alo... alo, alo më dëgjon...

- Ju dëgjojmë, ju dëgjojmë, herr komandant.

- Gjatë kësaj kohe i mbledhni të gjitha!

- Si urdhëron, herr komandant!

Ato fletushka disa orë më parë ishin fshehur në astaret e xhaketave dhe pllatove të dokerëve, të cilët vazhdonin të vinin

mëngjeseve e të largoheshin kur afronte muzgu. Punonjësi i doganës, i mahnitur nga bisdat e replikat e zëvendëskomandantit Gudorf dhe detarit të fshehur, ua kishte treguar dokerëve të gjitha çfarë kishin folur ata të dy dhe kishte dhënë me ngjyra çuditërisht të gjalla ljalët e Qamilit për ekzistencën dhe luftën e Bukuroshes së qytetit. Kjo kishte lënë përshtypje të rrallë te secili. Pastaj kjo dëshmi, dhe pse disi ireale, kishte shërbyer në rolin e polenit admirues. Faktin që në qytetin e evakuar kishin vepruar njerëz, kishin marrë vesh një pjesë e madhe e banorëve. Domethënë detari trim nuk kishte marrë përsipër të bëhej vetëm rojë e disa shtëpive, por e një qyteti të tërë. Dhe vetëm pas gjastëdhjetë e ca ditësh kishin arritur ta zbulonin, ta kapnin e ta vrisnin. Dhe këtë ia kishin bërë me hile, duke i vënë përballë jetën e tridhjetë të tjerëve. Këtë ngjarje me tingull legjende disa nga banorët e kishin zbritur në rrafsh real e konkret: domethënë në qytet ka vepruar dikush, po mund të jenë dhe të tjerë. Atëhere goditjet nuk duhet të rreshtin. Qyteti duhet të mbetet i gjallë deri në përmasat e një simboli. Dhe kështu, me disa nga dokerët si dhe punëtorët e fabrikës së miellit, ishte biseduar se si mund të gjallërohej lëvizja në qytet.

Era frynte në mol dhe i përplaste anijet e vogla sa majtas e djathtas. Dallgët, si ca kuaj të hazdisur, ngriheshin mbi këmbët e përparme dhe goditnin me forcë mbi skafet e drunjtja e metalike. Anija gjermane dhe pse disi më e madhe nga të tjerat, të ankoruara rreth kalatës, përplasej si damblllosur. Kapiteni i anijes dhe dy ushtarë detarë, kërkuan ndihmën e hamejve që ishin strehuar në një magazinë thujse të boshatisur, ku prisnin zbutjen e fortinalit.

- Ka rrezik të këputen cimat e anija të dalë në det të hapur -u tha kapiteni, një oficer i parruar, gjysmë i dehur -Ejani na ndihmoni!

Dokerët pranuan dhe shkuan drejt anijes. Vetëm katër prej tyre, me xhaketa të mufatura, u fshehën diku pas magazinës. Kur shokët kishin nisur punën duke shtrënguar e tërhequr cimat, të katër panë njëri-tjetrin në sy.

- Nxirrini! Dy prej nesh të ngjiten në atë skafin e përmbysur dhe t'i hedhin.

- Mos të na shohin.

- Ushtari ka zbritur nga kulla e vrojtimit. Në këtë shtrengatë askush nuk shikon tej kokës së tij.

- Atëherë të veprojmë sa pa u kthyer ushtari i kullës.

- Po shkoj unë dhe Petriti.

- Na, merri. Dhe kujdes, ëëë.

- Mos u bëni merak. Na prisni këtu. Për dy minuta, erdhëm.

Të dy djemtë vrapuan nga perëndimi i portit, ku ngrihej skafi i përmbysur. U ngjitën në skafin e ndryshkur dhe i hodhën fletushkat lart. Era e fuqishme që frynte nga juglindja, i mori në krahët e saj dhe vrapoi më të tej për nga brigjet ku qenë përqëndruar tre nga garnizonet gjermanc. Një pjesë e mirë e fletushkave fluturuan në drejtim të lagjes "Torra e molos".

Të dy djemtë mbaruan punë dhe u kthyen shpejt te magazina e madhe.

- Në rregull?!

- Në rregull. Shkojmë mes shokëve.

- Kujdes, kaloni nga fuçitë e bitumit pa rënë në sy.

Mes erës me shkulme stërkalash, ata u shkrinë pa u kuptuar me dokerët e tjerë që vazhdonin të siguronin anijen luftarake, ose, më saktë, anijen hemafrodite që tanimë përdorej për transportin e mallrave të rëndomta.

- Si shkoi? - pyeti Stefani që tërhiqte cimën e re.

- Mjaft mirë. Era i çoi larg si me porosi.

Komandanti Katzen urdhëroi shoferin ta ndalonte makinën.

- Shko kape atë fletushkën atje! - tha ai me një ton të rëndë.

Ushtari, frenoi, zbriti dhe rendi pas fletushkës së bardhë. Vetëm pasi vrapoi gati tridhjetë metra, arriti ta kapte.

Johan Katzeni, dhe pse nuk dinte thujtë asnjë fjalë

shqip, nënshkrimin Bukuroshja e qytetit, e thithi me vrer. Shtrëngoi nofullat e zemërimit.

- Ktheje makinën në port!

Hynë në portin e vogël mes gjëmimit të fortunalit. Retë e shtrëngatës po bëheshin gati të zbrazeshin. Disa motobarka të vogla prej druri, kërcisnin. Tutje sytë e Katzenit vunë re dokerët dhe disa ushtarë që po përpiqeshin të lidhnin cimat e reja. Po sigurojnë anijen, mendoi.

Kapiteni i anijes, e pa makinën që u afrua dhe e la punën për një çast.

- Çfarë ka ndodhur, komandant, ndonjë urdhër i ri? - e pyeti.

Katzeni nuk foli, po nxorri fletushkën para syve të kapitenit të anijes.

- E gjetët në qytet?! - pyeti qetësisht kapiteni i pa rruar, tashmë i bërë esëll nga shtrëngata.

- Po, në qytet, këtu pranë portit. Madje më telefonuan edhe nga garnizoni i tretë, ku kanë gjetur qindra fletushka të tilla. I ka sjellë era, më raportuan.

- Era?... Çudi!... Çfarë nuk po sjell kjo era!...

- Pse, çfarë sollti tjetër? - pyeti Katzeni.

- Po ja, gjithë këto telashe, - ia ktheu kapiteni - Anija rrezikohet. Vunë edhe dokerët në punë. Mirë që u ndodhën këtu.

- Mos i kanë hedhur pikërisht këta punëtorët e tu?! - i tha Katzeni.

Kapiteni u bë fare esëll.

- Kjo është e pamundur. Ata ishin gjithnjë nën kontroll.

- Alibi me vlerë - tha Katzeni - Por unë nuk dua të besoj se këto fletushka ranë nga qielli vetvetiu, aq më keq nuk mund të besoj se i ka hedhur ajo, Bukuroshja. Ky është kulmi! - u nxeh ai.

Kapiteni qeshi.

- Pse qeshni?

- Sepse traktet nuk kanë vlerë në një qytet pa banorë,

herr komandant.

- Këtë nuk e dimë - ia ktheu Katzeni - Pastaj kanë vlerë në rradhët e ushtarëve tanë. Ju e dini, ma merr mendja, se ç'ka ndodhur në këtë qytet, apo jo?

- Natyrisht që kam dëgjuar. Ilegali i fshehur u vra. Më duket se për ditë të tëra nuk ka patur asnjë veprim dyshues, apo jo?

- Nuk ka patur, përveçse një balonë fëmijësh, - tha Katzeni.

Tjetri qeshi.

- Pastaj dokerët dhe ata punëtorët e fabrikës së miellit, me sa di unë, ju i kontrolloni që në hyrje të qytetit, apo jo?

- Natyrisht.

- Atëhere pse të dyshoni te punëtorët, aq më tepër kur alibia ime i ndihmon ata...

- Mbase keni të drejtë - tha si i menduar komandanti Katzen. - Po shkoj njëherë në garnizonin e tretë. Më falni për shqetësimin. Mirupafshim!

- Mirupafshim! - iu përgjegj kapiteni i anijes dhe ngriti dorën lart, për t'i kthyer përshëndetjen "Hail Hitler!" komandantit të shqetësuar.

Ky duhej të kishte qëndruar akoma në spitalin psikiatrik, foli me vete kapiteni dhe nxitoi t'u jepte urdhrat e fundit dokerëve, të cilët, me sa duket, ia kishin arritur ta siguronin mirë anije.

Epidami kishte gjysmë ore që rrinte pranë dritares dhe priste kthimin e dokerëve nga moli. E kishte vënë re makinën e komandantit kur kishte hyrë në port. Shkakun nuk e kuptoi. Pastaj makina doli dhe u drejtua tutje, si duket në garnizonet pas kodrave. Njëherë i shkoi mendja se mos kishte nisur ofensiva zbarkuese, po në këtë môt të lig, mendoi, anglezët nuk kanë luajtur nga fiqiri.

Kishte ditë që bashkë me Shpresën vrisnin mendjen se çfarë aksioni të thjeshtë mund të bënin për t'u treguar nazistëve

se qyteti vazhdonte të ishte i gjallë. Një diçka të thjeshtë, një simbol të vogël, kishte thënë ai. Po mendohemi gjatë se frika dhe përgjegjësia janë më të mëdha, kishte thënë ajo. Ashtu ishte vërtet. Rasti i Qamilit i kishte mësuar të dy palët, edhe gjermanët, edhe ata të dy, të fshehurit e fundit. Nazistët fare mirë mund të bënin fajtorë punëtorët, mund t'i përdornin ata si kokë turku, apo si karrem për të kapur gjahun e fshehur. Kjo e mundonte çiftin. Pastaj, e bija thuajse po shërohej. Ajo kishte arritur edhe të fliste. A ia vlente të rrezikonin tani në fund. Edhe lajmet që jepte Radio-Londra në shqip, flisnin për një ofensivë të aletëve. Pra Rajhut po i afrohej honi i thellë. E megjithatë atë duhej të bënin diçka, duhej t'i jepnin një shenjë dokerëve, një shenjë të vetme sa për t'u treguar se rezistenca do të vazhdonte. Po si?

Gjatë atyre minutave që Epidami, i ulur në stolin pranë dritares, mendonte të gjitha këto, fletushkat e vogla ishin shpërndarë nga era. Tri fletushka të tilla ranë të qeta në oborrin e shtëpisë së tij. Në fillim ai nuk u vuri rëndësi, por traktet lëvizën dhe njëra, e mbështetur në gardhin përballë, i tregoi Epidamit fjalën Bukuroshja.

Zemra e Epidamit shpeshtoi të rrahurat. Thërriti Shpresën. E shoqja erdhi me një frymë.

- Shiko, shiko atje në oborr, pranë gardhit...tre trakte. Janë firmosur me një emër: BUKUROSHJA.

- Bukuroshja?! - u habit ajo - Si ka mundësi!?

- Duhet t'i kenë hedhur dokerët. Pashë dhe komandantin që hyri në port.

- Do dalësh t'i marrësh? - pyeti ajo.

- Si thua ti?

- Prit sa të ngryset.

- Mirë do të pres. Megjithëse kam frikë se mos m'i merr përsëri era.

- Kam frikë se këtë rradhë punëtorët do ta pësojnë - tha ajo.

- As unë nuk di ç'të them - ia bëri Epidami dhe ia mori

përsëri dylbitë së shoqes - Tani nuk shihet më. Ka plot një javë që ata i kanë kthyer projektorët nga deti, kështu që dhe lëvizja ime nuk do të jetë e vështirë. Si thua, të dal?

- Mirë, dil. Veç me kujdes!

- Fryn shumë erë dhe zhurmat nuk dëgjohen - tha ai duke hapur dritaren. - Mbaje kanatën. Ashtu.

Ai kërcëu lehtas. I përkulur nxitoi drejt tre fletushkave dhe i mori ato. Përsëri duke ecur në majë të gishtave, iu afrua dritares dhe kërcëu në parvazin e saj.

- M'i hiq këpucët, që të mos lë gjurmë në dhomë - i tha së shoqes, e cila akoma pa folur ai, ia lidhësat liruar këpucët.

Me çorape. me këpucët në dorë, ai zbriti në dhomën e fshehtë. Shpresa mbylli dritaren. Në dorë mbante tre fletushkat. Epidami u ngjiti përsëri sipër.

- Tani është pothuajse natë. Mos ki frikë, - i tha ai.

- Nuk e di, po se ç'kam një parandjenjë të keqe.

- Lëri parandjenjat. M'i jep traktet këtu. Ashtu. - Ai ishte i gëzuar.

- Ora e kthimit të dokerëve kaloi - i tha ajo.

- Kaloi - iu kthye ai. - Po mbase furtuna i ka penguar.

- Kam bindje se vonesa e tyre ka lidhje me traktet, - tha

ajo.

- Po sikur... - ia bëri Epidami dhe e la frazën përgjysmë.

- Çfarë?...

- Po sikur të hyjë në oborret e komshinjve. Mbase mbledh dhe disa të tjera.

- Që t'i shpërndash në krahun tjetër?

- Pikërisht. Ka mundësi që komandanti i qytetit i ka bllokuar dokerët, sepse është i bindur që i kanë hedhur ata. Po të shpërndajmë disa trakte në anën e kundërt të portit, ne do t'i ndihmojmë për t'i bërë të pafajshëm.

- Shumë mirë të shkoi mendja - tha ajo - Veç kujdes, kujdes se na mori lumi pastaj.

Dialog mes banorëve larg qytetit:

- Punëtorët ende nuk janë kthyer nga qyteti.
- Mbase i kanë strehuar atje ngaqë kanë punë.
- Po traktet?!... Ekziston edhe mundësia t'i kenë zbuluar.
- Atëhere ç'të bëjmë?
- Sipas planit: të rrezikojmë dhe të hedhim trakte nga

Shkëmbi i madh në garnizonin e plazhit.

- Atëhere kjo punë duhet bërë tani, sa më shpejt.

- Do shkoj unë dhe një shok tjetër.

- Duhet vepruar me kujdes se në Sh. ëmb janë vendosur disa kundërajrorë gjermane.

- Do të kalojmë përmes pyllit të pishave. Atje gjermanët nuk kanë vendosur roje.

KAPITULLI XV

KULLA E SAHATIT

Ishte një natë e mbarsur me erëra të forta, të cilat vërtiteshin në rrugët e rrugicat me një mllef të pashoq. Epidami veproi shpejt: hodhi traktet në lagjen "Kala", shkoi përsëri në varreza në të njëjtën rrugë si në aksionin e vendosjes së luleve dhe hodhi trakte mbi varret e të rënëve; pastaj gjatë kthimit hodhi ca fletushka të tjera, që era i çoi tutje: në shtëpitë buzë kënetës.

Në qytetin bregdetar, të mbushur me fletushka të firmosura me nga një emër mitologjik, ishin krijuar disa sy të vegjël ciklonesh. Një sy i tillë i fuqishëm përplasi disa trakte në fushat e sahatit, madje ngeci si me dorë një fletushkë në akrepin e njëres fushë.

Në krahun tjetër, diku nga juglindja, dy ilegalë duke përfitur nga errësira dhe era, duke marrë vdekjen ndër sy, çanë me vështirësi drejt Shkëmbit K., i cili ngrihej hijerëndë thujse mbi kapanonet e garnizonit të katërt. Nxorrën traktet dhe i

hodhën fletushkat, të cilat të përfshira nga era, u shpërndanë në hapësirën bregdetare. Vetëiu. Pastaj u dëgjua një bubullimë e thatë. Ilegalët nxituan rrugës së pyllit nga kishin ardhur. Ndërkohë, poshtë nga garnizoni, ku kishin arritur traktet e ngjashme me ato të qytetit, u dëgjuan krismat e para. Patrullat ishin treguar vigjilente.

Traktet e shumta kishin populluar qytetin me fjalët “Brigada”, “fitore”, “dështimi i nazistëve”, “Bukuroshja”. Ishte një popullatë tjetër që gjithashtu po e tërbonte Johan Katzenin, më shumë se popullata e fotografive.

Ushtarët e tij kishin të vështirë të hiqnin fletushkat e fiksuara në fushat e sahatit si dhe në akrepin e vogël. Koha e cete përpara me traktet, me brigadat, me Bukuroshen. Katzenit i shkoi ndër mend të praktikonte edhe njëherë lojën e ndihmësit të tij, Gudorfrit, por përsëri hoqi dorë, e para sepse ishte absurde t’i drejtohej një qenieje mitike si Bukuroshja dhe e dyta, sepse nuk i pëlqente që ai, Gudorfi, të krekosej tërë jetën me suksesin e përsëritur të planit të tij.

- Megjithatë do të vijë një ditë që do hakmerrem! - tha me zë Johan Katzeni dhe ata që ishin rrotull kthyen kokat për të dëgjuar më mirë se si do të vazhdonie më tej komandanti, por ai nuk foli më për këtë, vetëm mbloodhi grushtet dhe i nverikosur iu drejtua Gustav Gudorfrit:

- Jepni urdhër që punëtorët të lihen të lirë!

- Tani është mëngjes dhe do të ishte më e mira të nisnin punën, apo jo? - pyeti Gudorfi.

- Epo mirë. Të fillojnë punën. Nëse anija arrin të shkarkohet plotësisht sot, dokerët mos t’i shoh më në qytet!

- Si urdhëron! - tha shkurt Gudorfi, hipi në makinë dhe u drejtua nga rruga e portit.

Komandanti Katzen u ngjiti në zyrën e tij. Jashtë, që nga kulla e sahatit, dëgjohehin zërat e ushtarëve që vazhdonin përpjekjet për të hequr dy fletushka nga fushat dhe akrepi i vogël. Vërtet që kjo gjendje ishte e padurueshme. Një ironi e gjallë. Më mirë të kishe qëndruar në spital, Johan, në spital,

t'i çoje kurat deri në fund. Veç ai, Gudorli kishte shumë faj, që e kishte pushkatuar në vend, pa e marrë në pyetje, pa e torturuar, njeriun e fshehur. Ai, Johan Katzeni, do ta mbyllte njeriun me një sy në birucat e stohta të burgut të madh, do ta torturonte, do të kërkonte ndihmën e Gestapos nga kryeqyteti dhe patjetër që do të arrinte të nxirrte disa sekrete të nevojshme e të domosdoshme, të cilat do ta ndihmonin për të qetësuar qytetin e pastaj veten. Po ja që fati ishte kundër tij. Dhe, si për drej, ata anglezët nuk po zbarkonin e siç po dukej nuk kishin për të zbarkuar kurrë. I kishte ardhur shpirti në majë të hundës. Lajmet e mbushura me disfata e kishin lodhur së tepërmi. Në komunikatat e Komandës së Lartë gjermane, megjithëse dukej se gënjehej disi me shifra, kuptohej rrokullisja. Operacioni i Dimrit, apo Gjenerali Dimër, siç i thoshin ata, tashmë ishte kthyer në një, (o, zot!), në një dordolec me rrobe të shkyera, me spaletat e akullit të coptuara. I ishte fanitur Gjenerali Dimër.

- Ja, po ulem një copë herë këtu pranë teje - foli Gjenerali Dimër - për pak kohë aq sa ushtarët të heqin traktet nga ora.

- Më duket se i hoqën, Gjeneral, - ia ktheu Johan Katzeni.

- Hë, - ia bëri Gjenerali Dimër - Domethënë akoma pa u ulur, ti do të më përcjellësh. Turp,... vërtet turp!...

Komandanti Katzen vuri re se tani Gjenerali nuk i fliste ashpër si në ato ditët para shtrimit në spital.

- Gjeneral, më thoni të vërtetën, mos po e vonojmë të firmosim disfatën?

- Siç duket, po - tha kokëulur Gjenerali Dimër - Thu se me Operacionin e Dimrit do t'i thyenim, mirëpo paskan qenë llogari të gabuara.

- Po zbarkim a do të ketë?

- Ma merr mendja se jo.

- Po ç'presim atëhere?! - u zemërua Komandanti - Katër garnizone që hanë bukë kot. Na hidhni në luftë ku të doni, ku

të doni, veç këtu jo. Më mirë atje, përballë armëve, se sa këtu, ku edhe të vdekurit protestojnë.

- Pse, a protestojnë të vdekurit?! - pyeti Gjenerali Dimër, i cili u ngrit në këmbë, hoqi kapelen e vjetër dhe zbuloi kokën e thinjur.

- Në qytet, në këto tre muaj të vdekurit vërtet që kanë protestuar, bile na kanë lufuar.

- Po të gjallët, të gjallët ç'kanë bërë?! - pyeti Gjenerali Dimër, i cili shikonte poshtë në rrugë, ku dukeshin hijet e ushtarëve në kullën e sahatit.

- Të gjallët s'paskan forcë të kundërshtojnë të vdekurit, - i tha i lodhur Johan Katzeni dhe shtrëngoi kokën në darën e duarve.

- Papritmas u dëgjua një klithmë njeriu e shoqëruar nga një krra-krra korbash. Komandanti Katzen, kërcëu si me sustë dhe u ndodh në dritare, pranë Gjeneralit Dimër.

- Nga kulla e sahatit ra një ushtar, - foli qetë-qetë Gjenerali Dimër.

- Të zbresim! - thirri i papër mbajtur komandanti Katzen.

- Ti zbrit, kurse unë po qëndroj. Jam shumë i lodhur. Në këta miliona të vranë, një ushtar më tepër s'do të thotë asgjë.

Katzeni nuk bëri zë. Për dy minuta u ndodh para kufomës së ushtarit, i cili në dorë, si shpatë të thyer, mbante akrepin e sahatit, ku siç dukej ishte kapur për t'u siguruar.

- Kurse Gjenerali Dimër thotë se të vdekurit nuk protestojnë. Bile na kërkojnë llogari ne të gjallëve. - foli si me vete Katzeni dhe ata pak ushtarë e nënoficëfë që ishin rrotull kufomës, kuptuan se përsëri te komandanti i tyre po shfaqeshin simptomat e sëmundjes.

Megjithatë Katzeni, pasi pa fytyrat e tyre, sikur u përmbloodh dhe tha krejt natyrshëm:

- Merreni kufomën dhe varroseni!

- Si urdhëron, herr komandant!

Katzeni fërkoj sytë. E kuptoi se tani nuk do t'i shfaqej

më fantazma e Gjeneralit Dimër.

- Eja e marrim kufomën. - foli njeri nga ushtarët.

- Ku ta çojmë?

- Presim makinën e komandantit, - tha i treti - sa të kthehet nga porti. Hiqe atë akrep ore. Duket sikur ka vrarë veten me një thikë të çuditshme.

- Vërtet kështu duket. Po i ndjeri nuk e lëshon. I ka ngrirë në duar.

- Atëhere ta varrosim me gjithë akrep.

- Alo,... Alo,... alo... Po, unë jam, Johan Katzeni. Kush? Korparmata? Urdhëroni?... Si?!... Do tërhiqemi?!... Kuptova... Kuptova... Më mirë kështu... Hail Hitler!

Ishte i hutuar, megjithëse këtë lajm e kishte dëshiruar prej kohësh. Tani do të priste të vinte urdhri me shkrim e dalëngadalë do të organizonte kthimin e trupave nga brigjet për në thellësi të steresë. Më mirë kështu. Dang! Dang! Dang! Dang! Dang! Dang! Dang! Dang! Dang!

Nëntë herë. Ishte ora e madhe apo kambanat e një kishe të fshehur diku nën kafkën e tij, të cilët kumbonin për ushtarin e sapo rënë nga kulla e sahatit.

Dang! Dang! Dang!

Dang! Dang! Dang!

Dang! Dang! Dang!

Duhej të ishte patjetër në ëndërr, në ëndërr domosdo, sepse vetëm në ëndërra lindin kisha nën kafkë, sepse vetëm në ëndërra mund ta marrësh e ta përdorësh si shkop dirigjenti akrepin e këputur të një sahati, sepse vetëm në ëndërr mund të qajë një ushtarak i Fyhrerit, sepse vetëm në ëndërr mund të protestojnë ata qindra e mijëra të vdekur e të flijuar të një qyteti që çdo ditë kundërshtonte vdekjen.

Në muzg, kapiteni i anijes u tha dokerëve se mallrat ishin shkarkuar, ndaj të nesërmen nuk do të vinin më. Stefanit dhe dokerëve të tjerë u kishte bërë përshtypje këmbëngulja e kapitenit për të mbështetur alibinë e tij. Kjo këmbëngulje disi e çuditshme, por që shpesh pritet nga tipa sanguin, i kishte

shpëtuar nga vdekja e parë. Kurse shpërndarja e po këtyre fletushkave në lagjet e largëta të qytetit, gjatë kohës që ata ishin të izoluar, i kishte shpëtuar nga vdekja e dytë. Urdhri i mëngjesit i kishte shkarkuar nga ankthi, pra hë për hë nuk do të vinin më në qytet.

KAPITULLI XVI

GRAHMA E FUNDIT OSE “MUAJI I FATIT”

Zarfin me urdhërin për tërheqje të trupave, komandanti Katzen e mori si pa dëshirë nga dora e korrierit. Kishin dy ditë që diskutonin rreth bisedës telefonike me Komandën e Korparmatës. Klubi ishte gjallëruar si pa kuptuar. Roberti kishte gjetur një violinë tjetër dhe i dehur nga konjaku vërtitej mes tryezave, duke i rënë instrumentit me sy gjysmë të mbyllur. Secili pinte e dëfrehej sipas mënyrës së tij. Bisedat vërtiteshin sa vërtiteshin të lira, pastaj, ktheheshin te e njëjta pikë: te tërheqja e garnizoneve, ku do t'i përplasin, në cilin mal, në cilën luginë, në cilën rrugë, para cilës vdekje. Prandaj urdhërin nga Korparmata e prisnin me padurim. Lajmet ishin vërtet çoroditëse. Komanda e Lartë nëpërmjet Agjencisë gjermane të lajmeve e paraqiste tërheqjen e trupave si të paracaktuar në planet e saj, kurse agjencitë e tjera të lajmeve flisnin për asgjësimin e dhjetra divizioneve gjermane, për asgjësimin e Armatës së Gjashtë në frontin e tretë të Ukrainës, për kundërofensivat e dëshpëruara e të pasuksesshme të Fon Manshtainit, për bombardimet angloamerikanë mbi Gjermaninë dhe tokat e pushtuara prej saj.

- Ah, muaji mars, muaji mars - ia bënte Roberti dhe luante në violinën e re “Valët e Danubit”.

Johan Katzeni e kuptonte se ç'kërkonte të thoshte miku i tij me atë frazë pompoze, në dukje absurde. Madje jo vetëm me frazën, por edhe me valsën e njohur të Shtrausit. Për të

gjithë ushtarakët e Rajhut dihej se muajin mars, Hitleri e konsideronte si muajin e fatit, sepse në këtë muaj ai kishte rrezuar Hidenburgun dhe kishte marrë frerët e Rajhut në duart e tij, në këtë muaj kishte pushtuar Pragën dhe po në këtë muaj Vjenën. "Valët e Danubit" përhapeshin në sallën e tymosur, treteshin në lëkurat e ujçëve, deleve e sorkadheve, të cilat nuk kishin shpresë të binin më në dysHEME. Tingujt shoqëroheshin nga fjalët - refren të Robertit:

- Ah, muaji mars, muaji mars!

Komandanti Katzen u detyrua t'i tërhiqte vërejtjen Robertit. Pastaj urdhëroi ta hipnin në makinë dhe ta çonin në garnizonin e katërt. Por edhe në makinë, para shtëpive të boshatisura, para patrullave dhe tej në hyrje të qytetit, para ushtarëve të postbllokut, Roberti vazhdonte të luante në violinë pjesë të ndryshme dhe të deklamonte, si një aktor, fjalët:

- Ah, muaji mars, muaji mars!

- Çfarë ka në muajin mars? - e pyeti shoferi.

- Në muajin mars, asgjë. Në mars mbarsen macet. Ha-

ha-ha!

Zarfin e lehtë, tepër të lehtë, komandanti Katzen e hapi pa ndonjë solemnitet. Ishte në zyrën e tij, i vetëm. E lexoi me një frymë. Shkurt. Prerë. Saktë. Do të tërhiqeshin. Paralel me tërheqjen do të bëhej dhe minimi i bregdetit, si dhe do të hidhej në erë porti i qytetit.

Urdhri ishte i qartë. Katzeni pati një gëzim të brendshëm, vertet cinik, po gëzim, kur lexoi për minimin e brigjeve dhe shkatërrimin e portit. Në një farë mënyre kjo do të ishte hakmarrja e tij ndaj qytetit.

Vendosi të mblidhte urgjentisht komandën për t'i komunikuar urdhrin e Korparmatës.

Minat e markave "Holzminë", "Telerminden" dhe "3 mi-35", i vendosën në një dhomë të vogël pranë zyrës së Robertit.

- Ky plazh s'do të ketë verë, mbase asnjëherë, - i tha Roberti njerit prej xhenjerëve.

- Për disa vjet jo - foli xhenjeri, një nënoficer me përvojë - Edhe nëse armiku do të zbarkojë ndonjë ditë, do të hasë në zonat e minuara.

- Dhe minimi po bëhet në fund të muajit mars, - foli me vete Roberti, duke kujtuar turbull zhurmën që kishte bërë në klub para tre netësh.

- Si thatë? - pyeti xhenjeri që nuk e mori vesh domethënien e fjalëve të eprorit.

- Oh jo, asgjë, asgjë. Unë po largohem. Ju vazhdoni punën.

Do të minohej i gjithë plazhi, i gjithë bregdeti, si dhe faqet perëndimore të kodrave ku për disa muaj qenë ngujuar garnizonet. Tani, mendonte xhenjeri, një ushtri e hekurt do të përgjonte disa centimetra nëntokë. Minimi do të bëhej shpejt, menjëherë pas tërheqjes së trupave të katër garnizoneve. Tanimë thujse çdo gjë ishte gati, pritej urdhri dhe ai me xhenjerët e tjerë me anë të lopatave të vogëla, do të hapnin disa mikrovarre ku do kallnin qindra e qindra kufoma të hekurta. Pastaj do të minonin edhe detin. Imagjinoi faqen e detit përballë të mbushur me dhjetra nishane kanceroze dhe ndjeu një kënaqësi cinike.

Nga larg u afruan tingujt e violinës. Kuptohej që Roberti, komandanti i garnizonit të katërt, luante mbase pjesën e fundit para tërheqjes. Xhenjeri e njihte mirë Robertin dhe i pëlqente natyra e tij mospërfillëse, herë- herë hokatare, i pëlqente mënyra se si ai u fitonte zemrën eprorëve, madje edhe komandantit Johan Katzen. Tingujt e violinës u ndërprejnë. Xhenjeri mori lopatëzën dhe nisi të hapte gropën e parë. Rëra ishte e lagur dhe kërciste. Nënoficeri ndjeu hapa, ktheu kokën dhe pa përsëri Robertin, i cili këtë rradhë mbante në dorë

violinën.

- U ktheva përsëri..

- Ka ndonjë porosi tjetër?

- Jo, kam një dëshirë, një trill që duhet të ma plotësosh.

- Megjithëqej! - ia ktheu nënoficeri xhenjer, i cili i njihte mirë trillet e Robertit, veçanërisht pas dehjes.

- Dua që këtë violinë ta vendosësh pranë ndonjë nine. Në luftime unë asnjëherë nuk kam marrë violinë me vete. Merre!

- Si urdhëron! Po të doni ju, komandant, e groposim violinën që tani, në këtë varr...

- Varr?!... Kjo është e trishtueshme.

I la violinën nënoficerit, i cili qetë-qetë nisi të plotësonte atë dëshirë dhe amanet të komandantit të garnizonit të katërt. E hapi dhe pak gropën e vogël dhe vendosi në të në fillim "Holzminën" e pastaj violinën. Mendoit t'ia thoshte Robertit se, ashtu të përqaftuar, mina dhe violina ngjanin me Romcon e Zhuljetën, por nuk donte t'ia cingërriste më nervat eprorit ndaj gjithnjë i qetë, duke fishkëllyer motivin e Lili Marlenit, e mbuloi me dhë çiftin e çuditshëm.

Edhe në tre garnizonet e tjera ushtarët xhenjerë po groposnin minat, sikur po linin, të mbledhura në togje, hijet e tyre. Minavënësit nxitonin duke hapur gropa në ranishte, në kodrat argjilore, në tokat me shtresë shtufi e leshterikësh e duke mbjellë në to farëra vdekjeprurëse.

Në mëngjesin e fundmarsit, kur sabati tingëlloi tetë herë, vargu i gjatë i ushtarëve dhe i mjeteve të motorizuara, nisi marshimin e tërheqjes. Ishte një mot me qiell të çarë, nga ku buronte një dritë e kaltër. Komandanti Katzen, gjithnjë mbi makinën tij, parakaloi trupat e tre garnizoneve. Garnizoni i Robertit do ta priste matanë urës. Johan Katzenit në çast i shkoi mendja që gjithë atë ushtri, ato tanke, murtaja, topa e mjete të tjera, t'i derdhte si llavë mbi qytetin e boshatisur e të

shkatërronte gjithçka. Por kjo ishte vetëm një dëshirë e brendshme, një hakmarrje e fantazuar, sepse ai nuk do të bënte asgjë. Urdhri i Korparmatës mjaftonte edhe për hakmarrjen e tij. Tani me dhjetra xhenjerë kishin nisur të minonin brigjet rrotull qytetit, tokën dhe detin. Sapo trupat të kalonin urën, porti me ato pak anije, do të hidhej në erë. Kaq mjaftonte. Po Bukuroshja? Vetëm asaj nuk kishte çfarë t'i bënte. Për këtë kishte biseduar me veten, me Gjeneralin Dimër, me Komandën e Korparmatës, me komandën që ai drejtonte, me Robertin e tij të alkoolizuar, si dhe në spital me arkeologun e plagosur dhe të gjithë kishin bindjen se Bukuroshen nuk mund ta asgjësonin, ashtu siç nuk mund të vrisnin një ëndërr, një mendim, një shpirt. Natyrisht atij nuk i vinte mirë që bindja ishte krijuar. Po fundja cili ishte ai, Johan Katzeni. Një oficer i Rajhut në perëndim, një ish dirigjent orkestre, që nuk kishte arritur të dirigjonte as edhe një qytet të boshatisur, ndaj dhe nuk i lejohej irritimi prej të çmenduri, para një krijese që kishte ditur të kundërshtonte. Shubert: kuartet në re minor me variacione mbi "Vdekjen e vashës".

Makina arriti para komandaturës, e cila së shpejti do të kthehej në Bashki, apo kushedi në çfarë institucioni. Ngriti kokën nga kulla, ku sahati vazhdonte të punonte normalisht, pavarësisht se në njërën nga të katër fushat, një akrep mungonte. Akrepin e kishin varrosur sëbashku me kufomën e ushtarit orëndreqës. Katzeni ktheu kokën majtas, nga krahu tjetër, ku ngriheshin shtëpitë e shumta, si dhe disa nga muret e kështjellës së lashtë. Përsëri iu kujtua vendlindja e tij, Nurembergu, Porta Nigra e dashur, fëmijëria, pastaj shëtitjet me Anën në ato mure të gjëra. Megjithatë këto mure kështjelle se ç'kishin një si tërheqje magnetike, një hije krenarie që sot, në këtë qiell të ciflosur merrte një pamje më solemne. Mbase kjo kishte të bënte me tërheqjen e trupave të tij.

Dang! Dang! Dang! Dang! Dang! Dang! Dang! Dang!
Dang!

Duhej të tregohej më i matur. Fundja ai këtë kishte

dashur, të largohej nga ky qytet. Që nga spitali i kishte shkruar një letër Anës, një letër ku natyrisht vetëm e gënjente. Kurse tani kishte në xhep një letër tjetër, ku nuk nxinin më gënjeshtër, po xixëllonin disa lotë të brendshëm, një ofshamë e përgjithshme, disa fraza që tingëllonin si amanete. Mori njëherë frymë thellë dhe hodhi shikimin përpara. Tutje dukej ndërtesa e hotelit dhe e klubit.

- Kur do të kthehen banorët? - e pyeti shoferi.

- Nuk e di. Radioja akoma nuk ka dhënë ndonjë lajmërim. Por mendoj se pas minimumit të bregdetit. Shoferi tundte kokën.

Epidami, Shpresa dhe e bija, Jeta, ia kalonin dylbitë njeri-tjetrit për të parë atë marshim të heshtur të ushtrisë gjermane. Jeta e vogël shikonte qënien e lëvizshme me helmetat - luspa.

- Ata po tërhiqen. Zbarkim nuk do të ketë. - kishte thënë Epidami.

- Na ka marrë malli për të gjithë, - kishte thënë Shpresa e mallëngjyer.

- Dhe unë kam kaq kohë pa lozur, - kishte ndërhyrë Jeta.

- Si duket kjo është grahma e tyre e fundit, - kishte thënë Epidami.

Tani vazhdonin dylbimin e ushtrisë. Rrëshqanori me luspa helmetash po i afrohej urës në hyrje të qytetit. Atje e priste një garnizon tjetër. Papritmas u dëgjua një shpërthim i fuqishëm, që tronditi dheun, muret e shtëpisë, pemët në oborre. Jeta u drodh. E ëma e mbështolli në krahët e saj. Epidami ia mbylli veshët me pëllëmbët e mëdha.

- Mos keni frikë, - i qetësoi vajza.

- Hodhën portin në erë, - tha Epidami.

- Të poshtërit! - u zemërua Shpresa që vazhdonte të shtrëngonte Jetën në krah.

Shpërthimi vazhdonte. Atëhere Epidami, i trembur se mos i frikësohej përsëri e bija, e mori vogëlushen në krah dhe e zbriti poshtë, në dhomën e fshehtë. Porta e llamarintë, që lidhte dhomën me katakombet, tashmë rrinte e hapur.

- Qëndroni këtu, unë po ngjitem edhe njëherë, - tha Epidami.

- Babi, mos u bëj merak, jam shumë mirë, - e qetësoi përsëri Jeta, tani me kokën në prehërin e nënës.

- Ti je vajzë e mrekullueshme! - e përkëdheli i jati.

Ngjiti shkallëzat e nxitoi drejt dritares. Vendosi përsëri dylbitë. Porti ishte përfshirë nga flakët dhe tymi. Anijet e varkat e pakta, që kishin mbetur, digjeshin me shpejtësi. Pas çdo shpërthimi, copëzat e mëdha të skafeve ngriheshin në ajër si gjallesa në djegie dhe përplaseshin në det me dëshirën për t'u shuar.

Një port i vogël nuk do shumë kohë të shkatërrohet, ndaj çdo gjë u fashit për pak minuta. Kolona e ushtarëve dhe mjeteve të motorizuara e kishte kaluar urën.

Tani qyteti pret banorët, mendoi Epidami i përfshirë nga ca ethe emocionesh të veçanta.

KAPITULLI I EPILOGUT

BATICA NJEREZORE

Dy ditë pas largimit të trupave naziste, radioja dhe gazetat qëndrore dhanë lajmin se banorët mund të ktheheshin në qytetin e tyre. Po nëse evakuimi ishte bërë me urdhër dhe i menjëhershëm, banorizimi po bëhej ngadalë. Në fillim u kthyen qytetarët që nuk kishin patur çati e që kishin dimëruar ku të mundnin. Të drobitur, me një lodhje të pashembullt, ata nxitonin hapat drejt vatrave. Pastaj u kthyen të tjerët, ata që në këta muaj ishin bërë barrë e miqve dhe e kushërinjve në fshatrat

dhe qytetet rrotull. Shamë familje ishin të rralluara, ngaqë djemtë dhe vajzat kishin rrëmbyer pushkët e ishin ngjitur maleve.

Mes banorëve, si të trullosur, por me një gëzim që ndihej të lëvizjet e tyre, ecnin edhe kafshët shtëpiake.

Epidami kishte vendosur që, qetë dhe pa bujë, të takonte ata qytetarë të cilët i kishin besuar çelësat Qamilit. Shumë banorë e kishin marrë vesh rezistencën e qytetit nëpërmjet tregimeve të dokerëve dhe punëtorëve të fabrikës së miellit. Ai, si dëshmitar më i vjetër, do t'u tregonte hollësi të domosdoshme natyrisht më vonë, kur të vinte koha e duhur. Futi në trastë gjerdanin me çelësa dhe u bë gati të dilte.

- Babi, të vi dhe unë me ty. - kërkoi duke u lutur e bija.
- Mirë, eja.

Shpresa i përcolli deri poshtë te rruga kryesore.

- Në fillim të shkojmë te furra e bukëpjekësit, - foli

Epidami.

Dukej sikur ishte bërë me krahë. Do të merrte gjerdanin me çelësa që kish fshehur "pirati" në furrë e pastaj do të kalonte derë më derë për t'i shpërndarë ato, çelësat e jetës, të cilat i kishin ndihmuar kaq shumë në luftën e tyre.

Bukëpjekësi Naim e kishte hapur portën dhe po pastronte.

Epidami pasi e përshëndeti hyri drejt e në thelb:

- A e keni gjetur gjë gjerdanin me çelësa?

- Çfarë çelësash? - kishte luajtur të hutuarin furxhiu.

- Jam miku i Qamilit.. Para se ta vrisni gjermanët ai...

- Mirë, eja futu brenda - i tha furxhiu dhe e kapi për krahu. Ja ku janë çelësat. I kishte futur në furrë, ja këtu, në cep të gojës: Ja kemi borxh, trimit... Domethënë këtu te furra ime ka qenë para vdekjes, ëëë?

- Po, xhaxha.

- Bukën e parë do ta pjek për shpirtin e tij, - tha plaku me sy të shndritshëm nga lotët.

Qyteti ishte zgjuar. Çuditërisht ishin kthyer edhe zogjtë. Pëllumbat e rinj, me krahët ende të pazhvilluar, bënë prova

fluturimi. Ata nuk do ta njihnin më Kosta Pëllumbin dhe s' do të kishin mundësi të dërgonin pusullat e tij anekënd botës. Oxhaqet kishin filluar të shpalosnin shamitë e tymrave. Ora në kullë vazhdonte të ecte me rregullin e njohur. Vetëm një akrep kishte rënë, po kjo ishte thjesht si rënia e dhëmbit të parë të fëmija i njomë. Prauvera mugullonte kudo, nëpër kodra, në oborre, në rrugë e rrugica. Pasi rregullonin shtëpitë, banorët, gjithnjë grupe-grupe, nisën vizitat e para te njeri-tjetri. Pastaj, me tufat e luleve në duar, nxitonin për te varreza, ku të dashurit i kishte marrë malli.

Stefanin nuk e gjeti në shtëpi. madje as të shoqen dhe fëmijët. Një komshi i tha nën zë se Stefani dhe ca dokerë të tjerë ishin bashkuar me partizanët.

Epidami vazhdoi për në shtëpitë e tjera. Mjeshtri i ëmbëlsirave e kishte hapur dyqanin dhe i zgjati Jetës një sheqerkë të madhe shumëngjyrëshe. Xha Fati ia dha falas. Në vend të monedhës, Epidami i dorëzoi çelësin e shtëpisë. Tjetri e mori heshturazi, i mallëngjyer, duke thënë ngadalë vetëm një "faleminderit".

Vonë, kur të gjithë çelësat shkuan sërish te të zotët e tyre, mbi qytet u shfaq një krijesë e mrekullueshme, e ndezur, me flokë të shpalosur në erë, me një veshje mozaiku shumëngjyrësh. Të gjithë banorët dolën te pragjet e shtëpive, ndalën hapat dhe ngritën kokat. Sytë e tyre u mbushën me dritë. Pastaj krijesa mitike u bë reale, vraponte e vraponte nëpër qytetin e gjallëruar. Ishte e bukur, e prekshme dhe të gjithë qytetarët mahniteshin duke e parë dhe thërrisnin:

- Bukuroshja! Bukuroshja!... Ja Bukuroshja e qytetit!



Shkurt 1989